

Nga lulishtja e zemrës:

ENIGMA E DASHURISE PER ALLAHUN DHE PROFETIN

OSMAN NURI TOPBASH



Progresi Botime

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

SHKODËR, 2010

OSMAN NURI TOPBASH

Nga lulishtja e zemrës:

**ENIGMA E DASHURISE
PER ALLAHUN
DHE PROFETIN**

Titulli original:
Gönül Bahçesinden
MUHABBETTEKİ SIR
Osman Nuri TOPBAŞ



PROGRESI sh.p.k.

Adresa: L: Vasil Shanto Rr: Çajupi Shkodër / Shqipëri
Tel: +355 22 25 46 34 Fax: +355 22 25 46 33
Mob: +355 69 20 76768 Mob: +355 67 20 86767
Http: www.progresibotime.com e-mail: botime@progresibotime.com
Design: Bledar Xama

Adresa Kosovë: Rr: Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin / Prizren
Tel: +381 29 222 795 Fax: +381 29 222 797
e-mail: kosova@progresibotime.com

Adresa Maqedoni: Rr: Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25 / Shkup
Tel: +398 71 956 271 e-mail: maqedoni@progresibotime.com

PARATHENIE

*L*avdi Allahut të Lartë që na ka dhënë pjesë neve, robve të Tij të ngratë, nga kënaqësia dhe lumturia e besimit!

Paqe Krenarisë së Përjetshme të gjithësisë, i cili u bë pretekst për ta nxjerrë njerëzimin nga errësira në dritë!

Meqë Zoti e ka krijuar qenien me dashuri, i ka falur asaj një enigmë krejt të veçantë. Për rrjedhojë, aty ku s'ka dashuri, shihen shfaqje perëndimi e humbjeje, kurse aty ku ka dashuri, shihen shfaqje përsosmërie. Ashtu siç thuhet në kritikën mesnevite, *Allahu i pëshpëriti resë në vesh një të fshehtë dhe nga sytë e resë u zbrazën lot si lumë; i pëshpëriti trëndafilin në vesh një të fshehtë dhe trëndafili u zbukurua me mbretërinë e aromave e ngjyrave; i pëshpëriti gurin në vesh një të fshehtë dhe guri u kthye në perlë të fshehur mes mineralit; i pëshpëriti njeriut në vesh një të fshehtë dhe njerëzit që e ruajtën atë të fshehtë, u bënë të pavdeks-hëm!*

Ja, pra, kjo e fshehtë është enigma e dashurisë për Allahun dhe Profetin. Prandaj, fitimi i lumturisë së të dy botëve nga njeriu me anë të fitimit të pëlqimit të Allahut të Lartë dhe meritimit të ndërmjetësimit për falje të Profetit (s.a.s.) është një



e vërtetë evidente e fshehur në madhësinë përshndritëse të enigmës së dashurisë për Zotin dhe Profetin. Në zemrat konfidente dhe besnike të kësaj të vërtete përjetohet dalldia dhe vetëharrimi i një dashurie pasionante të shembëllyer në **vajtimin e drurit të hurmasë që qante** nga dashuria për Profetin (s.a.s.)! Ky përjetim e ngre njeriun, si **njeri të përsosur**, në majën e qenies, në postin e krijimit të përsosur dhe e shtyn në **drejtimin** e urdhëruar nga Zoti, në rrugën e drejtë, të quajtur *sirati mustakim* që është rruga e vetme e drejtë! Pastaj, vazhdimësia e të qenit *mustakim*, i orientuar, është e mundur duke treguar ndjeshmërinë për t'u shoqëruar, **për të qenë së bashku me njerëzit e mirë e besnikë**, sepse ky shoqërim vendos ekuilibrin **kurm dhe shpirt**, domethënë siguron epërsinë e mbretit-shpirt mbi shërbëtorin-kurm dhe, duke e shpëtuar zemrën ku hidhet vështrimi hyjnor, nga kjo botë e vdekshme dhe robëria e kurmit, i jep mundësi të arrijë kënaqësinë e të qenit konfident i Zotit dhe prehjen e të qenit në shoqërim të Zotit. Kjo prehje është një sevda me të cilën nuk ke të ngopur. Është një mënyrë shikimi pa pasë nevojë për sy, është një mënyrë jetese e çliruar nga pengesa e gjymtyrëve!

Pas kësaj, në çdo stacion të udhëtimit drejt pavdekësisë që e vazhdon duke u maturuar gjithnjë e më shumë mes shfaqjeve të **besimit dhe provës**, njeriu trajtohet në raport me **principlitetin dhe sinqeritetin** e vet. Nga ana tjetër, **frika dhe shpresa**, çelësi i mëshirës dhe bamirësisë së Zotit në këtë udhëtim hyjnor, janë shumë të rëndësishëm për fitoren e zemrës në luftën e saj ndaj egos në lidhje me ndjenjat egoistike negative si **ambicja dhe smira** dhe ndjenjën pozitive të **ngopjes dhe përkorësisë**. Kjo situatë, duke e mbajtur zgjuar njeriun nga **indiferentizmi**, i siguron atij adhurimin e Zotit me një zemër të gjallë e të paqtë, të pastruar e të ruajtur nga



mëkatet, i jep mbështetje zemrës **për ta mposhtur zemërimin** duke e mbajtur egon nën kontroll!

Kështu, ata që munden të pajisen me cilësinë e një “ekuilibristi të vërtetë”, siç shprehet Profeti (s.a.s.), duke e dalluar vullnetin hyjnor mes **jetës dhe vdekjes**, nuk u japin vlerë kënaqësive kalimtare, kapen vetëm pas njerëzve punëmirë dhe vazhdojnë një jetë të stolisur me dije, kulturë shpirtërore, shërbim dhe adhurim. Dhe zemrat, ngaqë një jetë e tillë ka për t’i mbushur vetëm me dashurinë për Zotin, jetojnë në qetësinë e **zbukurimit të vdekjes** brenda dëshirës së bashkimit me Zotin, domethënë e mendojnë vdekjen si natë dasme dhe, ngaqë ndodhen vazhdimisht mes emocionit të atij çasti bashkimi, kafazi-kurm nis t’i vijë ngushtë zogut-shpirt. Prandaj ditën ushqehen me gjëra hallall, të bekuara, siç e kërkon pëlqimi hyjnor, kurse natën, duke u kredhur nga dritarja e **enigmës së natës** në klimëra të zgjedhura, begatohen me të mira shpirtërore të vërteta të sofrës së Mëshiruesit. Prandaj tek ta nuk ka as lodhje nga frika për **ushqimin e përditshëm**, as rrahje zemre nga dyshimi për një gjë tjetër të kësaj bote! Në horizontin e dorëzimit dhe nënshtrimit, shpirti është në gjendjen e një reje që shpërndan mëshirë edhe mbi veten, edhe përreth. Duke u bërë burim begatie dhe qetësie për shoqërinë, edhe follenë familjare që është guri themeltar i saj, e shndërron në parajsë të kësaj bote!

Ata që rriten e përgatiten në atë parajsë, janë, në këtë botë prove ku zhvillohet lufta për jetë a vdekje **mes dritës dhe errësirës** si një shfaqje hyjnore, vazhdimisht kërkuesit dhe shërbyesit e të drejtës, të vërtetës, domethënë, të drejtimit të treguar në deklaratat hyjnore. Në mënyrë të veçantë, atë që u takon në lidhje me **detyrat tona ndaj Kur’anit**, e kryejnë të ekzaltuar, të mbushur vazhdimisht plot me begati dhe frymë shpirtërore. Veç kësaj, nga kjo gjithësi madhështore në



gjendjen e një libri të pazë e të pafjalë, marrin sa e sa mësimë urtësie, fshehtësie dhe vërtetësie e, kështu, bëhen një pasqyrë e shkëlqyer që reflekton përreth vezullimet e begatisë, qetësisë dhe gëzimit shpirtëror për të cilat janë të denjë. Ja, pra, kjo gjendje sublime e lartë është **të jesh një Kur'an i gjallë!**



-Këtë subjekt që morëm ta trajtojmë në këtë librin tonë të varfër, u përpoqëm ta zhvillojmë duke përfitur së pari nga Kur'ani dhe porosinë profetike, pastaj edhe nga gjendja e bukur, morali, poetika dhe shprehjet me përmbajtje të thellë të miqve të Zotit.

Mbështetur mbi këtë të vërtetë, në librin tonë përfituar nga njerëzit e afërt të Zotit në kuadrin e shfaqjeve për të cilat ata kanë qenë bërë të denjë, duke u drejtuar te burimet e punës dhe përpjekjeve të dikujt, te zjarri i pasionit të dikujt tjetër, duke dëgjuar zërin prej bilbili të një tjetri, duke u marrë erë trëndafilave të dikush tjetër dhe duke u përpjekur të mbledhim perlat plot urtësi të shpërndara nga dikush tjetër. Pra, morëm pjesë nga gjendja e dikujt e nga fjala e dikujt tjetër!

Dhe morëm pjesë veçanërisht nga *Mesnevi*ja e Mevlanait i cili, mes këtyre, në fushën e fjalëve dhe të thelbit të kuptimit, ka qenë i denjë për shfaqje të mëdha. *Mesnevi*ja e tij është një vepër e pavdekshme që bën fjalë për të fshehtat hyjnore, që tregon për rrjedhat e fuqisë së lartë, që na e përcjell neve me një stil sundues gjithësinë dhe detajet e saj.

Për mesnevinë si art poetiko-mistik, Mevlanai thotë kë-shtu:



“Mesneviya është një rrugë për ata që kërkojnë të arrijnë te e vërteta dhe të bëhen njohës të të fshehtave të Allahut. Mesneviya është shërim zemrash për njerëz të pastruar. Ajo i shpërndan mër-zitjet. Ndihmon për ta kuptuar Kur’anin. I zbukuron shprehitë...”

Zoti qoftë i kënaqur me këta rob të vërtetë të Tij dhe na e mundësoftë neve të përfitojmë denjësisht prej tyre!

Zoti u dhëntë favore të pafund atyre robve të përso-sur të Tij që e kanë shpenzuar jetën në rrugën e shërbimit ndaj Kur’anit! Na e mundësoftë të gjithëve të jetojmë si ata, të orientuar kah pëlqimi hyjnor e të marrim pjesë nga bukuritë e larta e sublime! Na rrethoftë ne me shfaqjet e begative dhe pasurive shpirtërore! Na favorizoftë ne duke na u dhënë zemrave dalldinë e besimit, ndjenjave, dritën e Kur’anit, shqisave, burimet e të fshehtave dhe urtësive dhe ndërgje-gjeve, dhembshurinë, mëshirën dhe afërsinë e Tij!

Amin, ashtu qoftë!

Osman Nuri TOPBASH
Stamboll - Yskydar
07.01.2001





ENIGMA NE DASHURINE
PER ALLAHUN DHE PROFETIN

الابذكر الله تطمئن القلوب

تقداسى مستغزوب

*"Zemrat kënaqen vetëm kur
e përmendin Allahun!"*

(Kur'ani, Ra'd:28)



ENIGMA NE DASHURINE PER ALLAHUN DHE PROFETIN

*N*jë mik i Zotit tregon:

Po kaloja nëpër një fushë të gjerë e të shkretë. Ndërkaq, hasa në një çoban të vetmuar. Pashë se po falte namaz me një përshpirtshmëri të thellë, kurse tufën po ia ruanin ujqit! Bëra çudi! E prita me kureshtje ta mbaronte namazin dhe pastaj e pyeta:

“O çoban! Si ndodhi që ujqit u bënë miq me dhentë? Si ndodhi që fryma e egërsisë dhe armiqësisë tek ujqit ia la vendin paqes dhe dashurisë?”

Dhe çobani, fytyra e të cilit qe ndriçuar prej shenjës së sexhdes ndaj Allahut, më tha kështu:

“O udhëtar i vetmuar! Enigma e kësaj dashurie të ujqve për dhentë ka të bëjë me dashurinë e çobanit për të zotin e vërtetë të kësaj tufe, pra, kjo që po sheh e po të çudit, është një enigmë dashurie!”

Siç duket edhe në këtë rrëfim, dashuria është një enigmë e tillë, veç së cilës nuk ka faktor më të fuqishëm që ta zhvillojë shpirtin e njeriut. Dhe kur kjo dashuri të jetë kthyer në



një pasion, drita e saj i djeg të gjitha dëshirat dhe iluzionet e tjera, perdet e errësirës i bën hi dhe zemrën e ngre në lartësi të pafundme, sepse njëra prej cilësive më të larta të thesarit të fshehtë të pohuar në deklaratën e mëposhtme është bukuria absolute:

كُنْتُ كَنْزًا مَخْفِيًّا فَأَحْبَبْتُ أَنْ أَعْرَفَ فَخَلَقْتُ الْخَلْقَ أُعْرَفَ

“Unë isha një thesar i fshehtë, desha të njihem dhe, pra, e krijova këtë gjithësi!” (I. Haki Bursevi, Kenz-i Mahfi)

Ja, pra, Zoti nuk deshi që kjo bukuri enigmatike, transcendente dhe përtej njohjes njerëzore të mbetet e fshehtë dhe e krijoj gjithësinë!

Në këtë krijim, kjo gjithësi ku përfshihet edhe bota jonë, mori si pjesë një pikë nga deti i dritës dhe bukurisë së Tij. Kështu, toka fitoi një përparësi dhe cilësi të ndryshme nga qeniet e tjera, ashtu që njeriun që e krijoj si qenien më të nderuar mes të gjitha qenieve, Allahu i Lartë e krijoj prej toke, prej dheu!

Allahu (xh.xh.) që i ka krijuar me dashuri hyjnore të gjitha qeniet, e bëri secilën prej tyre argument dhe provë të artit dhe përsosmërisë së Tij. Ndërkaq, edhe qenia e njeriut si një mre-kulli e artit hyjnor, u bë shfaqje e përsosur e dashurisë dhe pasionit. Sepse synimi përfundimtar i krijimit dhe zbukurimit të gjithësisë dhe botës sonë, si pjesë e saj nga Zoti duke e nxje- rrë nga thesari i Tij i fshehtë, nuk kanë qenë vetëm fushat e gjera të gjelbëruara, luginat, shkretëtirat e pamata dhe malet e lartë, por njeriu, burimi i dashurisë dhe pasionit si pretekste të krijimit të tokës dhe të të gjitha krijesave, njeriu, thelbi i gjithësisë! Prandaj hirshmëria e njeriut është në përp-



jesëtim të drejtë me aq sa e ruan ai synimin përfundimtar të krijimit të tij.

Nga ana tjetër, ngaqë shkaku i krijimit është dashuria, në çdo gjallesë kjo cilësi paraqet një prirje të bashkëlindur. Fakti që edhe akrepi, madje, i bart të vegjëlit e vet mbi shpinë, është një rezultat dashurie. Ndërkaq, kjo prirje gjen kulmin e vet te njeriu, krijesa më e nderuar.

Dashuria për Allahun

Në këtë botë prove, njeriu arrin një rezultat në raport me dinjitetin e qenies për të cilën ndjen afërsi dhe dashuri ose pas së cilës shtihet. Prandaj ndodh që zemra e njeriut e krijuar me një kapacitet “etjeje” të pafund, mund të arrijë përsosmëri në dashuri vetëm nëse prirjen dhe cilësinë e bashkëlindur për të dashur dhe dashuruar e drejton kah Zoti, ndryshe, nuk mundet të shpëtojë së vrapuari pas synimesh të ulta e të kota! Jeta e njeriut merr fund përmes lëkundjesh disfatiste. Pra, njeriu zotëron dhuntinë e lartësimin moralo-shpirtëror në atë masë sa ç’ua kushton prirjen e natyrshme e të bashkëlindur për të dashur e dashuruar Allahut dhe të dashurve të Tij si dhe me aq sa ç’e ka nivelin e forcës së vet shpirtërore!

Me të vërtetë, provat hyjnore para të cilave vihet njeriu, kanë të bëjnë, në një aspekt, me mënyrën se si e përdor ai da-shurinë. Prandaj, Zoti i ka dhënë strukturës së njeriut, krahas prirjeve pozitive, edhe veçori negative. Në këtë drejtim, Zoti i ka dhuruar njeriut pjesë nga tre atributet e Tij të mëdha, *ekzistencë absolute*, *bukuri absolute* dhe *mirësi absolute* duke e çenuar atë, njëkohësisht, me të kundërtat e këtyre,



mosekzistencë absolute, shëmti absolute dhe e keqe absolute. Në Kur'an thuhet:

مُوتُوا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوا

“Allahu ia ka frymëzuar atij (njeriut) edhe të mirat, edhe të këqiat!” (esh-Shems, 8)

Ja, pra, dy pole diametralisht dhe pafundësisht të kundërta, njëri pozitiv e tjetri, negativ, ndaj tërheqjes së të cilëve njeriu jepet një jetë të tërë!

Vetëm se duhet ditur që prirja e madhe vërtet e sëmure për njeriun është kthimi kah poli negativ, sepse ata që prihen kah ky pol përjetojnë një verbëri të tillë, si pasojë e të cilës pëlqejnë vetëm veten dhe bëmat e veta, gjë që është një dobësi dhe paaftësi e madhe e cila bëhet pengesë për dallimin e dobësisë njerëzore, madje, është më e dëmshmjja e sëmundjeve shpirtërore. Kjo do të thotë që, duke mbetur i huaj për fuqinë hyjnore, të thuash, me iluzionin e fuqisë vetiake, “unë”, të tregohesh mendjemadh dhe krenar.

Prandaj, kuptimi i vërtetë që bart fjala

فَالْهَمَّهَا فُجُورَهَا وَتَقْوَاهَا

“vdisni para se të keni vdekur!”

është porosia për të mos rënë në kurthin e attributeve të këqia të polit negativ te njeriu dhe për të shpëtuar prej vorbullave të egos. Ndërkaq, metoda që duhet ndjekur për arritjen e kësaj nuk është vrasja e egos, por sundimi mbi të. Poeti Xheleddin Rumi, Mevlana, thotë:

“Kur uji ndodhet nën gjemi, bëhet mbështetje për të, por, kur i hyn brenda, e mbyt. Po kështu mund të themi edhe për zjarrin që



e vë anijen në lëvizje. Kur zjarri ndodhet nën kazanët e avullit, e shtyn anijen para, por, kur del nga nënkazanët dhe ngjitet në kuvertë, e djeg!”

Atëherë themi se në atë masë sa t'i zbresë në minimum atributet negative, në atë masë i afrohet njeriu Zotit të vet. Dhe faktori i vetëm për suksesin e kësaj është, pa asnjë dyshim, drejtimi vetëm kah Zoti me tërë kapacitetin e zemrës. Ndërkaq, kthimi i menjëhershëm i dashurisë për kah Zoti bart për njeriun shumë rreziqe. Vjen një çast që zemra të nisë të digjet sikur të kish rënë nën një tension të lartë, gjë që i përmbys jetën njerëzore dhe domosdoshmëritë e saj. Shfaqja që qe realizuar para profetit Musa është një shembull i bukur i kësaj.

Në malin Sina, Musai (a.s.) u bë bashkëbisedues i atributit eternal të Zotit, “fjalë”. Para tërheqjes së bisedimit tej njohjes njerëzore pa tinguj e fjalë me Zotin, ai e humbi kontrollin e vetvetes dhe kërkoi ta shohë Zotin. Por mori përgjigjen (لَنْ تَرَانِي) (ti nuk mund të më shohësh Mua!). Megjithëkëtë, Musai (a.s.) nguli këmbë. Atëherë Zoti ia bëri të ditur se do t'i shfaqej malit përballë. Dhe, nën ndikimin e një grimce drite nga Zoti përshkuar mes pengesash, mali mori flakë e u thërrmua. Para një dukurie të tillë, Musai (a.s.) u mpak dhe bëri pendesë.

Kjo shfaqje e madhe dhe e çastit që i kapërcen fuqitë edhe të një profeti të vendosmërisë së lartë, tregon për domosdoshmërinë e shkallëzimit në dashuri. Kapaciteti dhe prirja e zemrës ndaj dashurisë hyjnore duhen përgatitur dhe rritur gradualisht. Duke u shmangur dhe çliruar prej faktorëve negativë dhe prej të gjitha lidhjeve dhe prirjeve materiale, tokësore, egoistike e të vdekshme, zemra kthjellohet, fiton



nivel dhe fiton aftësinë për të qenë si një pasqyrë e shkëlqyer e cila sheh, njeh dhe pasqyron afërsinë dhe dashurinë hyjnore.

Prindërit, gruaja, fëmijët dhe dashuria për ta, mundësitë materiale e shpirtërore dhe të mirat e tjera të kësaj bote janë një favor i madh i Zotit për robtë e vet. Por të gjitha këto duhet të jenë mjete për t'u afruar te Zoti dhe jo objekte të dashurisë. Ata që e dashurojnë "Bukurinë Absolute", nuk mund t'i dashurojnë imtësitë dhe relativitetet. Mevlana i thotë:

"Ata që ia falin zemrën kësaj bote, i ngjasin gjahtarit që gjuan hijet. Ç'mund t'u japë hija atyre?"

Kështu, një budalla deshi ta kapte hijen e një zogu. Por edhe zogu që qëndronte në degë, u habit me këtë!"

Bukuria Absolute është bukuria e Allahut. Kurse të gjitha bukuritë e tjera që i shohim me mahnitje, janë vetëm grimca të reflektuara nga bukuria hyjnore.

Aventura dashurore mes Mexhnunit dhe Lejlasë është një shembull kryevepër e kësaj të vërtete. Po qe se zemra e Mexhnunit do të mbetej te Lejlaja, ajo do të bëhej idhull për të. Kurse Mexhnuni, megjithëse doli në rrugë pas Lejlasë, arriti të ngjitej në nivelin e partnerit të dashurisë hyjnore. Atëherë, në sytë e tij, Lejlaja ra!

Të gjitha afërsitë dhe dashuritë janë legale me aq sa është kapaciteti i qenies së cilës i drejtohen. Ndërkaq, duhet që këto afërsi dhe dashuri të mos bëhen një seli absolute për zemrën, stacioni i fundit për të e të konkludohen me vetëmashttrim e humbje.



Kur Jusufi që bartte në ballë dritën muhammediane, u hodh në pus, Allahu (xh.xh.) e mbrojti atë, nuk e la të humbte. Ndërkaq, udhëtari i rastit që e gjeti dhe e nxori atë nga pushi, i mahnitur pas bukurisë së pashoqe që i doli para, nuk pa dot në të bukurinë jomateriale, shpirtërore që fshihej pas saj dhe e shiti!

Fakti që para bukurisë së Jusufit udhëtari i etur e harroi ujin, qe një rast për të, por, i gënjyer nga përfitimi material që do të kishte, ai e humbi këtë rast!

Ajo që u përpoqëm ta parashtrojmë dhe shpjegojmë këtu, është orientimi ideal për të arritur në afërsi dhe dashuri përfitimin maksimal. Kapërcimi pa u penguar i etapave të afrimit të Zotit dhe të dashuria hyjnore qëndron mbi mundësitë e shumicës së njerëzve. Për të veçantët, rezultati përfundimtar për ta është kthimi të Zotit, domethënë ajo që quhet “fena fil’lah”, humbje e qenies vetiake në qenien e Zotit ashtu siç humb lumi në det, gjë që është “beka bil’lah”, pavdekshmëri të Zotit, fitimi i pavdekshmërisë së qenies tënde pranë Zotit! Duhet të dihet se kufiri i mendjes është i përcaktuar; përtej atij kufiri vjen çmenduria. Kurse kufiri i zemrës, i ndjenjave, është i pafund. Ndërkaq, pika e qetësisë është “fena fil’lah” dhe “beka fil’lah”. Mevlanai, poeti Xhelaleddin Rumi, thotë se, në gjendjet “fena fil’lah” dhe “beka fil’lah”, zemra merr flakë nga dashuria pasionante hyjnore dhe këtë flakë nuk mundet ta shuajë as vdekja!

“Pasi të kem vdekur dhe të jem varrosur, hapmani një ditë va-rin e do të shihni se si më ngrihen tymëra nga qefini për shkak të zjarrit që më digjet brenda! Ky, kafazi-kurm është ai që e bën vdekjen të frikshme! Kur ta thyesh kurmin, si një guackë të sedeftë, me



anë të dashurisë hyjnore, do të shohësh se vdekja brenda tij i ngjan margaritarit që fshihet brenda guackës së sedeftë!..”

Për veten e vet, Mevlanai thotë kështu:

“Mua më duhet një ashk i tillë (një dashuri pasionante e tillë) që, nga flaka brenda tij të shpërthejnë kiamete, që nxehtësia e zemrës t’i shuajë e bëjë hi edhe zjarret!”

Ka dy lloje dashurish pasionante: iluzive e të vërtetë.

Dashuria dhe të shtënët pas një qenieje çfarëdo nga gjërat e zakonshme (vanitetet) e kësaj bote, quhet “dashuri pasionante iluzive”, kurse afërsia e thellë dhe lidhja ndjesore e ndjerë për Zotin e gjithësisë, bukuria e të cilit është përsosmëri dhe përsosmëria, bukuri, quhet “dashuri pasionante e vërtetë”.

Perdja e madhe e vënë mes Zotit dhe robit, domethënë pengesa apo pengesat që e bëjnë të pamundur ose të vështirë komunikimin mes tyre, nuk janë sendet apo largësitë e tilla si toka dhe qiejt. Kjo perde është, më tepër, ndjenja e njeriut (e frymës apo egos së tij) se është një qenie e veçantë prej Zotit. Prandaj Zoti urdhëron:

“... dhe kur i fryva prej shpirtit tim, ...” (el-Hixhr: 29)

Me këto fjalë Ai ia kujton njeriut margaritarin sublim që ia ka dhënë prej vetes.

Edhe shprehja e mëposhtme e ndjerë shpirtërisht nga lartësia e Zotit prej të shquarit Abdylkadir Gejlani, është një formë tjetër e të vërtetës së urdhëruar më lart:

“Unë jam enigma e njeriut...” (Fususu’l-Hikem I, 48)

Sipas kësaj, mund të themi se thesaret dhe enigmat hyjnore i përkushtohen njeriut. Allahu (xh.xh.) kërkon ta trego-



jë qenien e Tij sublime në strukturën e shenjtë të njeriut; duke thënë se “është enigma e njeriut”, jep lajmin e gëzueshëm për ta gjetur Atë në karakterin njerëzor. Po qe se ky margaritar sublim dhe ky lajm i gëzueshëm arrin ta bëjë besimtarin të arrijë përsosmërinë si rezultat i afërsisë dhe dashurisë pasionante të ushqyer për Zotin, atëherë zemra fillon të afrohet drejt botës enigmatike hyjnore, dalin në shesh enigmat e botës hyjnore, e vërteta e materies, enigma e quajtur njeri dhe gjithësi, robi bëhet i merituari i shfaqjeve të zemrës së pastër.

Kur robi arrin këtë pjekuri, perdja e moskomunikimit mes tij dhe Zotit fillon të hapet dhe robi merr pjesë nga enigma, “të vdesësh pa vdekur”, bota dhe dashuria vdekëtare për të, e gjithë bukuria kalimtare dhe për dukje e saj i bien robit nga syri dhe i dalin prej zemre. Kështu, shpirti meriton shijen dhe kënaqësinë e papërshekruar të afrimit me Zotin e vet, nga gjuha i derdhen këto vargje të poetit Junus Emre:

*Sofive u duhet bisedë,
Miqve u duhet tjetra jetë,
Mexhnunit, Lejlaja vetë;
Mua, Ti, më duhesh Ti!*

Për zemrën që ka arritur në këtë nivel, nuk ka qetësim tjetër veç bashkimit sublim. Vargjet e mëposhtme të shenjtorit të madh, Hydaji, janë tingëllime të pasionit hyjnor që e reflektojnë këtë situatë:

*Bukurinë hyjnore zemra kërkon,
Ndryshe, nuk dëfren, nuk dëfren!
Qetësimin e bashkimit hyjnor kërkon,
Zemra nuk dëfren, nuk dëfren!*



*Ky shpirt që gjeti dashuri,
Ç'e do pasurinë prej Sulejmani;
Çasti i dashurisë e la në habi,
Zemra nuk dëfren, nuk dëfren!*

*As në vetmi, as në shoqëri,
As në shumëllojshmëri, as në njësi,
As në Tuba, as në të parajsës bukuri
Zemra nuk dëfren, nuk dëfren!*

*Po qe kjo botë, po qe ajo botë,
Bashkimi juaj, një dashuri e kotë;
Hydajiu ç'të bëjë, o Zot,
Zemra nuk dëfren, nuk dëfren!*

Këto situata dhe shprehje janë shfaqje sublime të lartësisë së dashurisë pasionante për Zotin, të mbështjelljes së zemrave me të, të kthimit të robit kah Zoti me dashuri gjithnjë në rritje duke hequr dorë nga gjithçka si dhe të mbajtjes së këtij kthimi mbi çdo gjë tjetër! Shkurt, janë shfaqje të ajetit:

وَالَّذِينَ آمَنُوا أَشَدُّ حُبًّا لِلَّهِ

“Besimtarët (e formuar) e duan Allahun me një dashuri shumë të fuqishme...” (el-Bakara: 165)

Dashuria për Profetin (s.a.s.)

Duhet të dihet se burimi i vetëm i mëshirës dhe dashurisë që çojnë në detin e afërsisë dhe dashurisë për Allahun, është profeti ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.), ashtu që dashuria për Profetin është dashuri për Allahun, bindja ndaj Profetit



është bindje ndaj Allahut, kundërshtimi ndaj Profetit është kundërshtim ndaj Allahut. Sipas kësaj, qenia e shenjtë e Profetit është për njeriun një strehë dashurie. Njerëzit e pajisur me kulturën shpirtërore e dinë se shkaku i ekzistencës së qenies është dashuria për Muhammedin. Prandaj, e tërë gjithësia i është dedikuar Dritës së Qenies, Hz. Muhammed Mustafa (s.a.s.)!

Kështu, Zoti, si krijesë të parë ka krijuar **Dritën Muhammediane**, sepse shkaku i dytë, pas dëshirës hyjnore, i krijimit të kësaj bote shumëllojshmërie është që ajo ta veshë Dritën Muhammediane. Prandaj, Drita Muhammediane është dhurata e madhe hyjnore e Zotit për gjithësinë dhe robtë e Tij. Drita Muhammediane është mjedisi i shfaqjes së parë të së vërtetës hyjnore. Drita Muhammediane është një burim shfaqjesh të së vërtetës së individualitetit hyjnor e zbritur për botën tonë dhe në përputhje me kushtet e saj.

Kjo mrekulli krijimi, Krenaria e Gjithësisë, profeti ynë, Hz. Muhammedi (s.a.s.) është e pamundur të konceptohet përsosmërisht brenda mundësive njerëzore. Për rrjedhojë, deklarata mbi cilësinë e tij të lartë mbyllet në pafundësinë e heshtjes. Kurse e vërteta e tij që reflektohet në zemrat besimtare, është sa një centimetër kub në det. Sepse Drita Muhammediane, krejt si **“Shtëpia e Allahut”**, është një shfaqje e të vërtetave tej mendjes dhe shpjegimit, të futura në nivelin e njohjes njerëzore.

Ashtu siç e shprehim edhe në Fjalën e Dëshmisë, gjithëse ai është, në dukje, një **rob**, por ne nuk duhet të përpiqemi ta mbushim këtë konceptim në dukje për të me konsideratat tona të zakonshme për njeriun në përgjithësi si rob të Zotit,



sepse njohja jonë përballë të vërtetës muhammediane nuk ka ndryshim prej njohjes feminare përballë dukurive metafizike ngaqë Hz. Muhammedi (s.a.s.) është një **i dërguar** (resul) i zgjedhur mes robve e i bërë kurorë e gjithësisë, madje një i dërguar i tillë që emrat e të gjithë profetëve janë bashkuar në emrin e tij të bekuar. Legjislacioni i sjellë nga të gjithë profetët, domethënë feja që e ndan të mirën nga e keqja, ka gjetur përsosmërinë me Legjislacionin Islam të sjellë prej tij!

Për njerëzit e shquar, të mirë e të drejtë, për miqtë e Zotit, për profetët thuhet fjalë të mira, mbahen hutbe e bëhen lutje dhe këto vazhdojnë e ata kujtohen edhe pas vdekjes, sepse vdekja nuk e shuan emrin e tyre ashtu siç shuhet nga skena e historisë sundimtarët së bashku me shtetet e tyre. Në Kur'an thuhet:

الْآنَ اَوْلِيَاءَ اللّٰهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Dijeni mirë se për miqtë e Allahut nuk ka frikë dhe ata s’kanë për t’u dëshpëruar!” (Junus: 62)

Dhe në ballë të radhëve të formuara nga këta shpirtra të çmuar, është kurora profetike, Hz. Muhammed Mustafai (s.a.s.)!

Nisur nga kjo, ndërsa emri i çdo “mbreti” në dukje fshihet e harrohet, emri i nderuar e i bekuar i mbretit të kësaj bote dhe ahiretit, botës së pasme, Hz. Muhammedit (s.a.s.), ekziston amshueshmërisht në tokë, në qiej e në zemra. Atëherë themi se jo emrin e mbretërve të kësaj bote dhe të mbretërve të tyre, por emrin e atij mbreti të pashoq të ulur në fronin e pavdekshmërisë duhet ta shkruajmë ndër zemra me shkri-



min e pafshirshëm të dashurisë për të në mënyrë që zemrat të mund ta ruajnë vlerën e lartë që u jepet.

Në Kur'an, ajeti si më poshtë është realizuar për politeistët:

وَمَا كَانَ اللَّهُ لِيُعَذِّبَهُمْ وَأَنْتَ فِيهِمْ

“(O i Dërguar!) Përsa të jesh ti mes tyre, Allahu nuk ka për t’i ndëshkuar ata!..” (el-Enfal: 33)

Konvencionalisht, kjo do të thotë se për besimtarët që e mbajnë në zemër atë Dritën e Qenies, ka përgëzime dhe shpërblime të mëdha. Kjo do të thotë se me sa të mbushet zemra e një robi besimtar me dashurinë për Profetin (s.a.s.), aq largohet nga ndëshkimi hyjnor. Ky është një premtim i madh i Zotit. Kështu, pra, po qe se në zemrat tona është Profeti (s.a.s.), Zoti ynë nuk do të na ndëshkojë e nuk do të na shkatërrojë!

Bukuritë kërkojnë ta shohin veten në pasqyrë. Ato kërkojnë sy e zemër që t’i shohin e t’i duan. Kjo është edhe enigma e krijimit të gjithësisë dhe njeriut nga Zoti, Bukuria Absolute. Prandaj Ai ka thënë:

كُنْتُ كَنْزًا مَخْفِيًّا فَأُحِبُّتُ أَنْ أُعْرَفَ

“Unë isha një thesar i fshehtë që desha të njihem e të duhem...”
(I. Haki Bursevi, Kenz-i Mahfi)

Meqë fillimi i krijimit mori sendërtim me dritën e Profetit (s.a.s.), të gjithë profetët e shfaqur mbi tokë me Hz. Ademin në krye, kanë bartur begatinë e dritës së tij.

Mevlanai shprehet kështu:



“Vetëm me hapjen e një krahu, Xhebraili i pati përfshirë edhe lindjen, edhe perëndimin. Kur e pati parë Profeti këtë, duke menduar për madhësitinë e Atij që ia kishte dhënë këtë mundësi Xhebrailit, humbi ndjenjat dhe u mpak.

Por po qe se Profeti (s.a.s.) do ta hapte atë krahun që s’ta merr mendja të së vërtetës muhammediane, Xhebraili do t’i humbte ndjenjat përjetësisht, për të mos ardhur më në vete!

Kështu, kur i dashuri i Allahut së bashku me Xhebrailin patën arritur në Sidreti Munteha, Xhebraili pati qëndruar dhe i pati thënë atij kështu: “O i Dërguari i Allahut! Ti urdhëro e vazhdo se unë s’jam i barabartë me ty. Edhe sikur një hap të hedh më tej, digjem e bëhem hi!”

Jeta e sahabeve, shokëve të Profetit (s.a.s.) është e mbushur plot shfaqje dashurie të jashtëzakonshme për të. Ai pati thënë:

الْمَرْءُ مَعَ مَنْ أَحَبَّ

“Njeriu rri bashkë me atë që do...” (Buhari, Edeb, 96; Myslim, Birr, 165)

Natyrisht, me kusht që ta dojë sinqerisht, t’i bindet dhe t’i nënshtrohet...

Kur vdiq Profeti, dëshpërimi i shokëve arriti në kulm. Ata u bënë pothuaj si qiri i tretur, sepse mendonin se zemrat e tyre të dashuruara pas tij që nuk mund të rrinin asnjë ditë pa e parë, nuk do ta shihnin dot më atë në këtë botë! Ja, pra, duke mos e duruar këtë ndarje dhe dëshpërim, Abdullah bin Zejdi (r.a.) i hapi duart me zemër të djegur drejt selisë së lartë për t’u lutur:



“O Zot! Merrmi sytë tani! Pas vdekjes së Profetit tim që e kam dashur më shumë se çdo gjë, nuk dua të shoh më ndonjë gjë tjetër në këtë botë!..”

Dhe iu verbuan sytë aty për aty!

Afërsinë dhe dashurinë e gjerë të sahabeve, shokëve të Profetit për të është e pamundur ta shpjegosh me mundësitë e kufizuara të fjalëve! Ja disa shembuj nga deti i shembujve të panumërt.

Enesi (r.a.) tregon:

“E pashë të Dërguarin e Allahut që po e qethte berberi. Shokët e kishin vënë në mes dhe nuk linin të binte në tokë as edhe një fije floku!”

Me gjërat dhe fijet e flokëve të Profetit, shokët e ndjenin veten të bekuar e të begatuar. Ata i patën marrë me vete këto gjëra edhe në luftë. Shembulli më i bukur i kësaj është rasti i Halid b. Velidit që kishte fshehur nën çallmë disa fije floku nga të Profetit. Siç rrëfëhet, në luftën e Jermukut, Halid b. Velidi e humbi çallmën dhe i urdhëroi ushtarët t’ia gjejnë:

“Kërkojeni atë!” – i urdhëroi ai ushtarët.

E kërkuan por nuk e gjetën dot. Halid b. Velidi dha urdhër përsëri për ta kërkuar dhe e gjetën. Por panë se ishte një çallmë e vjetër! Shokët u habitën që Halid b. Velidi nguli këmbë aq shumë për një çallmë të vjetër! Atëherë ai u tha:

“I Dërguari i Allahut i pati prerë flokët. As’habet morën të gjithë nga ato flokë. Edhe unë mora disa fije dhe i futa nën çallmë që më dha aq shumë mbarësi, sa të gjitha luftërat ku u futa me këtë në kokë, i fitova! Sekret i fitores



sime është dashuria ime për të Dërguarin e Allahut!" (Sujuti, el-Hasaisu'l-Kubra, I, 170)

Një shembull tjetër.

Mbrojtësi i famshëm i Medines, pashai osman Fahreddin Pasha, gjatë meremetimit të varrit profetik, me frikën se mos çenohet fryma shpirtërore e të Dërguarit të Allahut, i porosit ustallarët e ngarkuar me detyrën e meremetimit që, po të duhet të ngulet diku ndonjë gozhdë, të përdorin pa tjetër çekiç prej druri dhe mes çekiçit dhe gozhdës të vendosin bandazh llastiku për të mos e prishur heshtjen e mjedisit. Ajeti kur'anor që e pati shtyrë atë të tregonte një delikatesë dhe edukatë të tillë, është kështu:

"O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin mbi zërin e Profetit! Mos i folni Profetit me të bërtitur ashtu siç i flisni njëri-tjetrit, sepse mund t'u shkojnë punët kot pa e kuptuar as ju vetë!" (el-Huxhurat: 2)



Afërsia dhe dashuria për të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) janë të pastra nga rreziku i prirjes ndaj një qenieje nga ato që i quajmë vanitete. Prandaj është e domosdoshme që ai të duhet me të gjithë fuqinë e zemrës. Hz. Fatimeja (r. anha) që përbën një shembull kulmor në këtë dashuri, e përshkruan kështu gjendjen e saj pas kalimit të Profetit në jetën tjetër:

"Me kalimin e Krenarisë së Gjithësisë në jetën tjetër, mbi mua ra një fatkeqësi e tillë që po të binte mbi errësirën, ngjyra e saj do të ndryshonte!" (Sahih-i Buhari Muhtasari, IV, 45)

Shfaqja më e bukur dhe kuptimplote e dashurisë për Profetin (s.a.s.) është respekti dhe konsiderata për të. Në Kur'an thuhet:



وَأَقِيمُوا الصَّلَاةَ وَآتُوا الزَّكَاةَ وَأَطِيعُوا الرَّسُولَ لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Falni namaz, jepni zeqat dhe bindiuni Profetit që të gjeni mëshirë!” (en-Nur: 56)

Nga ana tjetër, sipas parimit “ai që do, do çdo gjë të atij që do”, është kusht që Profeti të ndiqet në sjelljet, qëndrimet dhe aktet e tij. Ky kushtëzim rrjedh nga fakti që afërsia, dashuria dhe ndjekja e Profetit në këto aspekte, përbëjnë shtyllën kurrizore të afërsisë dhe dashurisë për Zotin. Në të kundërt, çdo pretendim dashurie është quajtur i pavlerë në rrugën e Kur’anit dhe Sunnetit. Dhe e vetmja rrugë për të arritur te Individualiteti i Lartë është përcaktuar me anë të dashurisë ndaj Profetit.

Fryma shpirtërore në adhurim, eleganca në veprim, mirësjellja në moral, brishtësia në zemër, drita në bukuri-në e fytyrës, rrjedhshmëria në gjuhë, delikatesa në ndjenja, thellësia në shikim, shkurtimisht, të gjitha këto bukuri janë shkëlqime që u reflektohen zemrave prej dashurisë për Dritën e Qenies!

Poeti Mevlana shprehet kështu:

“Eja, o zemër! Festa e vërtetë është bashkimi me Muhammedin, sepse ndriçimi i gjithësisë është nga drita e bukurisë së asaj qenieje të bekuar!”

Për rrjedhojë, dashuria për të Dërguarin e Allahut (s.a.s.) është maja më e lartë që mund të arrijë njeriu në rrugën që shkon për te dashuria për Allahun. Sepse Allahu i Lartë u ka përcaktuar një kufi të gjitha kapaciteteve njerëzore, përfshi njohjen dhe konceptimin. Kurse Individualiteti Hyjnor është tej e përtej këtij kufiri...



Dashuria për njerëzit e zgjedhur dhe të gjithë besimtarët

Allahu i Lartë urdhëron:

إِنَّمَا وَلِيُّكُمُ اللَّهُ وَرَسُولُهُ وَالَّذِينَ آمَنُوا الَّذِينَ يُقِيمُونَ الصَّلَاةَ
وَيُؤْتُونَ الزَّكَاةَ وَهُمْ رَاكِعُونَ

“Miqtë tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari dhe besimtarët, ata që, duke iu bindur urdhrave të Allahut, e falin namazin drejt dhe e japin zeqatin!” (el-Maide: 55)

Në ajet tregohet qartë se kush janë njerëzit të cilët duhet t’i dojë e t’i bëjë miq besimtari:

- Allahu (xh.xh.)
- I Dërguari i Allahut (s.a.s.)
- Të bindurit ndaj Allahut, njerëzit e mirë dhe të gjithë besimtarët.

Orientimi i dashurisë kah Allahu (xh.xh.) kërkon të duhen, në fillim Drita Muhammediane, pastaj qenia e shenjtë e Profetit (s.a.s.), miqtë e Zotit dhe, pastaj, duke e zgjeruar këtë si rrathë koncentrikë, çdo qenie të vlefshme e të pranueshme në lartësinë e Zotit sipas nivelit të vlerës dhe pranueshmërisë së saj. Kështu, një rreth i tillë dashurie në orientimin kah Zoti bëhet për shpirtrat një burim shërimi dhe mëshire. Kurse afërsitë dhe dashuritë e mbetura jashtë këtij rrethi e dobësojnë lo-gjikën përkatëse që sundon në ato dashuri. Prandaj, në afërsinë dhe dashurinë ndaj Profetit (s.a.s.) dhe miqve të Zotit që janë trashëgimtarët e tij, ka begati, kurse në përbuzjen ndaj tyre ka pendim në këtë botë dhe në jetën e pasme, ahiret!



Në një hadith të shenjtë, Zoti urdhëron:

مَنْ عَادَى لِي وَلِيًّا فَقَدْ آذَنَّهُ بِالْحَرْبِ

“Atij që i bën armiqësi robit Tim të zgjedhur, edhe Unë i shpall luftë...” (Buhari, Rikak, 38)

Veçanërisht, fakti që Zoti urdhëron në Kur’an si më poshtë në një mënyrë që i përmbledh të gjithë besimtarët, duhet t’ia tërheqë vëmendjen çdo besimtari:

“Ata janë të mëshirshëm ndaj njëri-tjetrit...” (el-Feth: 29)

Edhe përkufizimi i moralit të bukur si *“t’i shkosh atij që s’të vjen, t’i japësh atij që s’të jep dhe ta falësh atë që të bën keq”* (Ihyau Ulumiddin, III, 1151) është, në këtë çështje, një orientim.

Sipas kësaj, në marrëdhëniet mes tyre, besimtarët kurrë s’duhet të dalin jashtë këtij rrethi mëshire, afërsie e dashurie. Sepse kjo është rruga e dashurisë ndaj Allahut dhe e sendërtimit të afërsisë ndaj Tij. Kështu, edhe virtytet dhe vlerat e prijësve të mëdhenj shpirtërorë në lartësinë e Zotit përqëndrohen, krahas në moralin e bukur dhe adhurimin, edhe në vështrimin e gjithë krijesave me sy të dhembshur dhe trajtimin e tyre me mëshirë dhe dashuri. Prandaj ndodh që në Kur’an është urdhëruar shoqërimi me njerëzit e mirë dhe atyre u është dhuruar nderi të jenë trashëgimtarë profetikë.

Është për këtë arsye që, nëse një njeri merr pjesë, përfiton nga e vërteta dhe drita e Profetit (s.a.s.) duke e parë atë si mik të Zotit dhe ndërmjetës, kjo gjë vlerësohet sikur ta kishte marrë personalisht prej vetë Profetit (s.a.s.). Krejt si ndezja e një qiriri me anë të një qiriri tjetër të ndezur... Flaka që ndez një kandil dhe që, pastaj, me anë të tij, u përçohet të gjithë kandilëve të tjerë duke bërë të ndriçohet tërë mjedisi përka-



tës, është po ajo flakë e parë. Edhe robi, njeriu që ndriçohet nga kandili i fundit, merr dritë nga burimi i parë. Për rrjedhje, po qe se një njeri jepet i vetëdijshëm apo jo pas një bukurie hyjnore që shndrit te një person tjetër, bukuria ndaj të cilës ai mahnitet dhe pasionohet është bukuria e Zotit, është reflektimi mrekullor i saj te njerëzit dhe qeniet e tjera. Pa asnjë dyshim, shfaqja më e madhe e këtij reflektimi është realizuar te Profeti (s.a.s.). Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) është ura e vetme e mëshirës dhe e bashkimit!

Në Mesnevi thuhet:

“Allahu i pëshpëriti resë në vesh një të fshehtë dhe nga sytë e resë u zbrazën lot si lumë; i pëshpëriti trëndafilin në vesh një të fshehtë dhe trëndafili u zbukurua me mbretërinë e aromave e ngjyrave; i pëshpëriti gurin në vesh një të fshehtë dhe guri u kthye në perlë të fshehur mes mineralit; me një fjalë, u shfaq me atributin e bukurisë dhe hijeshisë dhe lëshoi ujë nga reja, i dha trëndafilin bukuri dhe gurin vlerë prej margaritari!

I dha trupit të njeriut një të fshehtë dhe njerëzit që e ruajtën atë të fshehtë, i lartësoi në pavdekësi! Njerëzit që morën frymëzim nga bota hyjnore, duke u shkëputur nga kurmi, arritën ta njohin enigmën e afërsisë ndaj Zotit!”

Pa asnjë dyshim, këto janë, në shfaqjet e tyre të ndryshme, nga një enigmë dashurie më vete, në klimën e të cilave janë të fshehura përsosmëria dhe bukuria e çdo gjëje.

Ja, pra, duke u mbujtur me enigmën e dashurisë, prijësat shpirtërorë janë bërë, gjatë gjithë historisë, pishtarë të përsosjes së besimit me anë të dashurisë, të maturimit të gëzimeve të shenjta në natyrën e krijimit të njeriut!



Zoti na e dhuroftë dashurinë e Profetit, njeriut më të dashur të Tij, dhe të atyre që ka dashur ai, si një favor të madh për ne!

Zoti mos na e marrtë amanetin pa u bërë ne njerëz punëmirë në atë shkallë sa të na mjaftojë për të na nxjerrë të pafajshëm në ahiret dhe pa na i ndriçuar zemrat me shfaqjet e madhështisë dhe shkëlqimit të dashurisë për Allahun!

Amin, ashtu qoftë!

W



Frymë dashurie nga Medina e Ndrithme

TRUNGU I HURMES QE QAN

Gjërat e jashtëzakonshme e të mahnitshme që vunë në shesh profetët në formën e mrekullive, kanë pasur për qëllim të krijojnë efekte për mënjanimin e shkujdesjes dhe paditurisë tek njerëzit në mënyrë që ata të kuptonin se ishin më asgjë se asgjëja dhe t'i bëheshin rob Zotit me një nënshtim të plotë!

Këto ngjarje mrekullore që e grisnin dhe mënjanonin shkujdesjen e njeriut, kanë për qëllim ta bëjnë të paaftë përceptimin dhe njohjen e të shkujdesurve, nga njëra anë, dhe ta bëjnë më konkret besimin e besimtarëve, nga ana tjetër. Të kësaj natyre janë shfaqjet e madhështimit të Zotit nga ana e jogja- llesave, bimëve e kafshëve, njohja e Profetit (s.a.s.) dhe prirja ndaj tij me dashuri nga ana e tyre.

Këto mrekulli janë shpalosur shumë e shumë herë krejtësisht hapur para syve dhe zemrave. Njëra nga më të njohurat prej tyre është vajtimi dhe rënkimi i trungut të hurmës për Profetin.

Dihet se, gjatë predikimit, Profeti mbështetej në një nga shtyllat e drunjtat të faltores. Dhe shtylla në fjalë që ishte një



trung hurmaje, e ndjente mbështetjen e Profetit dhe bëhej e lumtur për këtë.

Erdhi një ditë që sahabet, shokët e Profetit që merrnin pjesë në këto biseda e predikime, u shtuan aq shumë saqë një pjesë e mirë e tyre nuk e shihnin dot më Profetin në fytyrë, prandaj, me të drejtë, iu ankuan:

“O i Dërguari i Allahut, ngaqë jemi bërë shumë, nuk ta shohim dot fytyrën!”

Ata i kërkuan Profetit të bënte në faltore një vend të lartë ku të ngjitej për të folur. Ky vend i posaçëm që e kanë të gjitha faltoret, xhamitë, quhet *minber*.

Atëherë, në faltore u ngrit një minber. Aty e tutje, Drita e Profetësisë, Drita e Qenies do të ngjitej në minber e do të fliste. Por në rastin e parë që Profeti u ngjit në minber, ndodhi një mrekulli e papritur. Shtylla e hurmës ku mbështetej më parë Profeti kur bisedonte e predikonte, nisi të qante e rënkonte krejt si një njeri që ndjen, mendon dhe vuan nga ndarja dhe vetmia!

Ky vajtim dhe rënkim që aq i thellë, saqë e dëgjuan të gjithë besimtarët që ndodheshin aty, të rinj e pleq! Ndërkaq, vajtimi dhe rënkimi i trungut të hurmës u kthye në një gjuhë që e shprehte qartë vuajtjen e vet!

Të gjithë të pranishmit mbetën të mahnitur e të shtangur përballë një shprehjeje kaq të gjallë të vuajtjes nga një trung i thatë hurmaje! (Buhari, Menakib, 25; Byjy, 32)

Poeti Mevlana Xhelaledin Rumi, në vargjet e tij, e përkruan poetikisht kështu këtë ngjarje mrekullore:



“Profeti (s.a.s.) zbriti nga minberi dhe, duke e fërkuar trungun e hurmës me duart e tij të bekuara, e pyeti:

“O druri i hurmës, ç’kërkon? Pse qan? Pse rënkon?”

Dhe druri i hurmës nisi të fliste me gjuhën e vet. Mes lotëve të nxehtë, iu përgjigj:

“O i Dërguari i Allahut! Ndarja prej teje më ka djegur e për-vëluar. Zemra m’u mbush me një mall, dhimbje e hidhërim që s’ka të përshkruar! Unë jam ai trangu fatmirë e i lumtur ku më parë mbështeteshe ti për të folur e predikuar, kurse tani kam mbetur i vetëm sepse ti më braktise mua për t’u ngjitur në minber. Tani mbështetja jote është ai minber! Por, të lutem, ki mëshirë, më thuaj e më jep të drejtë, o i Dërguari i Allahut, cila qenie në këtë botë mund ta durojë ndarjen prej teje?”

Përballë vajtimit prej kësaj dashurie të brendshme të trungut të hurmës, Profeti i foli për ta ngushëlluar kështu:

“O druri i hurmës! Meqë vajtimi yt vjen prej hidhërimit të ndarjes prej meje, më kërkoi ç’të duash!..

A mos do t’i lutem Allahut të të bëjë ty një pemë të gjallë e të gjelbër që jep fruta për të gjithë njerëzit ç’janë në lindje e perëndim? Apo do të të bëjë ty një fidan xhenneti, një fidan seloie në xhennet që të mbetesh gjer në pafundësi i ri dhe i bukur si trupat më të rinj e më të bukur?..”

Dhe druri i hurmës që meritoi këtë kompliment, kërkoi nga Profeti (s.a.s.), si shprehje të dashurisë përvoëluese për të, këtë gjë:

“O i Dërguari i Allahut! Asnjërin prej këtyre gjërave s’dua! Dëshira ime e vetme është të shkrihem e humbem në qenien tënde! Prandaj, më merr e më gropos që të kalbem e të humbem e të shpëtoj nga ky trup i vdekshëm! Pema e re dhe e bukur e merr ushqimin nga



dielli dhe uji, kurse jeta ime u ushqye me bukurinë e bukurisë tënde, shijoi kënaqësinë e ngrohjes me ngrohtësinë tënde, kënaqësinë e të genit mbështetje për ty! E unë s'mund të ndahem dot nga kjo kënaqësi e këndshme dhe e ëmbël! Unë dua të mbetem kështu, përherë me këto ndjenja, me këtë kënaqësi, prandaj më gropos dhe më asgjëso në atë mënyrë që të ringjallet në dritën tënde të papërsëritshme për të mbetur i pavdekshëm!"

Dhe i Dërguari i Allahut vuri njerëz ta groposnin në tokë atë dru hurmaje që, në ditën e kiametit e të ringjallet, të ringjallet si njeri!"

Duke marrë shkak nga kjo ngjarje shembullore, Mevlanai jep këto këshilla në Mesnevinë e tij:

"Ta dish mirë, o lexues, se robi që favorizohet prej Zotit, duke mos u vënë veshin më dashuriëve kalimtare të kësaj bote, e kthen fytyrën nga Zoti që është synimi i vërtetë!"

O njeri i shkujdesur e i paditur! Pa shih nga mrekullitë e Musait dhe Ahmedit! Shih si u bë shkopi kuçedër e si u bë trungu i vetëdijshëm e rënko!

Të vërtetën e dashurisë nga një pemë ndjeje dhe merr shembull prej tij! Mos e dëno veten me dëshirat trupore e materiale të kësaj bote! Dhe dije se më e larta e pozitive dhe lumturisë së vërtetë është përtej kurmit, atje ku kurmi merr fund! Dije se lumturia e vërtetë duhet të kërkojë të shkëputet nga mashtrimet e kurmit të vdekshëm për t'u bashkuar me Zotin!

Është e çuditshme që një dru hurme të meritojë shefaatin, ndërmjetësimin e Profetit për falje, të zërë vend në zemrën e tij, duke mos u mashtruar nga kjo botë e përkohshme, të përkryhet si njeri i pjekur, t'i pranohet lutja, edhe pse është

një bimë, të arrijë një pozitë shpirtërore të paarritur dot nga sa e sa njerëz!

Ka shumë mundësi që, duke u frymëzuar nga kjo ngjarje, poeti Junus Emre ta bëjë të flasë kështu dollapin e drunjtë të mjerë:

*Mua më quajnë dollap i mjerë,
Uji më rrjedh paprerë, paprerë,
Zoti kështu paska thënë një herë;
E kam një hall pra rënkoj!*

*Më morën në mal si një pemë,
Pastaj duar e krahë m'i prenë
Dhe deshën si dollap të më kenë;
E kam një hall pra rënkoj!*

*Një dru i rritur në mal unë jam,
As i ëmbël, as i hidhur jam;
I shtënë pas Zotit tim jam;
E kam një hall pra rënkoj!*

*Dervish Junusi rënkon e qan,
Loti i syrit gjynahet i lan;
I dashuruar pas Zotit jam;
E kam një hall pra rënkoj!*

A s'merret mësim nga kjo, që sa e sa njerëz të cilët, megjithëse të krijuar me fytyrë e pamje njeriu e të pajisur me nderin dhe dinjitetin njerëzor të mbeten më të pandjeshëm se gurët e më të privuar se drurët për shkak se nuk arrijnë ta kuptojnë thelbin dhe të vërtetën njerëzore!



Kaq është e qartë se çdo njeri i ftuar nga Allahu në audiencën e Tij, e di se kjo botë është një urëkalim që duhet përshkuar me nder dhe dinjitet. Ai nuk ua lëshon veten shijeve mashtruese të kësaj bote, pasioneve që e thyejnë dinjitetin njerëzor. Ai bëhet udhëzues e pishtar i synimit drejt afërsisë dhe dashurisë hyjnore!

Vetëm personat me sytë e zemrës të verbuara dhe veshët e zemrës të zëna ndaj enigmave hyjnore nuk mundën të besojnë e nuk mundën ta kuptojnë si mund të flasë një dru apo një send çfarëdo e të tregojë të vërteta të panjohura!

Rregullsia dhe programimi i imtë hyjnor në gjithësi janë rezultat i urdhrit dhe porosisë “bëhu!”

Po qe se jogjallesat nuk do ta kishin dëgjuar dhe kuptuar urdhrin e Allahut “bëhu!”, atëherë kuptimi i sugjerimeve hyjnore nuk do të merrej vesh. Por, meqë të gjitha qenieve të gjalla e jo të gjalla iu dha urdhri “bëhu!”, do të thotë se urdhrat hyjnorë i dëgjojnë jo vetëm njerëzit, por edhe jogjallesat.

Djalli vë në zemrat e njerëzve të shkujdesur e të paditur një dyshim të akullt plot pandehma dhe ky dyshim ua ngrin atyre gjithë ndërgjegjen dhe vetëdijen. Edhe nëse sytë u shohin fizikisht, para kuptimeve dhe thellësive kuptimore u bëhen me perde. Kështu, djalli dhe egoja urdhëruese brenda tyre pothuaj i shtyjnë ata në një humnerë vetëvrasëse!

Qorrat e vërtetë nuk janë ata që i kanë të verbër sytë e kurmit, por ata që i kanë të mbyllur sytë e zemrës. Në fakt, ka njerëz të vërtetë me sytë e kurmit të verbër por me sytë e zemrës të hapur, për të cilët bota e përtejme është krejtësisht e dukshme!



Ja, kjo është urtësia më e lartë e Zotit që veten dhe urtësitë e veta ua tregon atyre që shohin me sytë e zemrës!

Përpjekja për të kuptuar se ç'thonë jogjallesat, për ta dë-gjuar apoteozën e degëve të pemëve me anë të një mendjeje të thatë, është një punë shterpë!

Ngjarja e mëposhtme ka një rëndësi shumë të madhe për ta shpjeguar shkujdesjen dhe paditurinë e njerëzve të tillë si Ebu Xhehli përballë zgjuarsisë së sendeve jo të gjalla!

Një ditë, Ebu Xhehlit ia tha mendja ta provonte Profetin. Fshehu gurë në pëllëmbë, shkoi te Profeti dhe i tha:

“A mund ta gjeshe se ç’kam në pëllëmbë? Po qe se je me të vërtetë profet dhe ke dijeni për të fshehtat e përtej qiejve, duhet t’i gjeshe menjëherë gjërat që i ke kaq afër!”

Profeti i tha:

“A unë të të them se ç’ke fshehur në pëllëmbë, apo ato të flasin e të dëshmojnë se unë jam profet i vërtetë? Për fuqinë e Zotit është shumë e thjeshtë t’i bëjë të flasin gjërat që ti ke në pëllëmbë. Po de-shi Zoti, të gjitha jogjallesat bëhen të gjalla e flasin si njerëz! Në fakt, sa e sa të fshehta mbi fuqinë dhe madhësitinë e Allahut iu zbulojnë ato njerëzve që kanë zemër! Kurse ti dhe ata si ti gjithsesi nuk kuptoni dot gjë nga gjuha e tyre!”

Ndërsa Profeti po thoshte kështu, gurët nisën të flisnin një nga një. Ata thanë Fjalën e Dëshmisë!

Ebu Xhehli u tremb shumë. Gurët i ranë nga dora. Fatkeqi i pandreqshëm, në vend që të shfaqte besimin e të shpëronte, thirri:

“Gënjeshtër, gënjeshtër!”

Dhe pastaj i tha Profetit:



“Nuk mund të ketë mbi tokë një magjistar që të matet me ty!”

Me këto thirrje mohimi dhe herezie, Ebu Xhehli u bë mohuesi më i mallkuar gjer në kiamet! Ai u largua përfundimisht nga mëshira hyjnore!

Një radhë, Profeti së bashku me Hz. Ebu Bekrin, Hz. Omerin dhe Hz. Aliun qenë ngjitur në malin Uhud. I trembur nga këta persona shpirtërorë që kishin qëndruar mbi të, mali Uhud u lëkund! Profeti i tha për ta qetësuar:

“Qetësohu, o Uhud! Mbi vete ke një profet, një besnik dhe dy dëshmorë!” (Tirmidhi, 3703; Nesai, Abas, 4/5, VI, 235)

Dhe mali i madh u qetësua!

Jo vetëm jogjallesat, por edhe kafshët dhe të gjitha qeniet e njihnin të Dërguarin e Allahut (s.a.s.), ndjenin dashuri për të dhe i bindeshin. Profeti ka thënë kështu:

“Me përjashtim të kundërshtuesve mes xhindve dhe njerëzve, të gjitha qeniet që ndodhen në qiej e në tokë, e dinë se unë jam i dërguari i Allahut!” (Ahmed bin Hanbel, Musned)

Të gjitha këto që thamë tregojnë se mrekullitë e shfaqura në bimët dhe trupat e tjerë nuk janë të posaçme vetëm për tru-ngun e hurmës!

O Zot! Na jep edhe neve pjesë nga dashuria e trungut të hurmës që qan nga dashuria për Mikun Tënd!

Amin, ashtu qoftë!

NJERIU I PERKRYER

Siç rrëfëhet, Isai (a.s.) hasi në një person me njolla në trup dhe me tëmthat të rëna. Duke i shpërfillur sëmundjet nga të cilat vuante dhe që, me sa dukej, ishin të shumta, ai thoshte:

“O Zot! Falënderime të pafund Ty që më ke shpëtuar nga mjerimi që i ka zënë shumicën e njerëzve!..”

Për ta hetuar cilësinë dhe pjekurinë e mendimit të atij njeriu, Isai (a.s.) e pyeti:

“O njeri! E nga ç’mjerim mund të të ketë shpëtuar Zoti ty?”

I sëmuri iu përgjigj:

“O shpirt i Zotit! Sëmundja dhe mjerimi më paralizues është shkujdesja e zemrës dhe shkëputja e saj nga Zoti! Lavdi pastë Zoti që më ka ruajtur nga kjo! Sepse unë jam i kënaqur me shijen dhe gëzimin e njohjes dhe afërsisë hyjnore që Zoti m’ia ka falur zemrës! Përveç Tij, të mirat e kësaj bote as që i shoh e i ndjej madje!



Njeriu, për të cilin Zoti ka thënë se e ka krijuar si “krijesë të përsosur”, është, pothuaj, si thelbi apo fara e gjithësisë,



sepse njeriu është qenia e vetme që ka marrë pak a shumë pjesë nga të gjitha atributet e Zotit te i cili bashkohen të gjitha kundërshtitë. Kjo është edhe urtësia e faktit që njeriu cilësohet si “krijesë e nderuar”.

Kështu, njeriu, aq sa është i pajisur me attribute bukurie që e lartësojnë atë në nivelet më të larta, po aq karakterizohet edhe me cilësi negative që e ulin dhe e poshtërojnë gjer në nivelet më të ulta. Jeta e njeriut është skena e një lufte të përvetshme, si rezultat i së cilës ai pozicionohet në një pikë të caktuar mes këtyre dy poleve. Kjo e vërtetë është një shfaqje e luftës së ngjashme që zhvillohet në makrokozmos, te njeriu që quhet “mikrokozmos”. E veçanta esenciale që e bën njeriun njeri, është aftësia e tij për të marrë nga kjo luftë një rezultat i cili e mbron elementin esencial në krijimin e tij.

Ja, pra, “njeri i përkryer” është emërtimi i përbashkët i atyre që shquhen në këtë mënyrë!

Njerëz të tillë janë një ekspozitë delikatesash dhe një mrekulli arti, janë përmbledhja e librit të gjithësisë, introdukta e tij si dhe mjedisi ku shfaqet enigma e krijimit.

Edhe kurmi i njeriut të përkryer, madje, është, në saje të sundimit të tij mbi gjymtyrët e veta, një skenë e shfaqjeve të gjërave të larta në zemrën e vet e cila, nga ana e saj, është mjedisi i konfidencës, intimitetit dhe dashurisë ndaj Zotit, është, pothuaj, pallati madhështor i thesarit të intuitës hyjnore! Pra-ndaj, në një kuptim, zemra e njeriut të përkryer është bërë Shtëpia e Zotit!

Njeriun e përkryer është tepër e vështirë për ta kuptuar dhe shpjeguar siç duhet.

Saadiu thotë:



"Zemra është vendvështrimi i Allahut që është tejet i madh!"

Fjalët e njeriut të përsosur janë urtësi dhe enigma, vepri-
met e tij janë të pastra, të mira. Ai ka marrë pjesë nga klima
ndjesore e Profetit (s.a.s.). Me strukturën e tij ndjesore, ai është
një përsosmëri estetike krijimi, sepse konfidenca me Zotin
dhe cilësia e të qenit zëvendës i Zotit mbi tokë janë të mun-
dura vetëm me një zemër të pastër e të mirë!

Njeriu i përkryer është bërë mishërim i enigmës:

"Fjalët i kam shariat, punët, tarikat, gjendjen, hakikat!"¹

Në hadithin profetik thuhet:

*"Allahu ka enë nga banorët e tokës. Këto enë të Zotit janë zem-
rat e robve të Tij të mirë. Më e pëlqyera te Zoti është më e holla dhe
më e buta prej tyre!"* (Taberani, Musnedu'sh-Shamijun, II, 19)

Duke u nisur nga kjo porosi profetike, disa janë shprehur
figurativisht kështu:

*"Ajo që s'e nxënë tokë e qiej, ndodhet në zemrën e besimta-
rit!"*



Si fluturat që vërtiten rreth dritës, njeriu i përkryer, me
konfidençën dhe dashurinë ndaj Zotit, e humb vullnetin e
vet, domethënë, Zoti bëhet syri që i sheh dhe veshi që i dë-

¹ Këtu, me *shariat* kuptohet legjislacioni islam i mbështetur në Kur'anin dhe Traditën Profetike të profetit Muhammed ose vetë ato; me *tarikat* kuptohet pluralizmi i mendimit në islam, jo ajo lloj dasie dhe praktike destruktive që nënkuptohet shpesh kur përmendet fjala *tarikat* ose *sekt*. Fjalën e tretë e lamë siç ishte në original: *hakikat*. Në botëkuptimin fetar dhe mistik islam si dhe në terminologjinë përkatëse, me *hakikat* emër-tohet e vërteta absolute, e ndryshme nga e vërteta relative e kësaj bote. (Përkthyesi)



gjon. Gjërat e paracaktuara nga Zoti janë, për njeriun e përkryer, më të bukurat e gjërave që kanë për të ndodhur. Meqë ndodhet nën efektet e soditjes së pamjeve hyjnore, dëshirat dhe pasionet e kësaj bote zvogëlohen tepër në vështrimin e tij. Relativitetet e përkohshme e humbin çdo vlerë.

Njeriu i përkryer është kah vëzhgon vazhdimisht bukuritë hyjnore. Gjithësia dhe dukuritë janë për të një rrjedhë shembëllyese. Përballë shfaqjeve hyjnore që rrjedhin e shkojnë, ai përjeton vetëdijen e robit dhe edukatën e njeriut të thjeshtë e të përrulur.

Prandaj ndodh që lutjet dhe përgjërimet që i drejton njeriu i përkryer Zotit, janë, përgjithësisht, të pranuar. Lutjet e tij nuk kthehen mbrapsht. Ndërkaq, ai, si rrjedhojë e edukatës dhe pëlqimit ndaj Zotit, për vete nuk kërkon asgjë. Pra, në lutjet ai vetë nuk është. Meqë natyra e tij është mburjtur me tharm mëshire, zemra ia përfshin tërë krijesat. Ai është i vetëdijshëm për faktin se programi hyjnor i gjithësisë është më i përkryeri, më i gjeturi dhe i pajisuri me një urtësi të thellë!

Një ditë, prijësi i urtë, Zymbyl Sinan Efendiu, i pyeti nxënësit e vet:

“Ç’do të bënit ju nëse, mos qoftë e thënë, një ditë Zoti do t’ju jepte në dorë administrimin e kësaj gjithësie?”

Megjithëse mbetën të habitur para kësaj pyetjeje të pazakontë, nxënësit, për të mos treguar mungesë mirësjelljeje ndaj mësuesit duke mos iu përgjigjur, shfaqën mendime të ndryshme.

Dikush tha:

“Nuk do të lija në botë asnjë mohues!”



Një tjetër:

“Të gjitha të këqiat do t’i asgjësoja!”

Dikush tjetër:

“Do t’i vrisja të gjithë ata që pijnë!”

Mësuesi vuri re se njëri prej nxënësve nuk po e hapte gojën fare. Ai rrinte i tërhequr e i drojtur. Mësuesi i tha:

“O bir, po ti, ç’do të bëje?”

I skuqur nga turpi, duke iu bindur me një përlulesi plot edukatë pyetjes së posaçme të mësuesit, nxënësi iu përgjigj me një zë të ulët:

“Imzot! Mos qoftë e thënë, a ka ndonjë të metë në administrimin e kësaj gjithësie nga ana e Zotit që unë të mund të bëj diçka të ndryshme nga kjo? Ndërsa rregullsia hyjnore në gjithësi vepron me një fuqi përtej çdo përfytyrimi, a mund të them unë, me mendjen dhe vullnetin tim të dobët, të cunguar e të kufizuar, *këtë do ta bëja kështu e, atë, ashtu?*”

Dhe i uli sytë e turpëruar përtokë.

Pas kësaj përgjigjeje të përkryer, mësuesi i urtë mbeti shu-më i kënaqur. Duke e vështruar nxënësin me shikime të the-lla me fytyrën e tij të nurshme e të buzëqeshur, u tha të gjithë nxënësve:

“Ja, tani e gjeti puna të zotin!”

Pas asaj dite, nxënësi i quajtur Musa Muslihiddin u mbi-quajt “**i zoti i punës**” dhe ky cilësim, duke e shtyrë në harresë emrin e tij të lindjes, u bë emri i tij i vërtetë!

Meqë njeriu i përkryer ndodhet nën shfaqjen e konfidencës dhe dashurisë hyjnore, prirjet egoistike tek ai digjen



ashtu siç digjet një copë letre nën një thjerrëz. Dhe meqë, kështu, ai kthehet në një epiqendër tërheqjeje shpirtërore, edhe njerëzit e tjerë e duan dhe e respektojnë në mënyrë të pavullnetshme. Por ai nuk bie në vorbullën e krenarisë dhe mendjemadhësisë sepse e ka shpëtuar veten nga çarku i komplimenteve dhe interesimeve të vdekshme. Ai ndodhet bashkë me Zotin mes njerëzve, ndërkaq që kurrsesi nuk tregon afërsi dhe prirje ndaj njerëzve të padrejtë dhe mosmirënjohës që janë e kundërta e njeriut të përkryer, megjithëse edhe për ta i vjen keq se është i mëshirshëm dhe lutet që të hyjnë në rrugë të drejtë!

Malli e pasuria dhe të gjitha kapitalet e kësaj bote i duhen atij vetëm për të dhënë, për të dhuruar, për të ndihmuar.

Njeriu i përkryer ia ka kushtuar veten njohjes dhe afrimit ndaj Zotit, të qenit konfident i Tij. Tashmë ai është një rob i thjeshtë e i vërtetë që nuk u jep vlerë vuajtjeve dhe mundimeve të kësaj bote. Njeriu i përkryer e sheh këtë botë me mendimin se

كُلُّ مَنْ عَلَيْهَا فَانٍ

“... çdo gjë dhe çdokush është i vdekshëm...” (er-Rahman: 26)

Gjithë synimi dhe qëllimi përfundimtar i njeriut të përkryer është fitimi i pëlqimit të Zotit. Në këtë drejtim, për të, gjella e shijshme nuk ka ndryshim nga gjella e pashijshme. Po kështu, e shumta nga e pakta, e nxehta nga e ftohta, pasuria nga varfëria. Sepse të gjitha janë relative.

Njeriu i përkryer është, në pamje, si një i vetmuar a i varfër, por, në botën e ndjenjave ai mbretëron në pallate të tilla



madhështore, rri ulur në frone të tilla të stolisura që, në sytë e tij, bota s'është gjë tjetër veçse një lojë e luajtur në rërë. Për rrjedhojë, ai s'kërkon gjë prej botës e prej njerëzve!

Në të gjitha punët ai vepron me maturi. Edhe në adhurimet ai ndjek rrugën më të dobishme.

Kështu, i Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

“Unë jam, ndër ju, më i maturi dhe ai që e ka frikë më shumë Allahun. Unë, disa herë agjëroj e, disa herë, s'agjëroj, disa herë fal namaz nafile e, disa herë s'fal. Unë pushoj. Unë martohem.” (Buhari, Nikah, 1; Muslim, Nikah, 5)

Me këto fjalë, ai kërkon të thotë se çdo gjë duhet bërë me maturi, pa e lënë mangut e pa e tepruar.

Sipas kësaj, Profeti, agjërimin e vazhdueshëm, qëndrimin zgjuar tërë natën dhe jetën prej murgu kurrë nuk e ka pëlqyer e kurrë s'e ka këshilluar. Ndërkaq, sigurisht që e ka ndaluar të kundërtën, jetën pa agjërim, në shkujdesje e indiferentizëm, të dhënë pas gjumit dhe dëshirave trupore. Domethënë, as lëshim, as dhe një teprim që do ta trondiste ekuilibrin...

Mbi njeriun ka të drejtë Zoti për një adhurim dhe falënderim ndaj Tij, ka të drejtë familja, vetvetja etj. Njeriu i përkryer përpiqet ta ruajë ekuilibrin mes tyre.

Njeriu i përkryer që ka një zemër të butë, e çon në vend pa tjetër fjalën e dhënë dhe kurrë nuk e shkel premtimin. Ai nuk e cënon dinjitetin e bashkëbiseduesit për shkaqe egoistike. Ai është i drejtë si në adhurimin ndaj Zotit, ashtu dhe në qëndrimin ndaj njerëzve.

Ai nuk thyhet as ndaj ndodhive kundër interesave të tij. Po qe se ai që i ka bërë keq është një i varfër të cilit ai gjer



atëherë i pati bërë mirë, edhe pas kësaj vazhdon t'i bëjë të mira me sa t'i vijë për dore, sepse njeriu i përkryer i cili është i pajisur me moralin e Allahut dhe kërkon vetëm pëlqimin e Tij, sillet dhe vepron sipas kritereve të Kur'anit dhe Sunnetit, Traditës Profetike! Dihet se Zoti i furnizon të gjitha qeniet, madje edhe ata që i kundërvihen!

Hz. Ebu Bekri (r.a.) e ndihmonte vazhdimisht një të varfër me emrin Mistah. Por, kur pa se në ngjarjen e shpifjes kundër së bijës ishte përzjerë edhe Mistahu, u betua se kurrë nuk do t'u jepte ndihmë atij dhe familjes së tij.

Pas kësaj, familja e Mistahut ra në një gjendje shumë të vështirë. Atëherë zbritën ajetet hyjnore që thoshin:

“Personat e virtytshëm e të pasur ndër ju le të mos betohen se nuk do t'u japin nga pasuria e vet të afërmve, të varfërve, të emigruarve në rrugën e Allahut; le t'i falin ata! A nuk doni ju që Allahu t'ju falë? Allahu është falës dhe mëshirues i madh!” (en-Nur: 22)

“Mos e bëni pengesë, për shkak të betimit, Allahun për të bërë mirë, për t'u drojtur prej Tij dhe për t'i pajtuar njerëzit. Allahu dëgjon dhe di!” (el-Bakara: 224)

Pas zbritjes së këtyre ajeteve, Ebu Bekri (r.a.) tha:

“Sigurisht, unë dua që Allahu të më falë!” (I. Xhanan, Kutub-i Sitte, II, f. 551)

Pastaj, ai dha dëmshtëpërblim për betimin që kishte bërë dhe vazhdoi të ndihmonte.

Njeriu i përkryer dhuron aq shumë në kohën dhe vendin e duhur, saqë ata që e shohin, e pandehin për dorëlëshuar. Po s'që vendi dhe koha e duhur, aq pak jep, saqë ata që e shohin,



e pandehin për dorështrënguar dhe koprrac. Kurse ai përjeton vetëm pëlqimin e Zotit. Zoti urdhëron në Kur'an:

“Jepu të drejtën edhe të afërmit, të varfërit, udhëtarit. Por mos shpenzo vend e pa vend! Sepse ata që shpenzojnë kështu, janë vëllezër me djallin. Dhe djalli është shumë mosmirënjohës ndaj Zotit të vet!” (el-Isra: 26-27)

“Mos u bëj dorështrënguar, por as krejt dorëlëshuar, se, pastaj, dënohesh dhe vuan për ato që ke humbur!” (el-Isra: 29)

I ndërgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për këtë ajet, kalifi Omer bin Abdulaziz ua pati shpërndarë pasurinë e tij e të familjes duke e marrë edhe pëlqimin e tyre, nevojtarëve, të vetmuarve e jetimëve, duke u bërë shembull për nënshtetasit e vet si dhe për të pasurit e tjerë. Si rrjedhojë, në kohën e tij pati ardhur puna të mos gjendej njeri për t'i dhënë zeqat! Omer bin Abdylazizi pati shkuar edhe më tej duke e braktisur pa-llatin perandorak për të jetuar në një çadër!

Edhe nëse njeriu i përsosur disa herë dënohet nga të tjerët për nënvleftësimin e jetesës dhe kënaqësive materiale, ai ndodhet në një pozitë të lartë moralo-shpirtërore që, në të vërtetë, kihet zili nga të gjithë. Bota është urdhëruar t'i nënshtrohet atij!

Porosia profetike thotë:

“... Atë që e ka hallin te jeta e pasme, ahireti, Allahu e bën të pasur në zemër, ia shpëton punët nga çoroditja dhe njerëzit vijnë tek ai të nënshtroar. Dhe atë që e ka hallin te kjo jetë, Allahu e bën të pangopur, të varfër, të çoroditur dhe nga kjo botë te ai vijnë



vetëm ata që ia kanë nevojën atij!” (Ahmed bin Hanbel, Kitabu’z-Zuhd, 181)

Njeriu i përkryer pajiset me një moral dhe natyrë aq të përkryer, saqë, përveçse për Allahun, për asgjë dhe me askënd nuk nxehet, nuk thyhet. Ai përjeton të fshehtën e deklararës hyjnore që thotë:

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ
عَنِ النَّاسِ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“Ata njerëz të devotshëm që japin për hir të Allahut si në bollëk, ashtu dhe në ngushticë, që e kapërdijnë zemërimin dhe që i falin të tjerët. Dhe, kështu, Allahu i do ata që dhurojnë!” (Al-i Imran: 134)

Duke e përjetuar të vërtetën e këtij ajeti, Hz. Xhaferi e pati falur shërbëtorin që i pati derdhur gjellën sipër dhe i pati bërë të mira të tjera. Kurse Hz. Hasan Basriu i falte ata që e përfolnin dhe i edukonte duke u dërguar dhurata!

Njeriu i përkryer është thesari i enigmave hyjnore. Vetëm ata që janë konfidentë të enigmës hyjnore e njohin përkryerjen e tij. Sepse ai nuk ka ndryshim nga njerëzit e tjerë si kurm, por, si zemër, është ndër robtë që Zoti i ka bërë bujarë. Ai është pasqyrë reflektuese e “krijimit të bukur”.

Zemra, ndjenjat e njeriut të përkryer nuk kalben nën tokë. Prandaj dhe veprat e tij që janë produkte të zemrës së tij, fitojnë pavdekësi.

Prandaj Allahu i Lartë, duke e çliruar njeriun e përkryer nga frika dhe hidhërimi, i ka dhuruar lumturinë e dy botëve. Në Kur’an thuhet:



أَلَا إِنَّ أَوْلِيَاءَ اللَّهِ لَا خَوْفٌ عَلَيْهِمْ وَلَا هُمْ يَحْزَنُونَ

“Ta dini se për miqtë e Allahut nuk ka frikë dhe ata nuk do të mbeten të dëshpëruar...” (Junus, 62)

Zoti ynë mos na ndaftë nga klima e begatë e miqve të Tij, me të mirat shpirtërore të të cilëve jemi rritur dhe edukuar!

Amin, ashtu qoftë!

W



ORIENTIMI

Dikush prej njerëzve të mëdhenj hasi në një plak që kishte ngarkuar dru në shpinë dhe ecte me vështirësi. Duke ia parë hallin, i tha:

“O plak, a s’ të mbeti bindje në Allahun i cili është ai që e ushqen çdo gjallesë, që akoma heq këtë mundim në këtë mo-shë, apo s’ ke njeri që të kujdeset për ty?”

Për ta plotësuar mungesën shpirtërore të bashkëbiseduesit, druvari plak ngriti sytë dhe hapi duart drejt qiellit:

“O Zot! Ktheji këta dru në flori!”

Kështu u lut druvari dhe drutë u kthyen menjëherë në flori!

Njeriu që e pa këtë shfaqje shenjtërie, foli, po kësaj radhe pa iu drejtuar kujt dhe me habi e mahnitje bashkë:

“Një njeri që ka arritur këtë shkallë, pse të bartë dru?”

Druvari plak tha:

“O bir, këtë e bëj që vetja ime ta dijë se unë jam një rob i Zotit, pra dhe të mos dalë jashtë rrethit të të qenit rob i Zotit, sepse gjëja më e pëlqyer dhe e pranuar në lartësinë e Zotit është orientimi në të qenit rob i Zotit!”



Prandaj, arifët, njerëzit e pajisur me kulturën shpirtërore, kanë thënë:

“Shenjtëria më e madhe është orientimi...”

Në kuptim të përgjithshëm, *orientim* (istikamet) do të thotë të kthehesh pa kundërshtim dhe ngurrim dhe të ecësh pa pushim drejt një synimi ose objektivi të caktuar. Kurse në terminologjinë e mistikës, do të thotë ta ruash pafajësinë dhe qashtërsinë e krijimit pa e dëmtuar dhe shkatërruar.

Si përfundim i ruajtjes së jetës ndjesore, vetja ose egoja arrin të edukohet, kurse zemra ose ndjenjat i afrohen frymës dhe moralit muhammedian, enigmat nisin të bëhen të dukshme, Allahu (xh.xh.) bëhet qëllimi i qëllimeve, gjërat e zakonshme ose vanitetet e humbin fuqinë, besimtari fiton një përmbajtje të denjë për të realizuar nivelin cilësor të arritjes te Zoti.

Megjithëse modeli më i personifikuar i përsosmërisë së një sjelljeje të tillë është Hz. Muhammedi (s.a.s.) i dërguar si mëshirë për botët, për ta treguar vështirësinë e realizimit të këtij niveli cilësor, edhe ndaj atij personaliteti të madh, madje, është drejtuar këshillimi hyjnor:

فَاسْتَقِيمْ كَمَا أُمِرْتَ

Kështu, duke nxjerrë nga ky ajet kuptimin e aludimit mbi vështirësinë e këtij niveli cilësor, përballë peshës hyjnore të një përgjegjësie të lartë, Profeti (s.a.s.) pati thënë një ditë:

“Sureja Hud më plaku mua...” (Tirmidhi, Tefsiri i sures 56/6).

Rrëfëhet se një njeri i mirë e pa në ëndërr Profetin (s.a.s.) dhe e pyeti:



“O i Dërguari i Allahut, ç’gjë nga sureja Hud të plakuri ty?”

Dhe Profeti (s.a.s.) i tha:

فَأَسْتَقِمُّ كَمَا أُمِرْتُ

“... bëhu i drejtë siç je urdhëruar!...” (Hud: 112) (Ihjaw Ulumidin, III, 145)

Abdullah bin Abbas (r.a.) ka thënë:

“Nuk ka në Kur’an për të Dërguarin e Allahut ndonjë këshillë hyjnore më të rëndë se ky ajet!” (Tefsiri Elmallëllë, V, 18)

Prandaj ka ndodhur që te Profeti, flokët dhe mjekra e të cilit gjer atë ditë ishin krejt të zeza, pa një fije të bardhë, pas zbritjes së këtij ajeti nisën të duken thinjat e para.

Komentuesit e Kur’anit e shtjellojnë në mënyrë të përmbledhur kështu këtë ajet:

“O i Dërguar! Eshtë e domosdoshme të veprosh sipas moralit dhe urdhrave të Kur’anit për t’u bërë një model i personifikuar orientimi në mënyrë që mbi ty të mos mbetet vend për asnjë dyshim dhe lëkundje. Ti mos i vër re fjalët e politeistëve dhe hipokritëve; ata lëria Allahut! Si në detyrat e përgjithshme, ashtu edhe në ato të veçantat, qëndro i orientuar ashtu siç duhet, ashtu siç je urdhëruar dhe mos u shmang nga rruga e drejtë (sirati mustakim)! Sado i rëndë të të jetë zbatimi i urdhrit të zbuluar, në kumtimin, zbatimin dhe praktikimin e atij urdhri mos u zbraps nga asnjë pengesë! Zoti yt është ndihmësi yt!”

Nga ana tjetër, ky komunikim hyjnor i ajetit përmbledh, në personin e Hz. Muhammedit (s.a.s.) gjithë ummetin, bashkësinë e tij. Në fakt, ajo çka e ka plakur Profetin, është, lidhur



me këtë përfshirje, shqetësimi i tij për bashkësinë, sepse ai vetë, sipas pohimit të ajetit të mëposhtëm, është i garantuar:

عَلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“... ti je në rrugë të drejtë!” (Jasin: 4)

Në këto kushte, ashtu siç nuk ka rrugë tjetër veç orientimit (sirati mustakim-rrugës së drejtë) për t’iu afruar Zotit e për t’u bërë konfident i Tij (vasilillah), ashtu dhe nuk ka pozitë më të lartë se ruajtja e orientimit në çdo çështje dhe urdhër më të vështirë për ta zbatuar atë me dinjitet.

Ja, pra, është për shkak të kësaj vështirësie që ky urdhër që e lexojmë në suren Fatiha shumë herë për ditë, i është dhënë ummetit, bashkësisë, si një lutje dhe, për rrjedhojë, si një tërheqje vëmendjeje!

Edhe fakti që kërkesa për orientimin në rrugë të drejtë, اِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ (ihdina’s-sirata’l-mustakim), zë vend në suren Fatiha dhe detyrimi i besimtarit për ta përsëritur atë të paktën dyzet herë në ditë në formë lutjeje, është argument i vështirësisë së ruajtjes së orientimit në mënyrë dinjitoze.

Sipas shprehjeve në Kur’an, sirati mustakim (rruga e drejtë, orientimi) është përshkruar si rruga e Allahut, rrugë krejt e drejtë, rrugë e përshtatshme, libri i Allahut, besimi dhe elementët e lidhur me besimin, islami dhe ligjshmëria islame, rruga e Profetit (s.a.s.) dhe e të mëdhenjve ndër sahabet, rruga e sunnetit dhe xhemaatit, rruga e njerëzve të mirë dhe e dëshmorëve, rruga e lumturisë në këtë botë dhe në jetën e pasme (ahiret), rruga e xhennetit, etj.

Sipas kësaj, sirati mustakim është rruga krejt e drejtë, përgjatë të cilës nuk ka asnjë kthesë, shtrembërim dhe çnivehim.



Sirati mustakim është rruga që shkon te Zoti. Në Kur'an thuhet:

صِرَاطِ اللَّهِ الَّذِي لَهُ مَا فِي السَّمَوَاتِ وَمَا فِي الْأَرْضِ الْأَلَى
اللَّهُ تَصِيرُ الْأُمُورُ

“(Sirati mustakim) është rruga e Allahut, Zotit të qiejve e të tokës. Dhe dijeni se çdo gjë më në fund do të kthehet te Ai!” (esh-Shura: 53)

Të jesh në rrugë të drejtë është adhurim i vërtetë ndaj Allahut. Në Kur'an thuhet:

فَاعْبُدُوهُ هَذَا صِرَاطٌ مُسْتَقِيمٌ

“... Adhurojeni Atë (me të vërtetë); ja, kjo është rruga e drejtë!” (Al-i Imran: 51)

وَمَنْ يَعْتَصِمْ بِاللَّهِ فَقَدْ هُدِيَ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“... Kush lidhet ngushtë pas Allahut, pa diskutim është shtyrë për në rrugë të drejtë!” (Al-i Imran: 101)

Në suren En'am, *sirati mustakim* është përkufizuar kështu:

“Thuaj: “Ejani t’ju këndoj se ç’gjëra ju ka bërë haram Zoti juaj: të mos i bëni shok asgjë Atij, të silleni mirë me prindërit, të mos i vrisni fëmijët me frikën e varfërisë se edhe ushqimin tuaj, edhe ushqimin e tyre Ne e sigurojmë, të mos u afroni as te të këqiat e hapura, as te të këqiat e fshehta dhe të mos e vrisni padrejtësisht jetën! Ja, këto që jua tregova m’i ka porositur Allahu në mënyrë që të mendoni dhe kuptoni!”



“Trajtojeni me qëllim dhe formë të mirë mallin dhe pasurinë e jetimit gjersa ai të arrijë në moshën e pjekurisë dhe peshoni e matni me drejtësi. Ne e ngarkojmë çdokënd me aq sa ka fuqi të mbajë. Kur të flisni në të mirë apo kundër dikujt, mbani drejtësi qoftë edhe sikur ai të jetë një nga të afërmit tuaj. Dhe mbajeni fjalën që i keni dhënë Allahut Ja, pra, Allahu ju urdhëroi këto në mënyrë që të mendohe- ni mirë!”

“Pa dyshim, kjo është rruga ime e drejtë, lidhuni pas saj e jo pas rrugëve të tjera që ju largojnë prej rrugës së Tij!”

(En’am: 151-153)

Po qe se robi nuk e vë dashurinë për Allahun mbi dashu- rinë dhe lidhjen për çdo gjë tjetër veç Tij, nuk mund t’i afro- het denjësisht rrugës së drejtë. Prandaj, njohja e Allahut sipas vetive të individualitetit të Tij të lartë, domethënë intuita ndaj Allahut (marifetullah) është kusht. Sipas kësaj, sirati mus- takim (orientimi, rruga e drejtë) është intuita ndaj Allahut (marifetullah-njohja e Allahut me intuitë). Sepse ai që arrin ta njohë Allahun me intuitë, pra arrin atë nivel shpirtëror që quhet marifetullah dhe që e rregullon jetën tërësisht sipas domosdoshmërive të këtij besimi, largohet prej të këqiave (sherrit) të vetes (nepsit-egos) dhe intrigave të djallit dhe jeton duke kërkuar vetëm pëlqimin e Zotit, zemra i bëhet e meri- tuara e shfaqjeve të favorit hyjnor. Robi që arrin këtë gjendje, ka hapur një dritare shpirtërore përtej klimës materiale që sheh syri e dëgjon veshi dhe tërë gjithësia kthehet për të në një libër madhështor e të urtë.

Ndërkaq, duhet ditur se një pjesë nga sahabet, shokët e tij, i patën kërkuar Profetit (s.a.s.) të bënin një jetë larg familjes



duke u dhënë natë e ditë pas adhurimit, kurse Profeti (s.a.s.) u pati këshilluar atyre maturinë.

Duhet ditur se Hz. Muhammedi (s.a.s.) e ka jetuar tërë jetën e vet brenda një programi të caktuar dhe kuadrit të mundësive njerëzore në mënyrë që të bëhet shembull për të tjerët. Ditët e tij kanë kaluar me adhurim ndaj Allahut, me respektim të të drejtave të familjes, me pushim të trupit që është një e drejtë e vetes (nepsit-egos) si dhe me marrëdhënie shoqërore zbatuese të detyrave hyjnore kundrejt njerëzimit. I Dërguari i Allahut (s.a.s.) i pati rregulluar në mënyrën më të bukur dhe ia pati parashtruar dhe propozuar ummetit, bashkësisë së tij.

Në këto kushte themi se nuk është aspak e drejtë që, duke dalë jashtë këtij rregullimit, parashtrimit dhe propozimit të Profetit, në disa detyra që na bien përsipër të tregojmë mefshtësi dhe nënvleftësim, kurse në disa të tjera, ndjeshmëri skajore. Ne duhet ta rregullojmë jetën tonë në përshtatje me parimet jetësore që na ka parashtruar Profeti.

Allahu i Lartë urdhëron:

قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَىٰ بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي
وَسُبْحَانَ اللَّهِ ۖ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ

“Thuaj: “Ja kjo është rruga ime! I ftoj veten time dhe ata që më ndjekin mua të shohim se ç’thotë Allahu...” (Jusuf: 108)

Në periudhat kur njerëzimi në përgjithësi i dhënë pas interesave materiale dhe forcës, qe zhytur në errësirën e mbretërimit të egos, një pjesë e njerëzve të mirë me krijim përjashtimor qenë ngarkuar nga ana hyjnore me detyrën e



profetësisë pranë njerëzve. Këta ambasadorë të bekuar që do të bëhe-shin model për popujt, qenë ngarkuar me këto tri detyra krye-sore:

- a) T'i lexonin dhe kumtonin ajetet e Allahut.
- b) T'ua mësonin njerëzve Librin dhe urtësinë.
- c) T'i pastronin vetet (nefset, egot), domethënë t'i orientonin njerëzit.

Ky varg orientuesish i nisur me Ademin (a.s.), ka gjetur përsosmërinë me Hz. Muhammedin (s.a.s.).

Kur'ani i cili i bën mohuesit ta ndjejnë veten krejtësisht të dobët e të paaftë dhe besimtarët të mahniten para tij, si dhe rruga e drejtë (sirati mustakim) si një shfaqje e personalitetit të Hz. Muhammedit (s.a.s.), i është paraqitur gjithë njerëzimit si një model shembullor.

Sirati mustakim, domethënë orientimi, është një poetikë njerëzish punëmirë.

Që punët të jenë të mira, duhen plotësuar dy kushte:

1. **Tadhim li-emrillah**, zbatimi i rregullt i urdhrimit hyjnor.
2. **Shefkat li-halkillah**, dhembshuri për krijesat e Zotit.

E shprehur ndryshe, orientimi është, duke e mbajtur të freskët dashurinë për të Dërguarin e Allahut, të mund të marrësh pjesë nga personaliteti i tij shembullor, të mund të pajisesh me moralin e tij, të mund të jetosh me frymën e Kur'anit dhe Sunnetit, si dhe, duke u larguar nga kënaqësitë materiale, frymore dhe egoistike të kësaj bote, të mund të



fitosh kompetencë mbi enigmat e adhurimit, lutjes dhe marifetit, njohjes intuitive të Zotit.

Edhe Hz. Omeri (r.a.), madje, shqetësohej për ruajtjen e principialitetit, sinqeritetit dhe orientimit në jetesën e vet. Pasi u bë kalif, në një hutbe, i pyeti kështu muslimanët:

“O xhemaat! Po qe se unë shmangem nga rruga e Allahut, ç'bëni ju?”

Një beduin u ngrit në këmbë e iu përgjigj:

“O kalif! Mos ki merak se, po të shmangesh, të drejtojmë ne me shpatat tona!”

Kalifin e kënaqi kjo përgjigje dhe tha me falenderim drejtuar Zotit:

“Lavdi ty, o Zot, që më dhe në pjesë një bashkësi (xhemaat) të tillë që të më korrigjojë po të gabo!”

Për hir të së mirës së ummetit, bashkësisë, Profeti (s.a.s.) vetëm Hudhejfes (r.a.) ia pati treguar se cilët kishin ndër zemra shenja hipokrizie. Hz. Omeri (r.a.) që e kishte marrë vesh këtë, duke dyshuar për veten, e pati pyetur një ditë Hudhejfen (r.a.):

“O Hudhejfe! Për dashurinë për Allahut, më thuaj, a ka tek unë shenjë hipokrizie?”

Dhe Hudhejfe i qe përgjigjur:

“O kalif! Të garantoj se tek ti nuk ka shenjë hipokrizie!”

Hasan Basriu (rah. a.) i tha kështu specialistit të hadithit Tavus që e kishte nxënë:



“O Tavus! Po qe se mësimi i hadithit të jep krenari, hiq dorë nga këndimi i kësaj diturie!”

Duke u dhënë mësim treqind nxënësve, Gazaliu u rrëmbye nga një shqetësim i madh:

“Duke u dhënë mësim kaq shumë nxënësve, unë a po veproj sipas pëlqimit të Allahut, apo, duke u mundur nga popullariteti, po ndodhem në buzë të greminës?”

Pas kësaj, Gazaliu e zbriti mallin dhe pasurinë e vet në nivelin më të paktë të mjaftueshëm (kifajet). Pastaj e la mësimin dhe, duke u tërhequr në vetmi dhe meditim, jetoi vetëm me lutje dhe adhurim drejtuar Zotit. Kështu, iu shfaq fryma e Profetit (s.a.s.) dhe ai gjeti qetësinë dhe lumturinë. Si përfundim, i shpëtuar nga përpjekjet e kaluara, tha:

“Lavdi Zotit, arrita prehjen e kënaqësinë!”

Tashmë një Gazali krejt tjetër kishte dalë në shesh!

Duke u kthyer nga fitoret e njëpasnjëshme të fushatës egjiptiane, sulltani i shquar Selimi i Rreptë mori lajmin se populli i Stambollit po e priste me entuziazëm të madh. Atëherë, megjithëse i ishte afruar Stambollit, e vuri ushtrinë të bëjë konak në bregun e kundërt të Çamllëxhasë dhe nuk u fut në qytet. Për të mos iu nënshtruar egoizmit, e thirri mësuesin dhe shokun e pandarë, lalë Hasan Xhanin, dhe i tha:

“O lalë, të erret mirë, të gjithë njerëzit të futen nëpër shtëpi e pastaj të hyjmë në Stamboll. Duartrokitjet e njerëzve të vdekshëm, kurorat e fitores dhe lavdërimet e tyre të mos na bëjnë krenarë e të na shtrijnë për tokë!..”



Më në fund, kur u err mirë, sulltan Selimi i Rreptë hyri në qytet fshehurazi e pa asnjë ceremoni!

Zemra (ndjesitë) është vendvështrimi hyjnor. Vlera e adhurimeve varet nga kthjelltësia e ndjenjave. Në Kur'an thuhet:

يَوْمَ لَا يَنْفَعُ مَالٌ وَلَا بَنُونَ إِلَّا مَنْ آتَى اللَّهَ بِقَلْبٍ سَلِيمٍ

“Atë ditë as malli të jep dobi, as fëmija, veç atyre që vijjnë tek Allahu me zemër të pastër!” (esh-Shuara, 88-89)

Në lidhje me zemrën e pastër, poeti Mevlana (k.s.) jep këtë shembull:

“Jusufi (a.s.) e pyet një mikun e tij që kthehej prej udhëtimit:

“Ç’dhuratë më solle mua?”

Miku i përgjigjet:

“Ç’mungon tek ti? Vetëm pse nuk ka gjë më të bukur se bukuria jote, të solla një pasqyrë që çdo çast bukuria yte të shfaqet te pa-sqyra!..”

Kurse Zoti është i pastër prej çdo mungese e relativiteti. Ai është krijuesi dhe shkaku origjinal i të gjitha bukurive. Është e domosdoshme të shkohet në audiencën e Tij të lartë duke e ruajtur zemrën të pastër në mënyrë që të vëzhgohen shfaqjet e enigmave dhe bukurive të Tij të pashoqe e të pafundme!

Kështu, në hadithin profetik thuhet:

“Pa dyshim, Allahu i Lartë nuk sheh kah trupat dhe pamjet tuaja; Ai e hedh vështrimin vetëm në zemrën tuaj!” (Muslim, Birr, 33; Ibni Maxhe, Zuhd, 9)



Allahu im! Na fut ne në rrugën e drejtë (sirati mustakim), na oriento dhe drejto! Na bëj ndjekës të rrugës plot lumturi bashkimi dhe favori të profetëve, besnikëve, dëshmorëve dhe të të mirëve që u ke dhënë të mira! Mos na ndaj nga orientimi! Dhe na ruaj nga rrugët e këqia mbushur plot dhimbje e shkatërrim të të ndëshkuarve dhe të të shmangurve, rrugë e cila të nxjerr në disfatë!

Amin, ashtu qoftë!

W





**TE RRISH BASHKE ME
NJEREZIT E MIRE DHE BESNIKE**

کتابخانه دارم که تمام کتابها را دارد
کتاب تو است که معصوم پندارم
هر آن که جان این ایوان را دارد
مرا که جان این ایوان را دارد

*Allahu gjithsesi e mbron nga të këqijat
njeriun që rri pranë besnikëve e i vëzhgon ata.
Nëse dëshiron që i Dashuri të të qëndrojë besnik,
mos e lër të të ikë ky rast që edhe
Ai të mos heqë dorë prej teje.*

(Fragment poezie persishte)



TE RRISH BASHKE ME NJEREZIT E MIRE DHE BESNIKE²

Ishte një njeri i paditur dhe indiferent që s'i donte njerëzit e afërt të Allahut³. Një ditë, duke kaluar pranë selisë së një miku të Zotit, zgjati kokën me kureshtje për të parë se ç'bëhej atje brenda. Atje ishte shtruar një kuvend mbi të cilin reshonin me pika margaritarësh shirat e frymëzimit dhe begatisë shpirtërore hyjnore. Por njeriu i paditur dhe indiferent s'kuptonte gjë nga kjo. Prandaj rrudhi buzët dhe vazhdoi rrugën e vet.

Atë natë pa një ëndërr të tmerrshme. Ishte në sheshin e grumbullimit të njerëzve pas ringjalljes⁴. Engjëjt ndëshkues⁵

2 Në original janë fjalët *salih* dhe *sadik*. "Salih" do të thotë "njeri i p - nëve të mira", njeri me cilësitë vetiake më të mira e të pëlqyeshme, që sillet dhe vepron mirë, pra që është i mirë edhe për të tjerët. Njëkohësisht, ky "njeri i mirë" është i tillë edhe në kryerjen e rregullt dhe të plotë të detyrave fetare. Kurse "sadik" do të thotë "njeri i fjalës së drejtë dhe besnik". Të tillë janë cilësuar, në historinë e mistikës islame, njerëzit që nuk e kanë vënë kurrë në dyshim ekzistencën dhe njësinë e Zotit, pro-fetësinë e Hz. Muhammedit dhe i kanë qëndruar gjer në fund besnikë besimit të tyre. Muslimani i parë që është cilësuar *sadik* (besnik), ka qenë Hz. Ebu Bekri. (Përkthyesi)

3 Në original: *evlijaullah*.

4 Në original: *mahsher*.

5 Në original: *zebani*.



e kishin kapur dhe po e çonin për në xhehennem. Por ja tek u duk ai mik u Zotit, pranë selisë së të cilit kishte kaluar atë ditë! Ai u tha engjëjve:

“Lëreni atë se koka e tij u fut dje në kuvendin tonë!”

Kurse engjëjt kundërshtuan:

“Jo! Ky është një njeri i paditur dhe indiferent, i caktuar për në xhehennem!”

Njeriu i shkretë, i zgjuar ndërsa ata po bisedonin kështu, qysh në mëngjes herët vrapoi për në selinë e atij personit dhe, me zemrën të zgjuar, tashmë, u fut në karvanin e njerëzve të pajisur me kulturë shpirtërore⁶.

Sipas një hadithi profetik të rrëfyer nga Enesi (r.a.), Allahu i Lartë ka një sërë engjëj shëtitës që kërkojnë vazhdimisht kuvendet ku bëhet ziqër dhe zhvillohen biseda shpirtërore. Kur hasin në një kuvend të tillë, radhiten rrotull tij dhe thonë:

“Zoti ynë! Këta njerëz këndojnë Librin tënd, i dërgojnë përshëndetje Profetit duke u lutur për paqe e mëshirë për të dhe kërkojnë prej teje gjërat e nevojshme të kësaj bote e të jetës së pasme.”

Dhe Zoti urdhëron e thotë:

“Bëhuni dëshmitarë: qofshin të falur!”

Ndërkaq, engjëjt shtojnë:

“Zoti ynë! Por mes tyre janë edhe filani e filani që kanë hyrë aty gabimisht!”

6 Në origjinal: ârif, njeri i pajisur me kulturë fetare e shpirtërore.



Por Zoti thotë:

“Ata robtë e mirë dhe besnikë janë një shoqëri e tillë që, kush ndodhet së bashku me ta, nuk mund të quhet i keq!”
(Tergib, II, 402)

Sihariqet e dhëna këtu në lidhje me çështjen e shoqërimit me njerëzit e mirë dhe besnikë, janë një nxitje me karakter të brendshëm, një nxitje që i drejtohet botës së brendshme të njeriut, sepse, për ta mbrojtur zemrën nga vanitetet⁷ dhe për ta bërë atë vazhdimisht objekt të sugjerimeve për të mira e dobi, janë të domosdoshëm shoqërimi, konfidenca dhe intimiteti me njerëzit e zemrës, me njerëzit e mirë e besnikë me qëllim për të marrë frymëzim prej botës së tyre shpirtërore. Nuk duhet harruar se, ndërsa organet e tjera kanë vullnet, zemra s’ka; ajo është e prirur për t’u orientuar në atë drejtim që i kërkojnë sugjerimet që i vijnë prej mjedisit.

Zemra merr ngjyrën, formën dhe harmoninë e mjedisit ku ndodhet. Ndërkaq, për zemrën, ky është fillimi i situatës kur nisin të lëshojnë rrënjë për të zënë vend në të ndikime të ndryshme. Ndikimet pozitive dhe negative të formuara më vonë mund të jenë edhe pozitive, por edhe negative për shkak të ngjashmërisë ose kundërshtisë me të parat. Po që se zemra nuk mbruhet e formohet qysh në fillim me ndikime të mira, mbetet e hapur ndaj një rreziku të madh, sepse konfidenca (dashuria) e pranishme në zemër ndaj të gjitha ndikimeve, luan një rol pranues, kurse neveria dhe urrejtja luajnë një rol kundërshtues. Prandaj, gjatë ngritje-uljeve shpirtërore të njeriut, përdorimi me vend i konfidencës (dashurisë) dhe urrejtjes ka një rëndësi shumë të madhe.

7 Në original: mâsivâ, vanitete, gjëra të zakonshme, gjëra të kota e të pa-vlefshme.

Me të vërtetë, ndërsa drejtimi i dashurisë ndaj atij që është i denjë për atë dashuri dhe i armiqësisë ndaj atij që e ka merituar atë armiqësi, e lumturojnë njeriun, e kundërta, domethënë drejtimi i dashurisë ndaj atij që s'është i denjë për atë dashuri dhe i armiqësisë ndaj atij që s'e ka merituar atë armiqësi, e bëjnë fatkeq njeriun po me atë intensitet që dashuron ose urren në mënyrë të padrejtë.

Po të mbahet parasysh kjo e vërtetë, del në pah krejt qartë se sa e domosdoshme dhe e rëndësishme është për zhvillimin moralo-shpirtëror shoqërimi dhe jetesa me njerëzit e mirë të Allahut! Edhe përfitimi nga kjo është në raport të drejtë me dashurinë që ndjehet ndaj bashkëbiseduesit, ndryshe, një shoqërim sa për formë, edhe në sjellje ndonjë dobi, nuk e jep rezultatin e kërkuar!

Veçanërisht të tërheq vëmendjen fakti që fjalët *sahabi* dhe *sahbet*⁸ vijnë nga e njëjta rrënjë. Sahabet, shokët e Profetit, u bënë modeli më konkret dhe i përsosur i përfitimit të dëshiruar nga biseda dhe edukimi moralo-shpirtëror në atmosferën ndjesore të dashurisë, respektit dhe edukatës që tregonin ata ndaj të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ndërkaq, duke dashur të përshkruanin se në ç'kushte të jashtëzakonshme dashurie, qetësie, prehjeje e lumturie e ndjenin veten në bisedat e Profetit, ata shpreheshin kështu:

“Na dukej sikur mbi kryet na kishte qëndruar një zog dhe druheshim se, po të bënim edhe lëvizjen më të vogël, zogu do të ikte!”

⁸ *Sahabi* quhen pasuesit e profetit Muhammed, shokët e tij, bas - këkohësit e tij, ata me të cilët ai kumtoi e përhap i islamin. Kurse fjala *sahbet* do të thotë *bisedë*. Sahabet ishin, njëkohësisht, bashkëbiseduesit e Profetit, pje-sëtarët e bisedave të tij.



Bota ndjesore e sahabeve, të cilën, duke bërë një paralelizëm figurativ me të kaluarën e tyre, mund ta përngjasojmë me një tokë të thatë, u mbrujt me reshjet mëshiruese e begatuese të klimës moralo-shpirtërore të bisedave të tij. Në këtë mënyrë u shndërruan krejtësisht ata njerëz të egër të periudhës injorante paraislamike, aq të pandjeshëm e të pamëshirshëm sa të propoznin përsëgjalli vajzat e tyre të vogla! Nga besimi i ri, nga shoqërimi me Profetin dhe nga bisedat e tij u formësua, brenda të njëjtës siluetë, një tip njeriu tejet i ndjeshëm, i gatshëm për t' u përplotur edhe për gjënë më të vogël, i dashur e vetmohues!

Ata njerëz e bartën kudo që shkuan personalitetin dhe moralin e lartë të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.). Ata shfaqën virtyte, jehona legjendare e të cilave do të vazhdojë gjer në kiamet. Zoti ynë i Lartë shprehet kështu për ta në Kur'an:

“Allahu është i kënaqur me muhaxhirët dhe ensarët⁹ dhe me ata që u ngjajnë atyre. Edhe ata janë të kënaqur me Zotin e tyre. Allahu ka përgatitur për ta xhennete ku rrjedhin lumenj dhe ku ata do të mbeten përgjithmonë. Ja, ky është shpëtimi i madh!” (et-Tevbe, 100)



Të gjitha bisedat që zhvillohen përmes një ekstaze adhurimi, janë një jehonë e bisedave të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), sepse Ai është epiqendra e përfitimit moralo-shpirtëror. Edhe bisedat plot emocione shpirtërore që janë zhvilluar

⁹ Muhaxhirët: mekasit muslimanë që u detyruan të emigronin për të shpëtuar nga shtypja dhe dhuna e politeistëve mekas si dhe për ta jetuar lirisht besimin e tyre. Ensarët: ndihmëtarët, medinasit që u dhanë ndihmë emigrantëve mekas, që i pritën si vëllezër duke ndarë çdo gjë me ta.

më pas e që zhvillohen sot janë vezullime të buruara nga ajo epiqëndër. Bisedat e njerëzve të mirë e besnikë duhen vlerësuar si një pasuri, sepse ato janë si parajsa ku ka sy dhe zemra që gufojnë me dashuri hyjnore.

Sa ç'është e rëndësishme për mbrojtjen e jetës ndjesore ndenjja me njerëzit e mirë e besnikë, po aq e rëndësishme është ruajtja me forcë prej afërsisë me njerëzit e paditur, indiferentë dhe mëkatarë, sepse era që kalon sipër kërmave, e përhap gjithandej kundërmimin e qelbur të tyre, i ngec frymëmarrjet dhe i ndrydh shpirtrat. Poeti Junus Emre e shpreh kështu këtë të vërtetë:

*Po t'i vënë bashkë në një kafaz korbin dhe bilbilin,
Secili do të dojë t'i shmanget bisedës me tjetrin, apo jo!*

*Korbi do të dëshirojë të ndahet sa më parë nga bilbili;
Edhe bilbili të njëjtën dëshirë do të ketë, për Zotin! Apo jo!*

Dihet afërsia e veçantë mes profetit Jakub (a.s.) dhe të birit, profetit Jusuf (a.s.). Kur profeti Jakub dalloi te i biri Jusuf cilësitë e veta, u dha më shumë pas tij duke e dalluar nga fëmijët e tjerë. Kjo dashuri krijoi një njësim të tillë mes të dyve, saqë, kur po ia dërgonin këmishën e të birit nga Egjipti, ai nisi ta ndjente që shumë larg kundërmimin karakteristik të të birit, kur këtë të fshehtë nuk ishte në gjendje ta ndjente askush tjetër!

Kur situatat shpirtërore ndikojnë edhe mbi gjërat e pajetë, kuptohet qartë se sa me kujdes duhet ta ruajë zemrën e vet njeriu i cili, pa asnjë dyshim, është pakrahasimisht më i ndje-shëm se sendet.



Një herë, duke kaluar nëpër zonën e quajtur *Vadi Muhassir* mes Arafatit dhe Muzdelifes, Profeti (s.a.s.) e nxitoi dukshëm ecjen. Të bërë kureshtarë për këtë veprim të tij, shokët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, ç’ndodhi që u nxitove këtu?”

Dhe ai iu përgjigj:

“Në këtë vend Zoti e shkatërroi ushtrinë e Ebrehesë!”

Një herë tjetër, duke u kthyer nga fushata tejet e mundimshme e Tebukut, për t’u çlodhur nën hije e për të gjetur ujë, shokët hynë në rrënojat e pallateve me gurë të gdhendur të fisit të Themudit. Kurse Profeti (s.a.s.) u tha:

“Këtu e shkatërroi Zoti fisin e Themudit. Mos merrni ujë këtu që të mos ju bjerë edhe juve pjesë nga ai ndëshkim!”

Shokët i thanë:

“O i Dërguari i Allahut, po ne i mbushëm caliket dhe gatuam brumë!”

Dhe Profeti (s.a.s.) u tha:

“Zbrazini ujërat, kurse brumin ua jepni deveve ta hanë!”
(Buhari, Enbija, 17)

Edhe njerëzit e mirë e të pajisur me kulturë shpirtërore, afërsinë, dashurinë dhe ekstatën e zemrave e bartin edhe në bisedat e tyre. Drita e të fshehtës së zemrave u reflektohet bashkëbiseduesve, zemrat e të cilëve, pastaj, marrin pjesë nga begatia e tyre shpirtërore.

Në lidhje me këtë çështje, Zoti urdhëron:



يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَكُونُوا مَعَ الصَّادِقِينَ

“O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe rrini ba-shkë me besnikët!” (et-Tevbe, 119)

Tejçimi i situatave realizohet, siç u trajtua edhe më lart, në raport të drejtë me afërsinë dhe dashurinë. Për t’u bërë një besimtar i përplotësuar, për të marrë rezultatin e dëshiruar në këtë tejçim, është kusht shoqërimi me njerëzit e mirë dhe besnikë, domethënë, t’i duash ata dhe të bëhesh i afërt për ta.

Për këtë arsye, koncepti **“rabita - lidhje”** që shpreh lidhjen e brendshme, esenciale, mes gjërave, këtu, konkretisht, mes nxënësit që i nënshtrohet edukimit mistik dhe njerëzve të mirë e besnikë të atij mjedisi, me qëllim për ta mbajtur gjallë e të freskët afërsinë dhe dashurinë ndaj tyre, është kthyer në një praktikë të bërë rregull.

Duhet menduar se një njeri që ndodhet në rrugën e mëkatit e të së keqes, mund të shpëtojë prej shumë humbjeve shpirtërore, ndoshta të pazëvendësueshme, me anë të ndikimeve pozitive të kësaj *lidhjeje*. Krahas kësaj, me anë të begatisë së *lidhjes ndjesore*, mund të bëhet i merituari i kushedi sa përfitimeve shpirtërore!

Me anë të fuqisë së afërsisë dhe dashurisë, lidhja ndjesore krijon, në ndijimet dhe ndjenjat, një vijë shpirtërore sublime dhe mes individualiteteve që ndodhen në dy skajet e kësaj vije, nis një marrëdhënie shpirtërore **njësimi dhe identifikimi**.

Në fund të këtij procesi lidhjeje, njësimi dhe identifikimi, ai që do, pothuaj asgjësohet në qenien e atij që do. Këtë situatë shpirtërore të realizuar vetëm si rezultat i një dashurie



pasionante, poeti Mevlana Xhelaledin Rumi (k.s.) e shpreh kë-shtu:

“Lumi që arrin në det, mbaron së qeni lumë. Ai tashmë është një pjesë e detit. Buka që hamë tretet në trupin tonë duke u bërë pjesë e tij. Edhe qenia e një njeriu që do, humbet në qenien e atij që do po me atë forcë që do!”

Në vazhdim, duke e përshkruar gjendjen shpirtërore pas këtij procesi lidhjeje, njësimi e identifikimi, shprehet kështu:

“Erdhi pasioni dhe më mbushi të tërin si gjaku damarët. Më hoqi mua prej meje dhe ma mbushi qenien me qenien e atij që dua. Miku ma mbushi tërë trupin dhe prej meje mbeti vetëm emri im. Gjithçka tjetër, vetëm Ai!..”

Kjo është cilësia e quajtur në mistikë “fenafil’lah” dhe “bekabil’lah”¹⁰. Ndërkaq, për të përparuar kaq shumë në da-shurinë dhe afërsinë me Zotin, duhet që zemra të fitojë një denjësi të tillë që të ketë mundësi për ta përballuar atë, gjë që mund të arrihet me anë të praktikimeve konfidenciale njerëzore.

Hz. Ebu Bekri (r.a.), në çdo takim të ri e në çdo bisedë të re me Profetin (s.a.s.) përjetonte një situatë të re vrulli dhe dall-die ndjesore. Edhe kur i ndodhej pranë, në vend që dashuria dhe malli për të t’i qetësoheshin, i shtoheshin. E, kështu, kur një ditë ia vuri para Profetit gjithë pasurinë duke ia falur me gjithë zemër, mori, si përgjigje, falenderime dhe komplimente profetike të cilat, me gjithë vlerën e lartë të tyre, nuk e këna-qën, sepse e vunë, qoftë edhe në dukje, në pozitën e “tjetrit”,

10 Fenafil’lah: humbje në Zotin. Bekabil’lah: gjetje e pavdekësisë me Zotin.

kurse ai e ndjente veten të shkrirë në qenien e Profetit, prandaj dhe, me dhimbje dhe drojtje, i tha:

“O i Dërguari i Allahut! Mos vallë pasuria, jeta dhe çdo gjë tjetër e imja janë veç prej **teje?**”

Një ditë, kur dëgjoji se Profeti (s.a.s.) ishte sëmurë, edhe Hz. Ebu Bekri, Besniku, ra në shtrat i sëmurë.

Ishte ky njësim dhe identifikim mes tyre që Profeti (s.a.s.) qe shprehur kështu një ditë:

“Ebu Bekr është prej meje, edhe unë jam prej tij. Ebu Bekr është vëllai im në këtë botë dhe në jetën e pasme!” (Tirmidhi, Menakib, 20)

Ja, kështu, ata që i shtrojnë zemrat para miqve të Zotit me sinqeritet, nënshtrim dhe thjeshtësi, shndërrohen në vendshfaqjen e bukurive që u drejtohen. Ashtu si hëna në qiell që, megjithëse s’ka dritë vetë, fiton veti dritëdhënëse duke e reflektuar dritën e marrë nga dielli, njerëz të tillë bëhen si kandilë ndriçues në natën njerëzore të mbuluar nga errësira!

Zoti ynë! Dhurojua edhe zemrave tona bukuritë e bisedave mes Profetit (s.a.s.) dhe shokëve të tij! Dhe na bashkone me bashkësinë e njerëzve të mirë!

Amin, ashtu qoftë!

W



SHPIRTI DHE KURMI

(Mbreti dhe skllavja)

Kjeriu i krijuar në mënyrë të përkryer e bujare, në ndryshim nga frymorët e tjerë, përbëhet prej dy shpirtrash. I pari është shpirti ose fryma që ndodhet në të gjithë frymorët dhe që merr fund së bashku me kurmin.

Në Kur'an thuhet: **"... dhe i fryva atij nga shpirti im..."** (el-Hixhr, 29) Ky është shpirti i dytë, shpirti cilësor i dërguar nga Zoti që bashkohet me kurmin në një etapë të caktuar të zhvillimit të fetusit në mitër. Ky shpirt ka edhe një emër tjetër: "shpirti-mbret". Dhe, më në fund, origjina e kurmit është toka.

Meqë prirja e çdo gjëje për t'u kthyer në origjinën e vet është e natyrshme dhe e bashkëlindur, kurmi u përshtatet të mirave të krijuara nga toka, prirja dhe dëshira e kurmit plotësohet dhe merr fund kur hyn në dhé. Ndërkaq, meqë shpirti cilësor vjen nga fryma hyjnore, edhe prirja e tij është e lartë dhe sublime. Kështu, edhe jeta është, te çdo njeri, skenë e një lufte të përvetshme mes shpirtit dhe kurmit. Rezultati i luftës midis prirjeve të lindura nga origjina e shpirtit dhe prirjeve të lindura nga origjina e kurmit siguron pikën e stabilitetit



mes pozitës më të ulët dhe pozitës më të lartë të vlerave nje-rëzore.

Në ngjarjen e mëposhtme, poeti Xhelaledin Rumi na e përshkruan në mënyrë të figurshme luftën për sundim mes shpirtit dhe frymës.

Ishte një mbret i pasur e fuqishëm. Një ditë, ai doli për gjah së bashku me oborrtarët.

Në rrugë e sipër, mbreti hasi në një skllave të bukur. Ajo ishte aq e bukur, sa e plagosi në zemër mbretin duke e bërë për vete në çast. Mbreti i gjuajtur dhe i plagosur vetë ndër-sa kishte dalë për gjah, për t'u freskuar sadopak nga zjarri i da-shurisë ku kishte rënë, e bleu skllaven duke dhënë para dhe dhurata të shumta, sepse, ashtu si zogu që përpëlitet brenda në kafaz, edhe zemra e mbretit përpëlitej tërë mundim brenda kafazit-kurm.

Pasi e bëri të vetën skllaven, mbreti pandehi se e gjeti, më në fund, lumturinë! Por gëzimi i tij nuk zgjati shumë. Skllavja u sëmur nga një sëmundje shumë e rëndë dhe nisi të dobësohej çdo ditë e më shumë duke u shkrirë si qiri. Erdhi çasti që ajo të mos ngrihej më dot nga shtrati. I mjerë dhe i dëshpëruar, mbreti mblodhi të gjithë mjekët e dëgjuar dhe iu lut me lot e përlulesi duke lënë mënjanë kërkesat e pozitës së tij të lartë:

“Jeta ime dhe e skllaves janë në duart tuaja!”

Edhe mjekët iu përgjigjën me krenari:

“Imzot! Secili prej nesh është, në mjekësi, Jezusi i kohës! Nuk ka sëmundje që të mos gjejë shërim në duart tona!”

Mjekët nuk thanë “në dashtë Zoti”! Dhe ky egoizëm i turpëroi ata. Barërat që përgatitën dhe ia dhanë skllaves së



sëmurë jo vetëm që s'e shëruan atë, por e sëmurën edhe më keq! Skllavja e gjorë mbeti kockë e lëkurë!

Mbretin e mbërtheu dëshpërimi. Klithjet që i dilnin nga gjoksi i përvëluar si shkretëtirë, ia bënë fytin nyje-nyje.

Pasi pa dobësinë dhe paaftësinë e mjekëve, mbretit i erdhën, më në fund, mendtë në kokë, shkoi me vrap në faltore dhe ra në gjunjë me ballin përtokë. Duke e qullur vendin me lot, ai iu përgjërua Zotit:

“Zoti im! Ti i di të gjitha dëshirat e zemrave! Unë u robërova pas një skllaveje! O shëruesi i vërtetë i lëngatave, mos më kthe prapë!”

Dhe u lut mbreti, u lut, u lut...

Para lutjeve të mbretit të dëshpëruar si det i dallgëzuar, edhe mëshira hyjnore nisi të fryhet si det i dallgëzuar duke bërë që t'i pranohet lutja. Zoti ia bëri të ditur me anë të frymëzimit se do t'i dërgonte për mjekim njërin ndër robtë e Tij të mirë e të vërtetë, një udhëzues hyjnor.

Mbreti vrapoi i gëzuar për në pallat dhe vuri re se mjekuesi kishte ardhur. Iu morën sytë nga drita që lëshonte pamja e tij. Para të ardhurit, edhe drita e diellit dukej e zbehtë. I shtangur nga mahnitja, mbretit i dukej se kishte mbetur pa kokë e pa këmbë! Gjëra të pandjera ndonjëherë më parë ndjeu dhe, në mënyrë të pavullnetshme, i foli kështu mikut:

“Në të vërtetë, unë dua jo atë skllaven, por ty! Por në këtë botë punët ndryshojnë. Urtësia e Zotit lind shkaqe pas shkaqesh!”

Dhe e përqafoi mikun fytyrëditë me dashuri dhe e futi në zemër. Nga njëra anë ia puthte dorën e ballin, nga ana tjetër mendonte me vete: *“More, po këta njerëzve u janë veshur sytë*



që nuk e shohin këtë të vërtetë, që nuk e vënë re këtë hënë të ndritshme?" I pushtuar nga një gëzim i papërshkruar, mendonte: "Ja se ç'thesar gjeta me durim në mjerimin ku rashë!" Pastaj foli me zë të lartë duke iu drejtuar mikut:

"O ti, dhurata e Zotit tim! O ti, kuptimi i gjallë i hadithit "Durimi është çelësi i gëzimit!" (Dejlemí, Musned, 3844) Mirë se erdhe! E kuptova se ç'mjerime na bien në kokë pa ty! Edhe qiejt e gjerë na vijnë ngushtë e nisin të na shtrëngojnë!"

Dhe e mori mbreti mikun për ta shpënë te skllavja e sëmurë.

Miku ishte një mjek shpirtëror, një mbret i shpirttrave. Ai kishte një mendim dhe zgjuarsi parashikuese të thellë. Me anë të dritës së Zotit, ia vuri diagnozën skllaves që në shikimin e parë.

Skllavja ishte një e sëmurë zemre. Ajo s'kishte asnjë sëmundje në trup. Kurse zemrën e kishte të vranë e të copëtuar!

Mjeku shpirtëror ia përshkroi me pak fjalë mbretit gjendjen e skllaves dhe, për ta bërë skllaven të fliste, i nxori jashtë të gjithë pranishmit.

Mjeku shpirtëror nisi t'i bënte pyetje të ndryshme të sëmurës duke ndjekur kundërveprimin e saj. Kështu, kur mjeku përmendi fjalën **Samarkand**, pulsi i të sëmurës nisi të rrahë fort. Fytyra nisi herë t'i skuqej e, herë, t'i zverdhej. Pastaj, kur mjeku përmendi fjalën **argjendar**, ajo u soll në atë mënyrë sa e zbuloi krejtësisht sekretin e saj.



Mjeku shpirtëror që e kuptoi, tashmë, si qëndronte puna, i kërkoi mbretit të çonte njerëz për ta sjellë aty argjendarin e Samarkandit.

I paaftë për të kundërshtuar, mbreti e zbatoi kërkesën e mjekut. Dhe skllavja që u bashkua, tashmë me të dashurin e saj, nisi të përmirësohej çdo ditë e më shumë dhe shpejt iu rikthyen shëndeti, bukuria dhe hijeshia e dikurshme.

Ndërkaq, mjeku shpirtëror që kishte qëllim tjetër, filloi të zbatonte pjesën e dytë të detyrës.

Mjeku i bëri argjendarit një sherbet shumë të fortë. Ai e piu sherbetin dhe në çast nisi të treftej në sy të skllaves. Argjendari u dobësua e u shëntua. I dolën sheshit të gjitha shëmtitë!

Sa më shumë që të dobësohej e të shëmtohej argjendari, aq më shumë ftohej skllavja prej tij gjersa, më në fund, ai vdiq dhe u fut në dhé. Kurse skllavja shpëtoi nga pasionet tokësore, u çlirua nga vuajtjet dhe u pastrua.

Kjo ngjarje e treguar në veprën poetike “Mesnevi” të poetit Xhelaleddin Rumi, nuk është një ngjarje e vërtetë dashurie mes një mashkulli dhe femre.

Ashtu siç e sqaron edhe vetë poeti që në krye, **kjo ngjarje është, në të vërtetë, historia e hallit tonë!**

Ky tregim përmban aventurën tonë me një mijë e një prova e urtësi, të nisur pasi Allahu, Zoti ynë, i fryu shpirt kurmit tonë. E thënë ndryshe, është tregimi i Moisiut dhe Faraonit brenda vetes tonë!

Ndarja e shpirtit nga bota e tij shpirtërore për t’u dërguar në këtë botë dhe, pastaj, pas hyrjes së tij në një kurm për



një farë kohe dhe rikthimit në botën e vet pas një maturimi frymor në atë kurm janë përshkruar në këtë tregim përmes ngjarjeve të tij në mënyrë shumë kuptimplote.

Kështu, **mbreti** për të cilin flitet në tregim, përfaqëson **shpirtin hyjnor** të fryrë në kurmin e njeriut.

Skllavja është simbol i **frymës, egos** së njeriut dhe **argjendari** pas të cilit qe pasionuar ajo, simbol i **dëshirave dhe interesave tokësore, i tërheqjeve të përkohshme e të vjetërueshme**.

Kurse **mjeku shpirtëror** është **mjeku hyjnor**, domethënë, **prijësi i përkryer**.

Sipas këtyre simboleve, historia e njeriut është kështu:

Mbreti ose shpirti hyjnor i larguar nga qenia pranë Zotit në pallatin hyjnor, del për gjah shpirtëror, por, kur përballet me skllaven, pra, me kurmin njerëzor, jepet pas saj duke e harruar postin dhe nderin e vet. Ai e harron adhurimin ndaj Zotit që është qëllimi i krijimit, bëhet gjah apo viktimë e egos dhe skllav i tij. Ai nis të bëjë gjithçka që ka në dorë për t'ia plotësuar kërkesat egos dhe për ta kënaqur atë!

Ndërkaq, fryma apo egoja njerëzore, për shkak të natyrës së vet, i mban sytë vazhdimisht poshtë, drejt gjërave të ulta duke i pandehur ato për lumturi. Dashuria e saj për argjendarin shpreh dashurinë për kërkesat dhe dëshirat tokësore, për arin e argjendin, shpreh adhurimin për to. Prandaj ajo nuk ia hedh sytë fare shpirtit. Sa më shumë që të vrapojë shpirti pas saj, aq më shumë largohet ajo prej tij!

I dëshpëruar nga kjo, shpirti kërkon ndihmë nga mjekët. Por ata nuk bëjnë dot gjë, sepse sëmundja është shpirtërore, pra, i sëmuri ka nevojë për një mjek shpirtëror.



Pasi mjeku i jep argjendarit sherbet dhe ai, duke u tretur e shëmtuar gjersa vdes, bie nga sytë e skllaves, mbreti ose shpirti hyjnor e kupton të vërtetën dhe shpëton nga skllavëria e saj, pra, nga skllavëria e frymës, egos.

Nga ana tjetër, lidhja dhe dashuria pasionante mes skllaves dhe argjendarit, për të cilën flitet në tregim, shpreh pasionet tokësore të njeriut, të cilat vjen një ditë e marrin fund ashtu si në tregim. Poeti shprehet kështu:

“Dashuria e vdekëtarëve nuk është e përhershme. Të vdekurit nuk na kthehen më prapë. Kurse dashuria e atyre që s’odesin, mbetet çdo çast më e freskët dhe e hijshme se gonxhja! Mësoje këtë dhe mos u kënaq me dashuritë e përkohshme, mos u deh e mos u humb pas tyre! Ti zgjidh dashurinë e vërtetë ku kanë gjetur lumturi profetët, të urtët! Dashuria e atij që është i pavdekshëm të bën ty ta da-shurosh të dashurin e vërtetë! Dashuria e përkohshme që zë vendin e dashurisë së vërtetë, mbetet e kufizuar kur nuk ka ndonjë shkallë për t’u ngjitur zemra te dashuria ndaj Zotit. Ai, zemra e të cilit ngec pas Lejlasë, nuk mundet të arrijë te Zoti, për rrjedhojë, nuk mund të gjejë qetësi!”

Sahabet, shokët e Profetit (s.a.s.), qenë lidhur dhe shtënë fort pas tij vetëm pasi i patën kapërcyer të gjitha dëshirat e kësaj bote, dhe, çdo dëshire të tij i qenë përgjigjur me gjithë zemër:

“Nënë e babë t’u bëfshin kurban, o i Dërguari i Allahut!”

Shfaqja më e bukur e dashurisë për Profetin që qe bërë truall për këtë nënshtrim dhe sakrifikim, është Hz. Ebu Bekr Besniku (r.a.). Aq e thellë ishte dashuria e tij për Profetin, sa, edhe kur ndodhej pranë tij, Hz. Ebu Bekri digjej nga malli për të!



Shpirti i njeriut sado afër të jetë me trupin përta u përket veprimeve, është krejt i ndryshëm përta i përket strukturës së vet. Me strukturë të pandryshueshme, ai është i pavdeks-hëm dhe i përherëshëm. Kurse kurmi, nga çasti kur krijohet e gjer sa të bëhet dhé, kalon nga një gjendje në tjetrën. Ndodh kështu sepse shpirti vjen nga një pozitë e lartë, kurse kurmi formohet nga një botë e vdekshme.

Poeti Junus Emre shprehet kështu:

“Nëse vdes, kurmi vdes, shpirti s’është i tillë që vdes!..”

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) ka thënë:

لَا أُحْصِي ثَنَاءَ عَلَيْكَ أَنْتَ كَمَا أَثْنَيْتَ عَلَيَّ نَفْسِكَ

“O Zot! Jam i paafte për të të njohur Ty me një intuitë të denjë për Ty dhe për të të lavdëruar e madhëruar Ty ashtu siç duhet! Ti je siç e ke përshkruar vetë individualitetin tënd!..”

(Gazaliu, Ihjau Ulumiddin, II, 719)

Shpëtimi nga dora e frymës, egos, i ngjet zogut që del nga kafazi në liri. Atëherë për shpirtin janë hapur dyert e larta të qiejve! Në Kur’an thuhet:

وَلَا تُلْقُوا بِأَيْدِيكُمْ إِلَى التَّهْلُكَةِ

“... dhe mos e hidhni në rrezik veten me dorën tuaj!..”

(el-Bakara, 195)

Këtë ajet, komentuesit e Kur’anit e kanë komentuar në mënyrë sinjifikative kështu: Këtu i bëhet thirrje shpirtit i cili ndodhet në pozitën e mbretit në strukturën e njeriut, të mos e shkatërrojë veten duke rënë rob në duart e skllaves së bukur ego që ecën në rrugën e gjërave të ulta...



Për të mos rënë në një gjendje të tillë, Profeti këshillon:

“Në këtë botë, bëhu si një i vetmuar, si një udhëtar!” (Buhari, Rikak, 3; Tirmidhi, 2333).

Ibni Omeri (r.a.) që përcjell këtë hadith, thotë:

“Kur të bëhet mbrëmje, mos e prit mëngjesin! Pra, kur të jesh duke ecur në rrugën e përjetësisë, mos ndalo duke thënë: “U err. Pa të shplodhem pak dhe, kur të gdhihet, nisem prapë për rrugë!” Ti je një udhëtar që ke para një rrugë të gjatë. Ti nuk ke kohë për të humbur. Pra, mos u lësho e mos qëndro!

Pastaj, kur të gdhihet, mos e prit mbrëmjen! Pra, mos mendo se ke para rininë dhe një kohë të gjatë që, gjithsesi, të mjafton për të shkuar, mos ia lër punën përtacisë! Mendo se vdekja mund të të kapë shumë më parë dhe sipas këtij mendimi vepro!

Dhe, kur të jesh i shëndetshëm, merr masa për kohën kur mund të sëmuresh, kurse për vdekjen përgatitu gjatë gjithë jetës!” (Rijazu’s-Salihin, III, 437-438)

Mbreti i të diturve të shpirtit, Hz. Hydaji i paralajmëron kështu njerëzit për të mos e humbur lumturinë e përjetshme:

*Trëndafil i çelur në kopshtin e përjetësisë ndërsa qe,
Në folenë tënde të mëparshme bilbil ndërsa qe,*

*Pate mirësinë të vish në këtë botën tjetër;
Kthehesh një ditë në folenë e vjetër...*

*Kjo botë, një iluzioni, një ëndrre i ngjan,
Jeta njerëzore në të, si uji rrjedh e shkon;*



*Pra, kujdes, iluzionit s'ke pse i beson,
Mos u mbështet te era që fryn, te uji që rrjedh e shkon!..*

Nuk ka dyshim se njerëzit që mendojnë vetëm për kurmin, e kanë shkuar kot jetën! Kurse njerëzit parashikues që mendojnë për shpirtin, janë nisur drejt së vërtetës!

Kur teprohet, ushqimi i kurmit bëhet i dëmshëm, kurse ushqimi i shpirtit, sa më i shumtë që të jetë, aq më i dobishëm bëhet!

Edhe kurmi duhet mbrojtur sepse është kallëpi i shpirtit, ndërkaq, nuk duhet treguar kujdes më shumë se ç'është e nevojshme. Sepse esencial është shpirti!

Imam Gazaliu e përcakton kështu masën e marrëdhënieve shpirt-kurm:

“Shpirti është si një kalorës, kurse kurmi, si një kalë. Kalorësi duhet të jetë i aftë, kurse kali, i shëndoshë e i fortë. Kalorësi i aftë e çon kalin nga të dojë. Kali që mban mbi vete një kalorës të paaftë, vjen një çast që prapësohet e rrokulliset në greminë bashkë me të!”

O Zot! Mos na bëj ne, brenda këtij kafazi-kurm, të je-pemi pas dëshirave dhe pasioneve të kurmit! Duke na e mbrojtur bukurinë dhe delikatesën e shpirtit, na oriento drejt selisë së takimit me Ty!

Amin!..

W



BESIMI DHE PROVA

Qëllimi kryesor i mistikës islame¹¹ është që, duke e stolisur njeriun e zakonshëm me sinqeritet dhe principialitet besimor¹², t'i japë atij formën e përsosur. Sepse njeriu ka ardhur në këtë gjithësi të pajisur me rryma fuqie dhe të fshehta hyjnore që do ta bënin të bashkohej me Zotin e vet, për t'u përgatitur për botën e përjetësisë dhe, mbështetur mbi këtë urtësi, është kushtëzuar me prova të ndryshme. Ndërkaq, për t'i merituar dhuntitë e përgatitura për të në botën e përjetshme, njeriu është i detyruar t'i fitojë provat duke arritur të ketë një zemër të pastër.

Eshtë për këtë arsye që, në çështjen kauzale të besimit dhe virtytit, njerëzit kalohen nëpër mijra etapa plot vuajtje, brenga, ankthe e dhimbje. Kështu, në rrugën e së Vërtetës, besnikët e kauzës hyjnore me perversët diferencohen nga njëri-tjetri. Prandaj, vetëm besimi është i pamjaftueshëm. Eshtë e domosdoshme që, duke e zbukuruar besimin me aktin e

¹¹ Në original: tasavvuf.

¹² Në original: ihlas.



mirë, të arrihet një nivel i lartë që do të japë mundësi për t'i kaluar me sukses provat hyjnore.

Allahu i Lartë thotë kështu në Kur'an:

الم أَحْسِبَ النَّاسُ أَنْ يَتْرُكُوا أَنْ يَقُولُوا آمَنَّا وَهُمْ لَا يُفْتَنُونَ
وَلَقَدْ فَتَنَّا الَّذِينَ مِنْ قَبْلِهِمْ فَلَيَعْلَمَنَّ اللَّهُ الَّذِينَ صَدَقُوا
وَلَيَعْلَمَنَّ الْكَاذِبِينَ

“Elif. Lam. Mîm. A mos vallë njerëzit pandehin se do të lihen vetëm me thënien “besuam”, pa u vënë në provë?”

Me shprehjen si më poshtë, bëhet e qartë se besimi me provën janë pothuaj të ndërthurur me njëri-tjetrin:

“Ne i vumë në provë edhe paraardhësit e tyre. Sigurisht, Allahu e di se kush janë besnikët (e çështjes së besimit dhe fesë) dhe kush janë gënjeshtarët!” (el-Ankebut: 1-3)

Sipas kësaj, besimi është një favor dhe prova, etaloni i tij, kurse mbrojtja e besimit me anë të durimit dhe nënshtrimit që kërkohet nga njeriu, është kundërvlera e besimit. E thënë ndryshe, me anë të provave të caktuara për njerëzit – sipas mundësive përballuese të tyre – me qëllim që t'i bëjë ata ta kuptojnë vlerën dhe lartësinë sublime të favorit që u ka dhënë, Zoti pothuajse kërkon prej tyre një kundërvlerë. Pohimi i ajetit të mëposhtëm është një shfaqje e kësaj të vërtete:

إِنَّ اللَّهَ اشْتَرَى مِنَ الْمُؤْمِنِينَ أَنْفُسَهُمْ وَأَمْوَالَهُمْ بِأَنْ لَهُمُ الْجَنَّةَ

“Allahu ka blerë nga besimtarët pasurinë dhe jetën e tyre me xhennet...” (et-Tevbe: 111)

Për rrjedhojë, sakrifikimi me gjithë dëshirë në rrugën e Zotit i kundërvlerave të kërkuara prej Tij (mall, pasuri, jetë,



etj.) me qëllim për të fituar pëlqimin hyjnor, është pretekst i përsosjes së besimit. Është jashtë çdo dyshimi se pasionet dhe vuajtjet që heq besimtari në këtë botë prove janë kundërvlera që i paguan ai fitimit në botën e ringjalljes.

Nga ana tjetër, dhuna e ushtruar nga mosbesimtarët e dhënë pas ambicjeve të kësaj bote mbi ata që përpiqen të jetojnë sipas Kur'anit dhe fesë, është për ta kundërvlera persekutuese e një ndëshkimit skëterror të mbushur plot ankth dhe fatkeqësi. Sepse ata e meritojnë ndëshkimin nga dy drejtime: e para se nuk besojnë dhe e dyta, se ushtrojnë dhunë dhe pa-drejtësi mbi besimtarët.

Në kohë të tilla të vështira, arritja e sinqeritetit dhe principialitetit në besim duke bërë adhurime dhe duke kryer punë të mira si dhe hyrja në universin shpirtëror të të Dërguarit të Allahut (s.a.s.), janë të domosdoshme.

Ç'është puna e mirë ose, ndryshe, akti i mirë?¹³ Është të besosh, të kryesh adhurime, të shfaqësh një moral të lartë dhe të përvetësosh e zbatosh parime jetësore të drejta në përputhje me besimin, adhurimet dhe moralin e lartë, duke i realizuar të gjitha këto për pëlqim të Allahut dhe kënaqësi të Profetit duke mos marrë parasysh kushtet që do të duhet të përballosh dhe çmimin që do të duhet të paguash për këtë. Mistikët e kanë përkufizuar aktin e mirë si respekt ndaj Krijuesit¹⁴ dhe dhembshuri ndaj krijesave¹⁵ të Tij. Realizimi i kësaj veçanërisht në kohë të vështira përsa i përket fesë dhe besimit është domosdoshmëri e mëshirës dhe dritës hyjnore. Në Kur'an thuhet:

¹³ Në origjinal: amel-i salih.

¹⁴ Në origjinal: tadhim li-emrillah.

¹⁵ Në origjinal: shefkat li-hallkil'lah.

“... (O besimtarë!) **Po qe se tregoni durim dhe qëndresë** (për ta jetuar fenë e Allahut duke i kapërcyer vështirësitë e shqetësimet), **mashtrimet dhe kurthet e tyre** (e armiqve të Islamit) **kurrë nuk do t’ju dëmtojnë juve, sepse Allahu i ka nën vëzhgim bëmat e tyre!**” (Al-i Imran: 120)

Po të shihet historia islame, vihet re se, në sajë të ndihmës së Allahut, muslimanët kanë arritur suksese të mëdha me forca shumë të vogla. Bedri, Muteja, dalja në Spanjë e Tarik bin Zijadit, etj. janë vetëm disa shembuj të kësaj të vërtete. Nga ana tjetër, edhe shteti i shkëlqyer osman që e vuri nënshkrimin me emrin hyjnor në të katër anët e botës, me katërqind kalorës është themeluar!

Dhe kjo tregon se muslimanët bëhen të suksesshëm me aq sa janë të sinqertë dhe principialë në besim. Kur janë të sinqertë e principialë, bëhen një fuqi e pamposhtur dhe, kur e humbin sinqeritetin dhe principialitetin në besim, e humbin edhe fuqinë. Në lidhje me këtë, Allahu i Lartë urdhëron:

إِنْ يَنْصُرْكُمُ اللَّهُ فَلَا غَالِبَ لَكُمْ وَإِنْ يَحْذُلْكُمْ فَمَنْ ذَا الَّذِي يَنْصُرُكُمْ مِنْ بَعْدِهِ وَعَلَى اللَّهِ فَلْيَتَوَكَّلِ الْمُؤْمِنُونَ

“(O besimtarë! Mbahuni ju në rrugën e Zotit pas sinqeritetit, durimit dhe devocionit!) **Po ju ndihmoi Allahu, s’ka kush që mund t’ju mundë...** (Kurrë mos u ndani nga rruga e Tij duke u sjellur me indiferentizëm dhe injorancë dhe mos bëni lëshime në fe, sepse) **po ju la Allahu përmbys, kush mund t’ju ndihmojë ju pastaj? Prandaj muslimanët duhet t’i besojnë dhe dorëzohen vetëm Allahut!**” (Al-i Imran: 160)

Shkurt, ecja në rrugën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij pavarësisht nga të gjitha vështirësitë dhe pengesat, është tre-



gues i besimit të muslimanit. Dhe çdo musliman duhet t'ia paguajë Zotit kundërvlerën e dhuntisë së besimit. Për ata që e paguajnë këtë kundërvlerë, në Kur'an është përdorur shprehja "ata që i japin borxh Allahut" dhe është pohuar se Zoti do t'ua shpërblejë këtë me të tepërt:

مَنْ ذَا الَّذِي يُقْرِضُ اللَّهَ قَرْضًا حَسَنًا فَيُضَاعِفُهُ لَهُ أَضْعَافًا كَثِيرَةً

"Kush është ai që i jep Allahut një borxh të mirë dhe, pastaj, Allahu t'ia paguajë atij me të tepërt?.." (el-Bakara: 245)

Prandaj, është e pamundur të kërkohet diçka pa e paguar kundërvlerën e saj. Në Kur'an thuhet:

"(O besimtarë!) A mos pandehët ju se do të hyni në xhennet pa ju rënë mbi krye ato që u patën rënë paraardhësve tuaj? Aq shumë patën vuajtur ata nga varfëria dhe shqetësimet, aq shumë qenë tronditur, sa, më në fund, profetët dhe besimtarët rreth tyre patën thënë: "Kur do të vijë ndihma e Allahut?" Dijeni se ndihma e Allahut është e afërt!" (el-Bakara: 214)

Në një hadith, Profeti porositi kështu:

"Besimtarët dhe besimtare të vihen në provë në vetvete, në fëmijët dhe në pasurinë e tyre, gjersa të takohen me Allahun të pastër e pa mëkate..." (Tirmidhi, Zuhd, 57)

Kjo do të thotë se urtësia e provave para të cilave vihet njeriu, janë jo vetëm për t'i dalluar besnikët dhe perversët nga njëri-tjetri, por, në të njëjtën kohë, për ta pastruar njeriun nga papastërtitë e mëkateve.

Është për këtë arsye që dhuna dhe padrejtësitë e ushtruar mbi besimtarët, edhe në u dukshin si persekutim mbi ta, janë favor. Mbi këtë ide ngrihet porosia:



“Sa të vuash, aq përfiton!”

Çdo gjë ka çmimin e saj. Është e pamundur të bëhesh zotërues pa u bërë i nënshtruar, të zotërosh diçka pa humbur diçka tjetër!

Para mrekullisë së profetit Musa, magjistarët e faraonit thanë:

“I besuam Zotit të botëve, Zotit të Musait dhe Harunit!”

Dhe ranë me ballin në tokë si shenjë nderimi ndaj Zotit. Ndërsa faraoni kokëtrashë u nxeh dhe u thirri sikur të donte të sundonte edhe mbi ndërgjegjet:

“I besuat pa ju dhënë leje unë, ë? Do t’jua pres këmbë e duar kithi dhe do t’ju var në litar!”

Por, të ekzaltuar nga besimi, magjistarët iu përgjigjën:

“E keqja jote s’na prek ne! Dëmi që mund të na shkaktosh ti, është i kësaj bote, kurse lumturia e jetës tjetër është e përjetshme!”

Dhe iu përgjigjën Zotit kështu:

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَتَوَقَّأْنَا مُسْلِمِينَ

“... Zoti ynë, na jep durim dhe na e merr jetën si muslimanë!” (el-Araf: 126)

Magjistarët e paguan besimin me këmbët dhe duart e prera dhe u bashkuan me Zotin si dëshmorë!

Në periudhat e para të krishterizmit, romakët dhe grekët paganë bashkë me idhujtarët e tjerë i nxirrnin besimtarët krishterë në cirqe që t’i copëtonin kafshët.



Edhe muslimanët e parë, gjatë 13 viteve të periudhës mekase të zhvillimit të Islamit, e paguan rëndë besimin e tyre dhe vetëm kur emigruan në Medine filluan të bëjnë një jetë më të qetë.

Historia e mohimit, herezisë, padrejtësisë dhe dhunës është e mbushur plot me shembuj të tmerrshëm të shpagimit hyjnor. Gjithashtu, ngjarjet tipike të dukura si fenomene natyrore janë, në fakt, jo dukuri spontane, por të lidhura me kup-time dhe urtësi të shumta. Fatkeqësitë natyrore vërtetohen si rrjedhoja të rregullsisë hyjnore. Zoti nuk është i padrejtë dhe mizor, por është një e vërtetë se këto fatkeqësi shfaqen kur njerëzit e meritojnë ndëshkimin. Zoti e bën të ditur këtë të vërtetë në Kur'an kështu:

وَمَا أَصَابَكُمْ مِنْ مُصِيبَةٍ فَبِمَا كَسَبَتْ أَيْدِيكُمْ

“Ndonjë fatkeqësi që mund t’ju bjerë mbi krye, në fakt e keni përgatitur vetë me duart tuaja!..” (esh-Shura: 30)

Pra, ata që u kundërvihen rregullsisë hyjnore dhe parimeve të shenjta, nuk mund t’i shmangen zbatimit të hidhur të shpagimit hyjnor!

Brenda të gjitha ndodhive fizike përmbahen në mënyrë të padukshme një mijë e një të fshehta që u tregohen profetëve dhe njerëzve të zemrës. Disa nga deklaratat kur’anore mbi këtë çështje janë si vijon:

“Sa e sa popuj të përkëdhelur nga mirëqenia i shkatërruam Ne! Ja gërmadhat e lëna prej tyre, një pjesë shumë e vogël e të cilave janë ribanuar përsëri. Ne u bëmë trashëgimtarët e atyre (të gjithave)!” (el-Kasas: 58)

“... Ja, pra, shih, si qenka fundi i mizorëve!” (el-Kasas: 40)



“Shumë breza të fuqishëm para tyre i shkatërruam; ata bënë strehime dhe kërkuan vrimë për t’u futur, por a shpëtuan? Pa dyshim, në këtë ka mësimë për ata që kanë ndjenja ose duan t’ua vënë veshin!” (Kaf: 36-37)

“Pastaj pas tyre sollëm breza të tjerë...” (el-Muminun: 42)

“Shumë vendbanime popujsh mizorë i rrënuam dhe, pas tyre sollëm shumë popuj të tjerë...” (el-Enbija: 11)

“... Pa dyshim, ndëshkimi i Tij është shumë i dhimbshëm, shumë i vështirë!” (Hud: 102)

“Me të vërtetë, shumë prej vendeve përreth jush i shkatërruam... Dhe i përsëritëm provat disa herë se ndoshta kuptojnë!..” (el-Ahkaf: 27)

“Me të vërtetë, Ne i shkatërruam të ngjashmit me ju! A nuk ka kush që të mendojë dhe të marrë mësim?” (el-Kamer: 51)

Zoti ynë është zotëruesi i një fuqie persekutuese që e ka shndërruar zjarrin e Nemrudit në trëndafilishte me anë të besimit të Ibrahimit, që e ka përmbysur mbretërimin e faraonit me anë të shkopit të Musait, që e ka bërë ushtrinë e Ebrehesë i cili është ngritur ta shkatërrojë Qaben, si një arë të lashtash të shkelur e të copëtuar me anë të zogjve të vegjël që kanë lë-shuar mbi ta gurë prej argjile të ngurtësuar, që i ka hapur profetit Muhammed (s.a.s.) horizontet e fitoreve duke e përforcuar me ushtarë të padukshëm në trajtën e engjëjve, erës dhe frikës!

Prandaj, çdo kundërshtues që ngre flamur kundër besimit dhe Islamit, është i dënuar të shkatërrohet nën kthetrat e tmerrshme të persekutimit hyjnor!



Zoti urdhëron në Kur'an:

وَلِلَّهِ خَزَائِنُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَكِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَا يَفْقَهُونَ

“... Thesaret e qiellit e të tokës janë të Allahut, por hipokritët nuk e kuptojnë këtë!” (el-Munafikun: 7)

Nuk duhet harruar se njeriu është i kushtëzuar me ligjet e jetës dhe vdekjes. Ç'marrëzi dhe ç'disfatë e tmerrshme është të mos e mbrosh dot besimin për shkak të indiferentizimit ndaj Allahut duke e nënvleftësuar atë (besimin) ndaj pozitive materiale prapëseprapë të dhëna nga Allahu i cili jep jetën dhe vdekjen!

Te njeriu, pajisjet materiale-shpirtërore si sytë, veshët, duart, këmbët, fjala, vetëdija dhe ndërgjegjja, të cilat i janë dhënë njeriut para së gjithash mbështetur mbi qëllimin final të krijimit, domethënë, për ta bërë njeriun të merituar të së vërtetës hyjnore, janë favore të larta të Zotit. **Sytë** janë dhënë për të parë përshndritjet objektive të së vërtetës; **veshët**, për të dëgjuar zërat orientuese hyjnore; **duart**, për të bërë mirë; **këmbët**, për kryer shërbime të dobishme; **fjalët**, për të shprehur rrjedhat ndjesore dhe kënaqjen e zemrës me përmendjen e Zotit duke kënduar fjalët hyjnore; **vetëdija**, për të rrokur rrjedhat e fuqisë hyjnore në botën e jashtme; **ndërgjegjja**, për të përmbledhur përshndritjet e shenjta dhe takimet shpirtërore në botën e brendshme.

Duhet ditur se prishja e fisnikërisë së krijimit, ndryshimi i asaj që ka krijuar Allahu janë të pamundur. Sado që të bëhen përpjekje për ta përhapur mohimin me anë të forcës apo shtrëngesës së formave të ndryshme, zhvillimi dhe filizimi i rrënjëve sublime të ngulura në thellësitë e ndërgjegjes dhe frymës besimore nuk mund të pengohet. Nevoja e njeriut për



t'iu afruar Zotit të vet, nuk mund të ndalohet. Këto gëzime sublime të krijimit nuk mund të parandalohen. Sepse fuqia hyjnore e ka përcaktuar nevojën për të besuar dhe afrimin te Zoti si **sunnetullah**, zakon hyjnor.

رَبَّنَا أَفْرِغْ عَلَيْنَا صَبْرًا وَثَبِّتْ أَقْدَامَنَا وَانصُرْنَا عَلَى الْقَوْمِ الْكَافِرِينَ

“... Zoti ynë! Na jep durim, na i forco këmbët (në besimin me sinqeritet dhe principlialitet) dhe na ndihmo kundër mohuesve!” (el-Bakara: 250)

رَبَّنَا وَإِنَّا مَا وَعَدْتَنَا عَلَى رُسُلِكَ وَلَا تُخْزِنَا يَوْمَ الْقِيَامَةِ

“Zoti ynë! Dhurona edhe neve atë që u ke premtuar profetëve dhe, në ditën e kiametit, mos na turpëro e mos na shkatërro!” (Al-i Imran: 194)

Amin, ashtu qoftë!

W



SINQERITETI NDAJ ALLAHUT¹⁶

mam Kushejriu tregon:

Një njeri i mirë pa në ëndërr Amr bin Lejsin e vdekur, ish heroin dhe sovranin e Horasanit, dhe bëri një bisedë me të.

“Si të trajtoi Allahu ty?” – E pyeti njeriu i mirë Lejsin.

“Allahu më fali!” – Iu përgjigj Lejsi.

“Ç’bëre ti që të fali Allahu? Ç’punë bëre sa ishe gjallë që meritove faljen e Allahut?” – E pyeti njeriu i mirë Lejsin.

Lejsi iu përgjigj kështu: “Një ditë kisha dalë në një vend të lartë. Prej atje u hodha një vështrim ushtarëve të mi dhe, duke më tërhequr vëmendjen numri i madh dhe shkëlqimi i tyre, dëshirova kështu: “Eh, sikur të kisha jetuar atëherë e të kisha marrë pjesë me këtë ushtrinë time në luftërat e Profetit e të kisha qenë një nga ata fatmirët që patën dhënë jetën për të!” Ja, pra, për këtë qëllimin dhe sinqeritetin e dëshirës sime më trajtoi Allahu me mëshirë, m’i fali mëkatet dhe më shpërbleu me dhuntitë e Tij të pafundme!”

¹⁶ Në original: ihlas.



Kjo ngjarje është një shembull i bukur që tregon se sa i rëndësishëm është sinqeriteti për besimtarin. Kështu, si rezultat i sinqeritetit të tij, njeriu bëhet i merituari i shumë e shumë favoreve edhe prej një pune të pakryer. Profeti (s.a.s.) porositi:

نِيَّةُ الْمُؤْمِنِ خَيْرٌ مِنْ عَمَلِهِ

“Qëllimi (synimi dhe sinqeriteti besimor) i besimtarit është më i dobishëm se akti i tij!” (Sujuti, Xhamiu’s-Sagir, II, 194)

Sepse synimi dhe sinqeriteti besimor janë akte të zemrës. Në këndvështrimin e Islamit, vlera e akteve është ekuivalente me qëllimin dhe sinqeritetin që bëhen shkak për realizimin e tyre. Kështu, konkluzioni (vlerësimi juridiko-fetar) mbi një akt mbështetet mbi synimin që vë personi me atë akt. Hadithi profetik mbi këtë çështje thotë kështu:

إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ

“Aktet varen (dhe vlerësohen) nga qëllimet...” (Buhari, Iman, 41; Muslim, Imare, 155)

Nisur nga kjo, parimisht, të gjitha aktet apo punët e mira, duke filluar me adhurimet, duhen kryer duke vënë si synim pëlqimin e Allahut, gjë që është e mundur me anë të sinqeritetit besimor, ihlas. Ihlasi ose principialiteti dhe sinqeriteti besimor është kryerja e akteve duke patur si synim vetëm pëlqimin hyjnor pa lëshuar mbi to hijen e synimeve dhe qëllimeve vetiake, materiale e egoistike. Siç është shpirti për trupin, është dhe principialiteti dhe sinqeriteti besimor për aktin. Akti pa principialitet dhe sinqeritet besimor është thjesht një lodhje e kotë e mangët në thelb.



Sinqeriteti (principliteti dhe sinqeriteti) besimor është, në synimin për t'iu afruar Zotit, mbrojtja e zemrës nga çdo lloj interesi material e temporal.

Kurse fryti i sinqeritetit është mirësia.¹⁷Mirësia është adhurimi dhe sjellja e njeriut sikur të ndodhej para Zotit, është ndjenja e të qenit në çdo çast nën vëzhgimin hyjnor.

Sinqeriteti i jep mundësi njeriut të meritojë pëlqimin hyjnor që është dobia dhe mbarësia më e madhe. Ajo çka kërkon Allahu nga aktet e krijesave është sinqeriteti, orientimi i tyre kah pëlqimi i Tij. Në Kur'an urdhërohet:

“(O i Dërguar!) Pa dyshim, Ne ta zbritëm ty Librin për hir të së vërtetës, prandaj adhuroje ti Allahun me sinqeritet!” (ez-Zumer: 2)

“Thuaj: “Unë jam urdhëruar ta adhuroj Allahun duke qenë i sinqertë në adhurimin ndaj Tij!” (ez-Zumer: 11)

I përzënë nga audienca hyjnore, Iblisi (djalli) **“Tha: Zoti im, meqë më përzure, unë do t’ua bëj atyre (njerëzve) mëkatet të bukura dhe do t’i largoj nga rruga e drejtë të gjithë me përjashtim të robve të tu të sinqertë!”** (el-Hixhr: 39-40)

Siç kuptohet nga ajetet, djalli mund t’u bjerë në qafë vetëm e vetëm atyre që tregojnë dobësi në sinqeritet, por nuk mund të ushtrojë asnjë ndikim mbi njerëzit e sinqertë. Si kundërpërgjigje ndaj fjalëve të djallit, Zoti thotë:

“Kjo është rruga ime e drejtë! Kurse ti nuk ke asnjë lloj pushteti mbi robtë e mi përveç se mbi ata të humburit që të ndjekin ty!” (el-Hixhr: 41-42)

¹⁷ Në origjinal: ihsan.



“Sigurisht, ti nuk do të kesh asnjë ndikim mbi robtë e mi, sepse atyre u mjafton Zoti si mbrojtës!” (el-Isra: 65)

Në hadithin e shenjtë thuhet:

“Sinqeriteti është, ndër të fshehtat e mia, një e fshehtë e tillë që ia lë amanet vetëm zemrës së njeriut që dua! Atë (sinqeritetin) nuk mund ta dijë as ndonjë engjëll për ta shkruar (në librin e tij të punëve), as dhe ndonjë shejtan për ta mbrapshtuar!” (et-Taxh, I, 43)

Sinqeriteti është një dhunti tejet e lartë dhe e domosdoshme për të gjitha aktet. Për të treguar se shpëtimi pa të është i pamundur, hadithi profetik thotë kështu:

“Njerëzit shkatërrohen, por dijetarët shpëtojnë. Edhe dijetarët shkatërrohen, por dijetarët punëmirë shpëtojnë. Edhe dijetarët punëmirë shkatërrohen me përjashtim të atyre të sinqertë të cilët, me-gjithëkëtë, janë (në këtë botë, në çdo çast) ballëpërballë me një rrezik të madh.”

Kjo e vërtetë shprehet kështu në Kur’an:

الْأَعْبَادَ لِلَّهِ الْمُخْلِصِينَ

“(Nga ndëshkimi) do të përjashtohen vetëm robtë e vërtetë të Allahut...” (es-Saffat: 40)

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا عَلَيْكُمْ أَنْفُسَكُمْ لَا يَضُرُّكُمْ مَنْ ضَلَّ إِذَا
اهْتَدَيْتُمْ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ

“O ju që keni besuar! Ju shihni veten tuaj (bëhuni të sinqertë dhe ruajeni këtë si bashkësi)! (Po të bëni kështu), askush nga ata që janë shmangur nga rruga nuk mund t’ju sjellë dëm. Të gjithë keni për t’u kthyer te Allahu që do t’ju njoftojë për ç’keni bërë!” (el-Maide: 105)



Sinqeriteti është pastërtia e qëllimeve nga të cilat varet shëndeti dhe begatia e adhurimeve.

Poeti Mevlana u bën zë kështu atyre që kryejnë adhurime pa principialitet dhe sinqeritet:

“O ti, njeri i shkujdesur! Sikur ta ktheje fytyrën me sinqeritet ndaj Zotit kur bie në sexhde dhe ta dije se ç’do të thotë, “Zoti im i lartë është i pastër prej të gjitha attributeve relative”, pra, të mos bëje vetëm sexhde për formë, por edhe sexhde me zemër!”

Adhurimet pa principialitet dhe sinqeritet janë të mbushura me “zota” të tjerë, pra, të fëlliqura. Kështu, pra, enigma që i kullon dhe i bën sublime adhurimet, ekziston me principialitetin dhe sinqeritetin. E kundërta e kësaj shprehet kështu në Kur’an:

فَوَيْلٌ لِلْمُصَلِّينَ الَّذِينَ هُمْ عَنْ صَلَاتِهِمْ سَاهُونَ الَّذِينَ هُمْ يُرَاؤُونَ

“Sa keq për ata që nuk tregohen seriozë në namaz por vetëm veprojnë për dukje!” (el-Maun: 4-6)

Principialiteti dhe sinqeritet janë mbrojtja e zemrës nga përzierja në akte e synimeve të tjera veç pëlqimit të Zotit. Vetëm adhurimet e realizuara me principialitet dhe sinqeritet, pra, me zemër të pastër, quhen “akte të pastra e të mira”¹⁸. Zoti urdhëron:

“... Ju pini një qumësht të pastër që kalon përmes stomakut dhe gjakut të kafshëve..” (en-Nahl: 66)

Komentuesit e Kur’anit e kanë komentuar kështu këtë ajet metaforik:

¹⁸ Në original: salih amel.



“Principialiteti dhe sinqeriteti e kullojnë aktin (adhurimin) nga turbullitë ideore e ndjesore siç kullohet qumështi nga përbërja e stomakut dhe gjaku...”

Allahu i Lartë urdhëron:

أَفَرَأَيْتَ مَنْ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوَاهُ

“(O i Dërguar!) **A e pe atë që i bën për zot dëshirat e veta?..**” (el-Xhathije: 23)

Kjo do të thotë se besimi dhe akti që dëshiron Zoti janë ato të realizuara me zemër të sinqertë dhe vetëm për pëlqim të Tij.

Sa bukur e shpreh ky rrëfim pendimin e sinqertë të një zemre të pastruar:

Një nga sahabet, shokët e Profetit, në shkujdesje e sipër, kishte mëkatuar duke vjedhur dhe, pastaj, kishte ndërë pendim, kishte shkuar te Profeti të cilit i kishte pohuar mëkatën dhe kishte pritur t’i jepte dënimin ligjor. Sahabiu ishte dënuar me prerjen e dorës dhe ishte ekzekutuar. Duke parë dorën e prerë duke u rrokullisur përtokë, sahabiu i ishte drejtuar me këto fjalë:

“Moj dorë! Falenderuar qoftë ai që të shkëputi ty prej meje, ndryshe ti do të ma kishe djegur tërë trupin!..”

Kështu e shprehte ai qetësinë, prehjen dhe gëzimin që ia kishin mbështjellë zemrën!

I Dërguari i Allahut (s.a.s.) porositi:

“Bëje punën me sinqeritet, se edhe e pakta të mjafton!” (Ihja U lumiddin, IV, 676)



“Allahu nuk sheh pamjen dhe pasurinë tuaj, por zemrat dhe punët tuaja!” (Muslim, Birr, 34)

Në ajetin e mëposhtëm Zoti aludon se i çmuar te Ai nuk është ai që bën shumë apo pak adhurime, por ai që i bën ato në mënyrë sa më të sinqertë:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيُبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا

“... Ai që i krijoi vdekjen dhe jetën për t’ju provuar se cili prej jush është më i mirë (i sinqertë) në punë...” (el-Mulk: 2)

Zoti i provon njerëzit në mënyra të ndryshme për të përcaktuar mirësinë (principlialitetin dhe sinqeritetin) në aktet e tyre. Kështu, në Kur’an thuhet:

“Elif. Lam. Mim. A mos vallë njerëzit pandehin se do të lihen vetëm me thënien “besuam”, pa u vënë në provë? Ne i vumë në provë edhe paraardhësit e tyre. Sigurisht, Allahu i di se kush janë besnikët dhe kush janë gënjeshtarët!” (el-Ankebut: 1-3)

Ndërkaq, duhet të kuptohet mirë përmbajtja e principlialitetit dhe sinqeritetit. Nuk është aspak e drejtë ajo që bëjnë disa njerëz që i braktisin adhurimet me pretekstin se nuk mundën të kryejnë adhurime të sinqerta, pra, ka rrezik të bien në hipokrizi. Prandaj nuk duhen braktisur adhurimet, por duhen bërë përpjekje për t’i përsosur ato duke i kryer me zemër të pastër, sepse rruga e sinqeritetit është plot vështirësi. Ajo kërkon luftë kundër prirjeve egoistike. Sinqeriteti nuk është një rezultat që arrihet menjëherë dhe thjesht. Sinqeriteti i denjë është një kulm në lartësimin njerëzor. Dhe kulmi arrihet duke u ngjitur hap pas hapi. Në këtë rrugë duhet edhe



vullnet njerëzor, edhe lutje drejtuar bujarisë dhe favorit të Zotit.

Rruga më e mirë për të arritur një zemër të pastër duke e mbrojtur atë nga vanitetet për ta bërë krejtësisht të singertë varet nga pajisja me këto veti kryesore:

1. Me ndjenjën e mirësisë për të qenë së bashku me Allahun (xh.xh.) nëpërmjet zikrit, domethënë për ta ndjerë veten gjithmonë nën praninë dhe vëzhgimin hyjnor.

2. Me aftësinë për ta mbajtur gjithmonë të freskët afërsinë me njerëzit besnikë e të mirë, duke filluar me Profetin, me anë të lidhjeve shpirtërore me ta, për t'i mbajtur ata si model dhe, kështu, për të siguruar energjinë e duhur moralo-shpirtërore.

3. Me aftësinë për ta përsosur zemrën duke fituar cilësi të e mëshirës, sakrificës dhe dorëzimit të mundësive veti duke e përjetuar vëllazërinë e besimit me anë të bisedës.

4. Me aftësinë për t'i përfshirë tërë krijesat në kuadrin e mëshirës dhe dashurisë së zemrës nëpërmjet shërbimit.

5. Me aftësinë për ta ushqyer kurmin, këtë amanet hyjnor, me ushqim hallall, sepse, po të bëhet kujdes për ushqim hallall, zemrat mbushen me prirjen për bindje ndaj urdhrit të Allahut dhe kurmi na bëhet burim dobie e mbarësie.

Esenciale është që, me anë të zikrit, lidhjeve shpirtërore, bisedës, shërbimit dhe ushqimit hallall, njeriu të jetojë në një klimë konfidence me bukuritë e shfaqura në zemrën e cila është vepra më e madhe e mëshirës hyjnore dhe një vepër estetike krijimi.



Zoti ynë! Na bëj edhe ne të merituarit e të vërtetës së principialitetit dhe sinqeritetit që është një ndër të fshehtat e Tua! Na jep pjesë edhe neve nga klima e zemrës e të urtëve që të adhurojnë Ty mes falenderimit të këtij favorit!

Amin, ashtu qoftë!

W



FRIKA DHE SHPRESA¹⁹

Qeta e njeriut kalon përmes lëkundjeve mes frikës dhe shpresës. Për një besimtar është e domosdoshme që frika dhe shpresa të përjetohen në zemrën e tij në një ekuilibër dhe harmoni të dyanshme. Sepse nga frika e tepruar lind skeptizmi dhe pesimizmi, kurse nga mungesa e tepruar e frikës lindin ndjenjat e sigurisë dhe garancisë. Prandaj, duke u nisur nga kjo, është ndaluar rënia në siguri nga goditja e ndëshkimit hyjnor si dhe në pesimizmin e mungesës së mëshirës hyjnore. Besimtari i formuar mban në këtë drejtim një qëndrim të ekuilibruar. Në Kur'an thuhet:

تَتَجَافَى جُنُوبُهُمْ عَنِ الْمَضَاجِعِ يَدْعُونَ رَبَّهُمْ خَوْفًا وَطَمَعًا وَمِمَّا
رَزَقْنَاهُمْ يُنْفِقُونَ

“(Ata njerëz të bindur që) ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre duke patur frikë nga ndëshkimi i Tij dhe shpre-

¹⁹ Në original: havf, rexhá.



së për mëshirën e Tij dhe që, nga gjërat me të cilat i kemi furnizuar, dhurojnë në rrugë të dobishme!" (es-Sexhde: 16)

Pesimizmi absolut, domethënë prerja e shpresës, është indiferentizmi i njeriut ndaj realitetit, është këndvështrimi indiferent sipas të cilit ai e sheh veten jashtë faljes (amnisti-së) hyjnore, si rezultat, është mohimi i shfaqjeve mëshirore, i fuqisë dhe madhësisë së Zotit.

Kurse siguria absolute (ndaj mosgoditjes prej ndëshkimit hyjnor) si e kundërta e pesimizmit absolut, është mungesa e ndjeshmërisë ndaj atributit hyjnor "Kahhar" (persekutues, dëshpërues, shkatërrues) ose nënvleftësimi i ndëshkimit hyjnor.

Shkurt, është e domosdoshme që frika ndaj Allahut të mos sillet në kufirin e pesimizmit absolut dhe, në të njëjtën kohë, që shpresa të mos afrohet te siguria absolute, por të ruhet ekuilibri.

Nga mikrobota në makrobotë, tërë gjithësia është programuar brenda një rregullshmërie dhe ndjeshmërie hyjnore. Nga lëvizja e diellit gjer në lëvizjen e trupave të tjerë qiellorë, nga rrotullimi i grimcave brenda atomit gjer te rrezatimet e padukshme, që të gjitha zhvillohen brenda rrymave të një force të papërceptueshme e të papërfytyrueshme. Çdo gjë i nënshtrohet programit të vullnetit hyjnor. Edhe mosbesimtari mendon se nuk ka mundësi që dielli ta shtojë ose pakësojë shpejtësinë, që ditë-nata të bjerë ose të dalë mbi 24-orëshin. Në këtë mënyrë, në ndërgjegje ai e miraton fuqinë e vullnetit hyjnor, por, për shkak të egos, e mohon dhe ligjet themelore të gjithësisë i quan gabimisht si fuqi më vete duke i emërtuar



“ligje të natyrës”. Kurse këto ligje janë të vërtetat që quhen shkurt “zakone ose tradita hyjnore”²⁰.

Pa asnjë dyshim, kjo gjithësi është gjithësi shkaqesh. Allahu, Zoti i gjithësisë që është shkaku i shkaqeve, e ka bërë çdo gjë të varur nga një shkak me qëllim që ajo të marrë ekzistencën e duhur dhe të kryejë siç duhet detyrën e saj. Kështu, po qe se vullneti hyjnor do të ishte shfaqur pa shkak, as shfaqja e tij do të mund të përballohej, as kjo botë do të mbetej një botë prove. Prandaj, zotëruesit e kulturës shpirtërore nuk lidhen pas shkaqeve, por pas shkakut dhe shtyesit të shkaqeve. Kurse ata që nuk mundin të bëjnë vëzhgime hyjnore, përsillen pa orientim mes shkaqeve duke u kapur vetëm pas shkaqeve fizike.

Për t’i ndëshkuar mohuesit dhe mizorët, Zoti i vë në veprim disa dukuri natyrore jashtë programit hyjnor me të cilin jemi mësuar, domethënë, në funksion të ndëshkimeve materiale-shpirtërore. Kështu, vetia konstruktive e vëzhguar rregullisht të zjarri, uji, era dhe elementë të tjerë natyrorë, shtyhet në plan të dytë duke i shndërruar ata në fuqi shkatërruese. Për rrjedhojë, të mos e shohësh dëshirën dhe vullnetin hyjnor ose, shpesh, lejen hyjnore në themel të dukurive që zhvillohen në natyrë, do të thotë të mbetesh i mbërthyer te një perspektivë shterpë dhe, disa herë, të verbër. Ata që bien në një indiferentizëm dhe gabim të tillë, poeti Mevlana i paralajmëron kështu:

“Mos harro se, përballë fuqisë hyjnore, kjo botë i përngjet krejt një mullari kashte! Vullneti hyjnor atë disa herë e ngre, disa herë e sheshon; disa herë e bën të rregullt, disa herë, të derdhur e të shpërn-

²⁰ Në origjinal: adetullah, sunnetullah.



darë. Disa herë e vërtit djathtas e, disa herë majtas, disa herë e bën si një trëndafilishte, kurse disa herë, si një gjembishte...”

Zoti ka dashur që kjo botë të jetë një botë prove, prandaj ka bërë të shfaqen në të dy cilësi të kundërta, por të ndërthurura me njëra-tjetrën, favorin dhe persekutimin²¹.

Ndërsa nuk është një e drejtë e njeriut, favori (lutf) realizohet shpesh në saje të preteksteve të tilla si lutjet dhe lëmoshat e sinqerta si dhe lloje të ndryshme punësh të mira.

Kurse persekutimi (kahr) realizohet para së gjithash për shkak të haramit (akteve fetarisht të ndaluara), padrejtësisë, dhunës dhe perversiteteve e teprimeve masive. Krahas kësaj, persekutimi shfaqet disa herë për të vënë në provë durimin, dorëzimin dhe nënshtrimin e njeriut dhe, për rrjedhojë, për ta lartësuar atë. Kështu, herë pas here, Zoti i vë në provë robtë e vet në mënyra të ndryshme. Kjo shprehet kështu në Kur'an:

“Pa dyshim, Ne vëmë në provë me pak frikë dhe uri si dhe me pakësim në jetët, mallrat, pasurinë dhe prodhimet... (O i Dërguar!) Përgëzoji ata që durojnë!..” (el-Bakara: 155)

Mbi këtë urtësi mbështetet edhe fakti që edhe profetët, madje, me gjithë pafajësinë (inocencën) e tyre, kanë kaluar nëpër një qerthull vuajtjesh e mundimesh.

Në përgjithësi, çdo gjë që ndodh në gjithësi ndodh brenda dijes së Zotit. As edhe një gjethe nuk bie pa dijeninë e Tij. Në Kur'an thuhet:

وَمَا تَسْقُطُ مِنْ وَرَقَةٍ إِلَّا يَعْلَمُهَا وَلَا حَبَّةٍ فِي ظِلْمَاتِ الْأَرْضِ
وَلَا رَطْبٍ وَلَا يَابِسٍ إِلَّا فِي كِتَابٍ مُبِينٍ

²¹ Në original, respektivisht: lutf, kahr.



“... as dhe një gjethe nuk bie jashtë dijes së Tij. Ai ka dijeni edhe për një grimcë në thellësitë e errta të nëntokës. Çdo gjë e njomë dhe e thatë ndodhet në librin e qartë!”

(el-En’am: 59)

Prandaj gjithmonë duhet mbështetur te Zoti dhe duhet kërkuar falje prej Tij duke bërë penësë. Në Kur’an thuhet:

وَمَا كَانَ اللَّهُ مُعَذِّبَهُمْ وَهُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“... dhe, nëse kërkojnë falje, Allahu nuk ka për t’i ndëshkuar!” (el-Enfal: 33)

Poeti Mevlana shprehet kështu:

“Të qash e të rënkosh është një pasuri e madhe e shëndoshë dhe e palëkundur, kurse mëshira e Allahut është një mbështetje shumë e fuqishme. O ti i shkujdesur që vetëm qesh, shijojë kënaqësinë e të qeshurit, por shijojë edhe kënaqësinë e të qarit që është si një mini-erë sheqeri. Ç’sy i bekuar është syri që qan për Allahun! Ç’zemër e bekuar është zemra që qan për Allahun! Për qarjen dhe rënkimin ka patjetër mëshirë!”

Kurse poeti Saadi shprehet kështu:

“Po s’qau reja, si do të qeshin barërat, po s’qau fëmija, si do t’i japë nëna sisë?”

Zoti ynë! Mbroje bashkësinë e Muhammedit nga ndëshkimi yt dhe nga çdo e keqe dhe fatkeqësi! Na bëj ne që, si në kohë të qeta, ashtu dhe të vështira, të kemi frikë dhe shpresë dhe, në kohë të vështira, të durojmë duke mos e humbur shpresën tek Ti!

Amin, ashtu qoftë!



INDIFERENTIZMI²²

Një udhëtar po udhëtonte i vetëm nëpër shkretëtirë. E kish vënë kokën para i zhytur në mendime duke e humbur krejt kujdesin për të papriturat dhe rreziqet e panumërta të udhëtimit në shkretëtirë. Ndërkaq, papritmas i doli para një egërsirë, udhëtari u shkund nga indiferentizmi dhe nisi të vraponte me sa kish mundësi për të shpëtuar kokën, megjithëse e kishte të qartë se me të ikur s'do të mund të shpëtonte. Prandaj, sapo pa një pus, u hodh në të pa u menduar. Duke rënë poshtë, pa një degë peme të rritur në murin e pusit dhe u kap në të!

Por ç'e do, degën ku u mbajt udhëtari po e brenin dy minj, njëri i zi e, tjetri, i bardhë! Udhëtari hodhi vështrimin në fundin e pusit: një kuçedër po e priste me gojë hapur të binte sapo të këputej dega, ndërsa katër gjarpërinj kishin nxjerrë kokat nga foletë dhe po i kërcënoheshin...

Udhëtari i shkretë u tmerrua! E kapi një frikë e thellë! Gjendja ku kishte rënë s'lejonte as nënvleftësimin më të

²² Në original: gaflet, indiferentizëm, moskokëçarje, padije, mosinteresim, etj.



vogël, as dhe humbjen më të vogël të kohës! Duhet të dilte nga pusi një çast e më parë, domethënë para se minjtë ta brenin plotësisht degën...

Ndërsa po mendonte seriozitetin dhe rrezikshmërinë e gjendjes ku ndodhej dhe po kërkonte ndonjë vend për t'u kapur në muret e pusit e për të dalë jashtë, udhëtari i zuri syri aty pranë hoje blete plot mjaltë! Ai mendoi me vete:

“Mjaltë në këtë vend të çuditshëm! Kushtet nuk i kam aspak të përshtatshme, por, megjithëkëtë, po e provoj një herë mjaltin pastaj dal jashtë!”

Udhëtari zgjati dorën, mori një copë hoje dhe e hëngri. Aq shumë i shijoi mjalti, sa, duke e harruar në ç'gjendje ndodhej, tha me vete:

“E ku e gjej unë prapë një mjaltë të tillë! Po ha sa e kam në dorë!”

Kështu, duke e përqëndruar mendjen, syrin dhe zemrën te mjalti, udhëtari i mjerë harroi se ku ndodhej dhe se i duhej të kërkonte mundësi për të dalë që atje, krejt si struci që e fut kokën në rërë për t'u mbrojtur duke harruar se ka lënë jashtë gjithë trupin!

Ndërsa udhëtari hante mjaltë, minjtë e brenë degën, dega u këput, udhëtari ra në gojën e kuçedrës dhe mori fund...



Ky është një rrëfim simbolik dhe alegorik. Pusi dhe rreziqet në të simbolizojnë jetën e kësaj bote, kuçedra dhe gjarpërinjtë simbolizojnë cilësitë e këqia, mjalti simbolizon kënaqësitë e përkohshme dhe mashtruese të kësaj bote, dega simbolizon jetëgjatësinë e njeriut, miu i zi dhe miu i bard-



hë simbolizojnë netët dhe ditët, domethënë kohën që e bren jetëgjatësinë dhe udhëtari simbolizon njeriun që vjen e shkon si udhëtar në këtë botë prove, i cili, po të bjerë në indiferentizëm, përfundon me disfatë e shkatërrim!

Në këto kushte, çështja më e rëndësishme për njeriun është të dijë të mbrohet nga çdo lloj indiferentizmi që do ta bënte një ditë të qante me klithma pendese dhe të bëjë të gjitha përpjekjet për të arritur shpëtimin e lartë, qetësinë dhe gëzimin e përjetshëm. Fundja, a nuk e kërkon këtë qëllimi final i njeriut dhe gjendja ku ndodhet?

Dihet se lumturia e çdo njeriu vërtetohet me anë të jetesës në përshtatje me qëllimin final të krijimit të vet. Si qenia më e lartë e gjithësisë, njeriu duhet ta dijë pse është krijuar, t'i rregullojë sjelljet dhe veprimet e veta sipas kësaj dhe të qëndrojë syçelë ndaj rreziqeve të kësaj bote dhe dashurive e kënaqësi-ve të përkohshme të saj.

Ndryshe, po qe se njeriu i krijuar me cilësi që e bëjnë qenien më të përsosur e të nderuar, bën një jetë larg Zotit, i pavetëdijshëm dhe i paditur për esencën e vet, bie në indiferentizmin e përshkruar në rrëfimin e mësipërm, gjë që ka për rezultat një jetë të hequr zvarrë dhe një mjerim mjaft të hidhur.



Nuk mund të mendohet një mendimtar dhe intelektual i vërtetë i cili nuk do që ta kuptojë enigmën dhe urtësinë e kësaj vajtje-ardhjeje të njerëzimit, individët e të cilit vijnë këtu një nga një nga një botë e panjohur dhe, pasi jetojnë për një farë kohe në kushte prove, dalin përsëri një nga një nga kufiri i kësaj bote për të emigruar në botën shpirtërore.



Zotërimi i të vërtetës së njerëzimit, rrokja e kuptimit të jetës dhe vdekjes janë rezultat i shpëtimit nga indiferentizmi për të cilin po flasim, gjë që është punë e një gjykimi të qartë që shkëlqen me një dritë hyjnore, e një zemre të zhvilluar dhe e një ndërgjegjeje të paintriguar.

Prirjet natyrore si injoranca, epshi, mendjemadhësia, krenaria, ambicja, koprracia, smira, shpërdorimi dhe zemërimi janë shfaqje shkatërruese të indiferentizmit. Të mbytesh në këto vorbulla për ta braktisur nderin si njeri, është vetëmashtrim dhe disfatë. Është për shkak të këtij vetëmashtrimi që mëkatet që realizohen si rezultat i prirjeve në mënyrë indiferente dhe pasionante, bëhen pengesë për dallimin e të Vërtetës, nderi dhe dinjiteti njerëzor bien poshtë, shpirtrat mbulohen me errësirë, Krijuesi harrohet.

Për ata që bien në një gjendje të tillë, Kur'ani thotë:

فَوَيْلٌ لِلْقَاسِيَةِ قُلُوبُهُمْ مِنْ ذِكْرِ اللَّهِ أُولَئِكَ فِي ضَلَالٍ مُبِينٍ

“... Sa keq për ata që u janë ngurtësuar zemrat për ta përmendur Allahun!..” (ez-Zumer: 22)

Me të vërtetë, me pakësimin e mbështetjes morale në ndërgjegjet, mendimi i hollë dhe thellësia shpirtërore humbasin, shfaqet një dobësi serioze në aftësinë për t'u orientuar, mëkatet u duken egove të këndshme si një fllad i ëmbël, njeriu bëhet i verbër ndaj turpeve të veta. Ashtu siç ndodh që një njeri me gishtat tërë plagë e qelb ha bukë pa ndjerë neveri dhe, përgjithësisht, pa i shkuar mendja se të tjerët që e shohin mund të ndjejnë neveri, ashtu edhe indiferentët që jetojnë nën pushtetin e egos, nuk shqetësohen nga gabimet e veta. Ata gjithashtu nuk janë të vetëdijshëm për dëmin që pësojnë vetë ose u shkaktojnë atyre që kanë përreth. Sepse ata që izo-



lohen nga indiferentizmi sikur të futeshin brenda një blindi, bëhen shurdhë dhe të verbër ndaj të Vërtetës. Zoti thotë për ta në Kur'an:

“Ata, shurdhët, memecët dhe qorrat...” (el-Bakara: 18)

Poeti Mevlana i përshkruan në mënyrë humoristike gafat e vizitorit dhe të të sëmurit, që të dy indiferentë, larg pëlqimit të Zotit, të dhënë pas interesave materiale.

Një njeri i arsyeshëm dhe i respektueshëm i thotë një mikut të tij indiferent dhe të rëndë nga veshët:

“Komshiun e ke të sëmurë, a s’di gjë ti?”

Shurdhi nisi të bëjë llogari me vete:

“Ta zëmë se i shkova komshiut të sëmurë për vizitë. Po si do ta kuptoj unë me këta veshë të rëndë se ç’thotë ai i sëmuri i ri?”

Dhe shtoi:

“Veç kësaj, kur sëmuret njeriu, zëri i del i prerë, i dobët dhe i ngadaltë. Unë s’do ta marr dot vesh ç’do të më thotë!”

Por, pasi u mendua edhe pak, vendosi të shkojë:

“Megjithatë, e kam komshi, s’kam ç’bëj, më duhet t’i shkoj. Ndryshe, të gjithë do të më shajnë e do ta humbin respektin për mua!”

Pastaj bëri një plan të tillë:

“Kur t’i shkoj për vizitë, me ta parë se po lëviz buzët, do të përpiqem ta marr vesh se ç’thotë dhe do t’i përgjigjem pa i lënë ta kuptojë se s’e kam dëgjuar. Fundja, edhe dhimbjet



s'kanë për ta lënë t'i dëgjojë mirë fjalët e mia! Së pari po e pyes:

“Si je, o komshiu im i shkretë?”

Sigurisht, ai do të më përgjigjet kështu:

“Mirë, pak më mirë jam tani!”

Atëherë, edhe unë do ta uroj:

“Lavdi Zotit!..”

Pastaj do ta pyes:

“Ke ngrënë ndonjë gjë?”

Dhe ai do të më thotë:

“Kam pirë një sherbet” ose “Kam ngrënë një supë”!

Unë prapë do ta uroj:

“Të bëftë mirë, t'u bëftë shëndet!”

Pastaj do ta pyes për mjekun:

“Cili mjek të vjen, kush të sheh?”

Ai do të më përgjigjet:

“Më sheh filan mjek!”

Për t'ia shtuar besimin te mjeku dhe për t'ia forcuar shpresën për shërim, unë do t'i them:

“Shumë mjek i mirë! Shumë mirë që e keni thirrur atë!
Ai ka këmbë të mbarë! Ku të vërë dorë ai, punët vihen për vije!”

Pasi i rregulloi me mend të gjitha, njeriu i rëndë nga ve-s-hët u nis për tek komshiu i sëmurë.



Siç e kishte menduar me vete, filloi duke e pyetur për shëndetin:

“Si je, o komshiu im i shkretë?”

I sëmuri që përpëlitej nga dhimbjet, iu përgjigj:

“Jam shumë keq, më duket sikur më ka ardhur fundi!..”

Vizitori që s’ia dëgjoji dot fjalët, i dha përgjigjen që e kishte menduar vetë më parë:

“Lavdi Zotit!..”

I sëmuri u prek thellë! Ai s’e kuptoi dot se pse po gëzohej nga kjo komshiu që i kishte ardhur për vizitë! Ai mendoi me vete: “Domethënë, komshiu do që unë të vdes!”

Vizitori i bëri të sëmurit pyetjen e dytë:

“A ke futur gjë në gojë, o komshi, ç’ke ngrënë?”

I mërzhitur nga fjalët e para që ia kishin rënduar akoma më shumë gjendjen, i sëmuri iu përgjigj me zemërim:

“Helm!..”

Vizitori iu përgjigj:

“Të bëftë mirë, gjak e dhjamë!..”

I sëmuri u nxeh keq sepse edhe nuk qe nga ata njerëz që mund ta kuptonin se këtu kishte një keqkuptim! Megjithatë, heshti. Kurse vizitori vazhdoi:

“Cili mjek të ka parë, kush po të vjen?”

I sëmuri, zemërimi i të cilit kishte arritur kulmin, iu përgjigj:



“Kush të më vijë? Azraili! Eja, këput qafën që këtu e mos më zemëro më keq!”

Vizitori shurdh jo vetëm që s’i dëgjonte fjalët e të sëmurit, por as përpiquej të kuptonte gjë nga gjetet e tij, por vetëm radhiste pyetjet që kishte menduar. Ai vazhdoi:

“Aa, ai ka këmbë të mbarë! Sa mirë, s’po thua? Duhet të gëzohesh shumë!”

Dhe u ngrit për të shkuar.

Duke dalë nga shtëpia e të sëmurit, vizitori shurdh po mendonte:

“Sa mirë bëra që erdha! Edhe nderin e shpëtova, edhe të sëmurin e gëzova!”

Në të vërtetë, vizitori kishte dalë me humbje nga kjo vizitë. Ai e kishte zemëruar shumë komshiun e vet të sëmurë që po mendonte shumë keq tani për të dhe po e mallkonte!



Poeti Mevlana thotë:

“Duke dashur t’ia fitonte zemrën të sëmurit, shurdhi ia theu zemrën. Me parashikimet dhe bisedën e sajuar sipas mendimit të vet, e zemëroi shumë të sëmurin. Meqë shkoi për vizitë jo me sinqeritet, por vetëm sa për t’u dukur, nuk fitoi gjë, u turpërua dhe humbi fqinjësinë dhe miqësinë shumëvjeçare!”

Nga ana tjetër, edhe i sëmuri, nuk duroi dot dhe u mposht nga zemërimi. Në vend që, duke menduar mirë për fqinjin, të përpiquej ta kuptonte ngatërresën, mendoi keq për të dhe ra në gabime të rënda!”



Ajo që na takon neve në këtë botë të përkohshme, është që, brenda mundësive njerëzore, të mos qëndrojmë indiferentë ndaj Krijuesit dhe shkaqeve të krijimit, përkundrazi, të li-dhemi me gjithë zemër pas Kur'anit dhe Traditës Profetike dhe të jemi në gjendje për të bërë gjithmonë gjykim dhe vetëllogari të drejtë!

Njeriu që është dhunti e botës, duhet të jetojë pranë Krijuesit. Ne e kemi të domosdoshme ta adhurojmë Zotin që na ka dhënë vlera jetësore, që na i fal mëkatet, që na i njeh zemrat dhe të fshehtat. Faljet dhe ritet kanë kohë të caktuara, kurse besimi dhe adhurimi i Zotit përfshin gjithë jetën.

Zoti na bashkoftë me njerëzit e mençur e të zgjuar që ecin në rrugën e drejtë! Zoti na bëftë pjesëtarë të bashkësisë së të Dërguarit të Tij!

Amin, ashtu qoftë!

W



Njeriu është krijuar me natyrë dhe mundësi të prirur edhe për të mirën, edhe për keqen. Kjo cilësi e realizuar sipas caktimit dhe vendimit hyjnor dhe që ka të bëjë me faktin që kjo botë është një botë prove, është shkaku i lëkundjes së përvetshme të njeriut mes të mirës dhe të keqes, të bukurës dhe të shëmtuarës. Ndërkaq, ata që munden ta arrijnë pikën e përsosmërisë në të mirë dhe bukuri, janë, sikurse majat e maleve, të numërueshëm, të rrallë. Për këtë arsye, gjeniu Saadi, duke bërë një vlerësim të përgjithshëm për njeriun, pyetjes se *ç'është njeriu* i është përgjigjur kështu:

“Ca pika gjak dhe një mijë e një dyshime!..”

Një grumbull dyshimesh... Ndërkaq, shumë të paktët fatmirë që munden të shpëtojnë nga shqetësimi i shkaktuar prej

²³ Në origjinal: hirs, ambicje; hased, zili e keqe, smirë; kanaat, ngopje, kënaqje me atë që ke, me atë që të ka dhënë Zoti ose që të ka rënë në pjesë, duke mbajtur parasysh se përpjesëtimi hyjnor i dhuntive dhe cilësive mbështetet mbi pabarazinë me qëllim që të mbahet në këmbë shoqëria njerëzore ku secili të ketë nevojë për shërbimet e të tjerëve, pra, ku secili individ ka vlera që s'i ka një tjetër.



prirjeve negative si dëshirat dhe pasionet e pafrenuara dhe zilitë dhe smirat e skajshme, përbëjnë, brenda këtij cilësimi të përgjithshëm, një përjashtim.

Zoti ka dëshiruar që njerëzit të përbëjnë një shoqëri dhe, për ta siguruar këtë, i ka përpjestuar të mirat nga individi në individ në mënyrë të pabarabartë. Kështu, Ai i ka bërë individët nevojtarë ndaj njëri-tjetrit. Kjo pabarazi ose ky dallim në shpërndarjen e dhuntive mes individëve që vihet re në të gji-tha periudhat e historisë së njerëzimit dhe që është i domosdoshëm për vënien e njeriut në provë, është një parim themelor i mbështetur në caktimin hyjnor, për pasojë, i pashmang-shëm. Nevoja për solidaritetin shoqëror është një shfaqje e këtij dallimi ose e kësaj pabarazie. Ndërkaq, ky dallim ose kjo pabarazi lind tek disa njerëz një sërë negativitetesh të padë-shirueshme, në krye të të cilave vijjnë **ambicja, urrejtja, smira**, etj.

Po qe se ambicja nuk frenohet, përfundon në sëmundjen e quajtur smirë. Ata që e lëshojnë veten në vorbullën e ambicjes dhe zilisë, herët a vonë e humbin qetësinë. Këto prirje negative që e dëmtojnë esencën e pastër të njeriut, janë, në të njëjtën kohë, edhe një mospajtim me programin hyjnor të caktimit dhe përpjesëtimit të dhuntive, gjë që përbën faj. Ndërkaq, ata që kapen nga kjo sëmundje egoistike, e humbin aftësinë për ta dalluar këtë të keqe në veten e tyre.

Pasionet dhe zilitë që e mbysin njeriun në vorbullën e qëllimit të gjatë e të pafund, e bëjnë atë ta harrojë botën tjetër për t'u dhënë me dashuri pasionante pas kësaj bote. E thënë ndryshe, e bëjnë njeriun të mundet prej dëshirave të egos dhe të bëhet skllav i gjërave materiale. Sytë e ambiciozitetit nuk ngopen kurrë, prandaj ai jeton vazhdimisht me ndjen-



jën e varfërisë. Ai ndjen vazhdimisht uri shpirtërore. Ndërsa çdo plotësim dëshire duhej t'i jepte ngopje, i zgjon një oreks dhe ambicje të re. Shfaqjet e zilisë dhe smirës te egoja janë të ndryshme. Smira i paralizon prirjet e pastra me të cilat është i pajisur krijimi i njeriut, ia dobëson logjikën, i dënon me mundje shfaqjet e natyrshme të besimit dhe dorëzimit. Prandaj, Profeti (s.a.s.) ka thënë kështu për smirën:

“Ajo është gërryesja e besimit...” (I. Xhanan, Kutubi Sitte, V, 278)

Ziliqari dhe smirëziu kërkon t'i merret gjëja që ka njeriu që ka zili dhe smirë, e t'i jepet atij vetë. Kur kjo është e pamundur, thotë: *“As mua, as atij!”* Atij nuk i vjen mirë aspak që tjetri ka dhe dëshiron shkatërrimin e tij. **Ziliqari ushqen kundër njeriut që ka zili, urrejtje dhe hakmarrje si dhe dëshirë për ta përfolur dhe poshtëruar atë.** Shkurt, e kalon jetën e vet të shkurtër mes dyshimesh e mendimesh të këqia.

Mendimet e shqetësuara që e bëjnë njeriun ta ketë syrin te gjëja që ka tjetri, janë një lloj mospëlqimi ndaj përpjesëtimit hyjnor dhe mospajtimit ndaj caktimit hyjnor. Njeriu s'e di se ndoshta ajo çka i ka rënë në pjesë është më e dobishme për të!

Marufi Kerhi thotë:

“Njeriu i pjekur i sheh të pasurit jo me zili, por me dëshirë për të marrë mësim prej tyre, i sheh të varfërit jo me mendjemadhësi, por me thjeshtësi, i sheh femrat jo me epsh, por me dhembshuri!”



Kur shpirti bëhet delikat, të gjitha zilitë dhe smirat materiale zhduken. Kështu, për besimtarët, sipas nivelit të tyre ndjesor, ndryshojnë edhe masat e vlerësimit të të mirave dhe realizohet konsiderata e sheriatit (ligjit), sipas së cilës, *mall yt është yti, malli im është imi*; konsiderata e mistikës, sipas së cilës, *malli yt është yti, edhe malli im është yti*; konsiderata e të vërtetës absolute, sipas së cilës, *as malli yt s'është yti, as mall im s'është imi, të gjitha janë të Allahut*".

Sa bukur e shpreh poeti Junus Emre faktin që zilia dhe ambicja janë vetëmashtrim, kurse rezultati i tyre, iluzion optik në shkretëtirë:

....

*Ti beson në këtë botë,
Ke mall, thua, ke pasuri;
Pse gënjen kot më kot?
S'është aspak si thua ti!*

....

*Kam mall, kam pasuri,
Po pronari i tyre i parë?
Rrenë mall, rrenë pasuri,
Gënjehu dhe ti si të tjerë...*

Sipas kësaj, qysh në krye të herës, pasuria vazhdon të qarkullojë dorë më dorë.

Duke kaluar së bashku me të tjerë pranë një varreze, Shakkik Belhi u tha shoqëruesve:

"Shumica e këtyre kanë qenë gënjeshtarë!.."



Të habitur, shoqëruesit e pyetën:

“Për ç’shkak?”

Shakik Belhiu u përgjigj:

“Kur ishin gjallë, a nuk thoshin ata, *kam mall, kam pasuri, kam shtëpi, kam kalë shale, kam farefis, kam kopshte...*”? Mirëpo edhe ju e shihni tani se s’paska qenë ashtu!”

Meqë besimi dhe nënshtrimi i ambiciozit janë vazhdimisht të dobët për shkak të zilisë, jeta shpirtërore e tij kthehet në burg.

Duke bërë çudi me gjendjen e ambiciozit, poeti Mevlana shprehet kështu:

“Ç’është kështu me njeriun që bëhet skllav i floririt dhe i pasurisë së kësaj bote? Ç’janë ato që nuk shpenzohen në rrugën e Zotit? Ç’shprehin ato? A nuk është zovarrisja skllavërore pas pasurisë shkakut që e dërgon njeriun në qiej me duar bosh?”

Me të vërtetë, shembulli i Salebes²⁴ që u bë skllav i pasurisë dhe u mbyt në vorbullat e varfërisë shpirtërore, është shumë domethënëse.

Salebe që ishte nga muslimanët medinas, kishte ambicje të madhe për mall e pasuri. Ai donte të bëhej i pasur. Për këtë, ai i kërkoi Profetit të lutej për të. Profeti iu përgjigj:

“Pasuria e pakët që i dihet vlera (për të cilën falenderohet Zoti), është më e dobishme se pasuria e shumtë që s’i dihet vlera!”

24 Kanë qenë 29 sahabe, bashkëkohës të Profetit, me emrin Salebe, por personi për të cilin bëhet fjalë këtu, nuk është Salebeja që njihet për devocion dhe që pati marrë pjesë në luftën e Bedrit.



Salebe hoqi dorë një herë për një herë nga ambicja e tij, por sërish shkoi te Profeti dhe i kërkoi të lutej për të që të bëhej i pasur:

“O i Dërguari i Allahut, lutu për mua që të bëhem i pasur!”

Kësaj radhe Profeti i tha kështu:

“A s’jam unë për ty një shembull i mjaftueshëm? Beto hem në Allahun se, po të desha, do të më derdhej nga pas ar e argjend sa këto male! Por unë kam mbetur i ngopur e i kënaqur me kaq!”

Salebe hoqi dorë përsëri nga dëshira për t’u bërë i pasur, por ambicja s’e la të qetë. Ai nisi përsëri ta dëshirojë pasurinë duke u vetëjustifikuar se, po të bëhej i pasur, do t’i ndihmonte të varfërit dhe do të fitonte më shumë të mira. Me këto mendime, Salebe shkoi për herë të tretë te Profeti dhe i tha:

“Beto hem në Atë që të ka dërguar ty si profet të vërtetë se, po të më bëjë të pasur, do t’i ndihmoj dhe mbroj të varfërit dhe se do t’i jap gjithkujt të drejtën që i takon!”

Më në fund, pas gjithë kësaj këmbënguljeje, Profeti u lut:

“O Zot!, jepi Salebes pasurinë që dëshiron!..”

Pa shkuar shumë kohë, Zoti i dha Salebes pasuri të mëdha. Tufat e tij të bagëtive mbushën fushat e malet. Mirëpo, duke u marrë me pasurinë e shumtë, Salebe që njihej gjer aty si njeri që shkonte rregullisht në faltore, nisi të mungonte gjithmonë e më shumë gjersa filloi të shkonte



vetëm në namazet e xhumasë. Kurse më vonë i harroi edhe ato!

Një ditë, pasi pyeti dhe mësoi se ç'kishte ndodhur me Saleben, Profeti tha:

“Sa keq për Saleben!..”

Por indiferentizmi dhe injoranca e Salebes nuk mbetën me kaq. Ai që premtonte dikur se do t'i ndihmonte dhe mbronte të varfërit, arriti puna që t'i përzente nëpunësit e mbledhjes së zeqatit duke kundërshtuar të jepte më të paktën e të drejtës së të varfërve të përcaktuar në Kur'an. Salebe u bë hipokrit dhe hezitant.

Në Kur'an thuhet kështu:

“Dhe dikush prej tyre i dha fjalën Allahut se, po t'i jepte Allahu nga mirësia dhe bujaria e Tij, do të jepte sado ka dhe do të bëhej nga të mirët.

Por, kur Allahu i dha nga favori i Tij, ai e ktheu fjalën!”

(et-Tevbe: 75-76)

Për jetën materiale me të cilën nuk ngopet ambiciozi, në ajetin e 46 të sures Naziat thuhet:

“Dhe kur ta shohin ditën e kiametit, do të pandehin se kanë ndenjor në këtë botë vetëm një mbrëmje ose sa një paradite!”

Shkatërrimi që i sjell ambicja shpirtit të njeriut të kujton përshkrimet që i bën Zoti në Kur'an xhehennemit:



“Atë ditë do t’i themi xhehennemit: “A u mbushe?” Kurse ai do të përgjigjet: “A ka dhe më?” (Kaf: 30)

Në një ajet, Zoti thotë kështu për ambiciozët:

“Lërimi ata! Të hanë, të dëfrenë dhe qëllimet boshe t’i mashtrojnë, se shpejt do ta kuptojnë...” (el-Hixhr: 3)

Historia e zilisë dhe smirës është e vjetër sa njeriu. Zilia e parë fillon me kundërvënien e Iblisit, djallit, ndaj Hz. Ademit të krijuar prej dheu.

Megjithëse ishte mësues i engjëjve, Iblisi e kishte prejardhjen nga xhindët, pra, sikurse ata dhe njerëzit, zotëronte ego. Duke mos e njohur urtësinë hyjnore, ai bëri një krahasim mes vetes të krijuar prej flake pa tym dhe Ademit të krijuar prej dheu, për pasojë, e pati smirë Ademin i cili, megjithëse, sipas tij, me krijim më të ulët, qe nderuar me sexhden e en-gjëjve.

Edhe të vëllezërit e profetit Jusuf që e patën smirë atë, nuk e ruajtën dot veten dhe e hodhën në pus të vëllanë duke kryer një mëkat të rëndë.

Në hadithin profetik porositet:

“Kurrë mos kini smirë, sepse smira i ha dhe i asgjëson të mirat si zjarri drurin!” (Ebu Davud, Edeb, 44; Ibni Maxhe, Zuhd, 22)

A nuk ishte zilia dhe smira shkak i fundosjes nën tokë të Karunit së bashku me thesaret e tij që s’i barteshin dot as çelësat?

Allahu i Lartë e përshkruan kështu fundin e Karunit:



“Më në fund, Ne i fundosëm në tokë edhe atë, edhe pallatin e tij. Tani ai as ka kënd për ta ndihmuar, as dhe vetë është i aftë për ta shpëtuar veten!” (el-Kasas: 81)

Megjithëse zilia është e ndaluar, në rastet kur ajo është një ndjenjë pozitive që e shtyn njeriun të pajiset me cilësi të mira pa ia dëshiruar të keqen tjetrit, lejohet. Në hadithin profetik porositet:

“Vetëm dy veta kihen zili. Njëri, i pasuri që nga pasuria që i ka falur Allahu, shpenzon në rrugë të Allahut dhe tjetri, i dituri që diturinë që ia ka dhënë Allahu, ua mëson edhe të tjerëve!” (Buhari, Ilm, 15; Muslim, Musafirin, 268)

Kihen zili vetëm një i pasur që dhuron në këtë mënyrë dhe një i ditur që e bën të dobishme për njerëzit diturinë e tij. Kjo lloj zilie është trajta pozitive, e lartë e zilisë së kthyer në virtyt. Kihen zili profetët dhe personalitetet e lartë dhe në këtë rast kemi të bëjmë me një emocion moralo-shpirtëror të lartë. Zilia e shpirtrave të pastër për të pasur virtyte të larta dhe për ta fituar botën tjetër është domosdoshmëri e fisnikërisë së tyre.

Ndërkaq, mjekimi i vetëm i ambicjes, zilisë dhe smirës që janë nga cilësitë më të rrezikshme të moralit të ulët, është i mundur me anë të veshjes me frymën e qetë të ngopjes dhe kënaqjes, sepse thesaret hyjnore që i përfton zemrës ngopja dhe kënaqja me atë që të ka dhënë Zoti, pra, që ke në dorë, as pakësohen, as mbarojnë. Kështu, Profeti (s.a.s.) ka thënë:

القَنَاعَةُ كَنْزٌ لَا يَفْنَى



“Ngopja dhe kënaqja është një thesar i pafund...” (Dejlemi, Musned, 4699)

Prandaj, kriteri i vërtetë i të qenit i pasur është ngopja dhe kënaqja, është pajtimi me përpjesëtimin hyjnor, është të mos i shohësh me zili ata që kanë më shumë se ti. Shija e vërtetë e pasurisë mund të shijohet vetëm me ngopje dhe kënaqje.

Poeti Mevlana thotë:

“Vdisni që të ringjalleni, që të meritoni bukurinë dhe pasurinë e vërtetë!”

Ndërkaq, duhet ditur se bukuritë kërkojnë sy që t'i shikojnë, zemra që t'i dashurojnë. Ashtu siç nuk u tregohen bukuri syve të verbër, ashtu siç nuk iu ekzekutohen melodi ve-shëve të shurdhër, ashtu dhe s'pritet që të pangopurit që s'dinë se ç'është preha dhe lumturia e ngopjes dhe kënaqjes, të ngopen e të kënaqen.

Njeriu i përkryer nuk heq keq për nevojat e përditshme. Ai nuk vrapon pas ushqimit, por pas Ushqyesit. Ai nuk e ka syrin te mundësitë dhe kamja e të tjerëve. Ai është gjithmonë i pajtuar e i kënaqur.

Kurse fundi i atyre, gjëllimi i të cilëve përbëhet vetëm nga shijet trupore dhe dëshirat materiale e sensuale, është, gjithsesi, i hidhur e për të ardhur keq. Nuk mund të mendohet që njerëzit që i dënojnë mundësitë dhe përpjekjet për shijet trupore, të kenë ndonjë pasuri shpirtërore.

Zemra e njeriut të mirë është përtej mallit dhe pasurisë. Ajo s'bëhet e pasur me mall e pasuri, sepse ajo është e mbushur plot dhe e pasur me dashurinë për Allahun, Zotin e gjithësisë!



Zoti ynë! Mbrona ne nga flakët e ambicjes dhe zilisë që i djezin dhe shkatërrojnë punët e mira dhe na pajis me thesarin e pafund të ngopjes dhe kënaqjes me atë që na është dhënë!

Amin, ashtu qoftë!

W



MPOSHTJA E ZEMERIMIT

Njeriu që vjen në botë si një tufë bukurish, fsheh në vetvete ose në ego cilësi të këqia, kurse në shpirt, prirje devocioni. E thënë ndryshe, njeriu është i prirur edhe për të mirën, edhe për të keqen.

Prandaj, njeriu e ka të domosdoshme t'i pastrojë cilësitë dhe prirjet e ulta me anë të pastrimit të egos, kullimit të zemrës dhe zbukurimit të moralit si dhe t'i përsosë atributet shpirtërore. Ndërkaq, morali i keq që duhet ta hedhë poshtë para së gjithash njeriu, është, pa dyshim, zemërimi, sepse zemërimi është tipari më i rrezikshëm i moralit të keq, është një gjendje egërsie që i bëhet pengesë arsyes dhe zemrës. Njeriu i zemëruar është një gjë e keqe e mbushur plot hakmarrje, urrejtje, zënie dhe krim.

Pjesa e zemërimit e librit të jetës është një histori fatkeqësie. Shpëtimi nga ky rrezik tragjik është vëllazëria dhe



përdorimi i forcës së durimit, ruajtja e qetësisë pa e prishur ekuilibrin. Ebu Derda (r.a.) i pati thënë Profetit (s.a.s.):

“Më mëso diçka nga ato gjëra që duhen për të hyrë në xhennet!”

Dhe Profeti i qe përgjigjur:

“Mos u zemëro!” (Buhari, Edeb, 76; Tirmidhi, Birr, 73)

Edhe një tjetër i pati thënë, po kështu, Profetit:

“O i Dërguari i Allahut! Nuk kam mundësi të mbaj mend shumë gjëra, prandaj më thuaj shkurt ç’të bëj që të jem i lumtur!”

Dhe Profeti i pati thënë:

“Mos u zemëro!” (Buhari, Edeb, 76; Tirmidhi, Birr, 73)

Edhe në hadithe të tjera porositet:

“Atij që e mban veten pa u zemëruar, Allahu ia mbulon të metat!” (Ihja, III, 372)

“Nuk ka gjë më të dobishme për të fituar pëlqimin e Allahut sesa gëlltitja e zemërimit!” (Ihja, III, 392)

“Pehlivoani (ekuilibristi) më i aftë nuk është ai që i tund dhe i rrëzon përtokë të gjithë partnerët! Hero i vërtetë është ai që e mban veten kur i duhet të zemërohet!” (Buhari, Edeb, 102; Muslim, Birr, 106-108)



Profetët, të urtët dhe dijetarët janë karakterizuar gjithmonë nga kujdesi dhe përpjekja për ta zotëruar zemërimin dhe, ndaj të tjerëve kanë mbajtur gjithmonë rrugën e faljes. Të vë-l-



lezërit i patën shprehur pendimin Hz. Jusufit për veprimin e tyre që do ta kishte çuar atë në vdekje:

تَاللَّهِ لَقَدْ أَتَرَكْنَا اللَّهَ عَلَيْنَا وَإِنْ كُنَّا لَخَاطِئِينَ

“... Betohe mi se Allahu të ka shquar ty ndër ne! Me të vërtetë, ne kemi bërë gabim!” (Jusuf: 91)

Kurse Jusufi, me një virtytshmëri të lartë, i pati falur ata kur i kishte të gjitha mundësitë për t'i dënuar:

لَا تَتْرِبَ عَلَيْكُمُ الْيَوْمَ يَغْفِرُ اللَّهُ لَكُمْ وَهُوَ أَرْحَمُ الرَّاحِمِينَ

“... Sot nuk ka qortim për ju! Allahu ju faltë! Ai është mëshiruesi më i madh!” (Jusuf: 92)

Shembujt më të bukur të mëshirës dhe faljes gjenden në jetën e Profetit (s.a.s.). Në ditën e triumfit të Mekës ai e pati falur Hindin, gruan që ia kishte kafshuar mëlçinë të ungjit Hamza. Ai e pati falur, në shkëmbim të thënies së Fjalës së Njesisë, Habir bin Esedin që ia kishte rrëzuar nga deveja të bijën Zejnep shtatzënë, e cila qe plagosur rëndë. Jeta e Profetit është e mbushur plot me raste të tilla. Kur zemërohej, ai s'ngrihej nga vendi. Ai nuk zemërohej veçse kur kundërshtohej Zotit, kur merreshin nëpër këmbë e drejta dhe e vërteta. Ai zemërohej edhe kur shkelej një e drejtë por askush nuk e vinte re dhe nuk qetësohej gjersa ajo e drejtë të çohej në vend. Ai kurrë nuk zemërohej për vete, nuk e mbronte veten dhe nuk hynte në debate me të tjerët për këtë.

Në Kur'an janë pohuar qëndrimet e shquara të Profetit për mposhtjen e zemërimit:

“(O i Dërguar!) Atëherë, me një mëshirë nga Zoti yt, u solle butë me ta! Po qe se ti do të tregoheshe i ashpër e



zemërgur, ata do të shpërndareshin e largoheshin. Fali ata dhe lutu për faljen e tyre dhe këshillohu me ta në çështjet e përditshme, por, kur të vendosësh, mbështetu te Allahu, sepse Allahu i do ata që mbështeten dhe besojnë te Ai!” (Al-i Imran: 159)

Në një ajet tjetër, Zoti i cilëson si **njerëz të mirësisë** njerëzit që dhurojnë, që e mposhtin zemërimin dhe i falin të tjerët:

الَّذِينَ يُنْفِقُونَ فِي السَّرَّاءِ وَالضَّرَّاءِ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ وَالْعَافِينَ
عَنِ النَّاسِ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ

“... të devotshmit që japin për Allahun si në bollëk, ashtu dhe në ngushticë, që e mposhtin zemërimin dhe që ua falin të metat të tjerëve. Edhe Allahu i do njerëzit e mirësisë!” (Al-i Imran: 134)

Siç rrëfëhet, Xhafer Sadik kishte një skllav që i bënte shërbime personale. Një ditë, skllavi i solli një tas me supë që ia derdhi pa dashje mbi rroba. Xhaferi e pa skllavin me shumë zemërim. Atëherë skllavi i tha:

“Imzot, në Kur’an thuhet: “ وَالْكَاطِمِينَ الْغَيْظَ ” “ata që e mposhtin zemërimin”!

Xhafer Sadik i tha:

“E mposhta zemërimin!”

Skllavi vazhdoi:

“Imzot, po aty, në Kur’an, thuhet: “ وَالْعَافِينَ عَنِ النَّاسِ ” “ata që u falin të metat të tjerëve”!



Xhafer Sadik i tha:

“Të kam falur, pra!”

Sklavi i tha për herë të tretë:

“Në fund të ajetit thuhet: “ وَاللَّهُ يُحِبُّ الْمُحْسِنِينَ ” “Allahu i do njerëzit që u bëjnë mirë të tjerëve!”

Xhafer Sadik i tha:

“Shko, pra, je i lirë! Për hir të Allahut, të kam dhënë lirinë!”

Kjo ngjarje tregon se sa bukur është të pajisesh me moralin e Kur’anit dhe Profetit (s.a.s.)!



Ndërkaq, duhet pohuar se zemërimi përbuzet kur e ka burimin te egoja dhe motivet djallëzore, por ndryshon puna kur është fjala për cënimin e besimit. Kur cënohen besimi, e drejta dhe e vërteta, indiferentizmi është i gabuar. Kështu, sa ç’është e rëndësishme mposhtja e zemërimit për hir të Allahut, është i rëndësishëm edhe zemërimi për hir të Allahut.

Megjithëkëtë, është mjaft e vështirë për ta dalluar qartë kufirin mes këtyre dy situatave të zemërimit dhe për të vepëruar drejt. Për ta bërë këtë dallim duhet pjekuri dhe ndjeshmëri e madhe. Për rrjedhojë, shprehjen e Kur’anit, “ata që e mposhtin zemërimin” mund ta kuptojmë si “ata që e kontrollojnë zemërimin”. Shembulli më i bukur në lidhje me këtë është veprimi i Hz. Aliut (k.v.).



Gjatë një beteje, Hz. Aliu kishte vënë poshtë një armik dhe po e vriste. Njeriu që po e shihte vdekjen me sy, bëri një gjest të shëmtuar duke e pështyrë Hz. Aliun në fytyrë.

Për Hz. Aliun, një pjesëtar trim i familjes profetike dhe i cilësuar luan i Allahut, nuk ishte e vështirë t'ia priste me një të rënë të shpatës kokën një armiku që e kishte vënë nën vete. Por, duke pasur frikë se, pas gjestit të armikut, vrasja e tij do të bëhej një fitore e egos së vet, u ndal, e uli shpatën që e kishte dhuratë prej Profetit dhe hoqi dorë nga vrasja e armikut.

Armiku u habit! Pas gjestit të ulët kundër Hz. Aliut, armiku priste që ai ta vriste me një zemërim shumë të madh për t'ia shpague fyerjen. Por nuk ndodhi siç e kishte menduar! Armiku u ndodh ballëpërballë me një të vërtetë të paimagjinueshme për të. Duke mos e kuptuar dot sjelljen e Aliut, heroit të Islamit dhe të zemrës, e pyeti me kureshtje:

“O Ali! Pse qëndrove? Pse s’po më vret? Pse u qetësove kështu, papritmas?..”

Hz. Aliu i tha kështu:

“Këtë shpatë që ma ka dhuruar i Dërguari i Allahut, unë e vërtis në rrugë të Allahut dhe për pëlqim të Tij ua pres kokën mohuesve dhe hipokritëve! Dhe në këtë punë kurrë nuk e ngatërroj veten, sepse unë jam luani dhe shpata e Allahut, jo e vetes, mendjemadhësisë dhe krenarisë sime! Duke më pështyrë në fytyrë, ti deshe të më fyesh dhe zemërosh dhe unë do të të vrisja ty për një shkak të thjeshtë që s’i ka hije kurrë muslimanit. Por unë kam dalë të luftoj jo për të kënaqur krenarinë time, por për hir të Allahut!”



Para një modeli të tillë të moralit të lartë, armiku u bë tjetër njeri. Ai e rroku konceptin e miqësisë së vërtetë dhe, duke përfituar nga kapaciteti i Hz. Aliut në mirëkuptim, falje, butësi dhe qëndresë kundër egos, besoj dhe e deklaroi besimin!

Ç'portë të lartë hapi Hz. Aliu para njeriut që e pështyu në fytyrë! Ai i fali jetën armikut, njeriut që mund ta kishte vrarë! Ai e quajti me vend t'i dhuronte lumturinë e vërtetë njeriut që deshë ta fyente, hidhëronte dhe zemëronte! Ai i zgjati atij një urë që e ngjiste në qiejt e favorit hyjnor dhe pavdekësisë! Ai i zgjati trëndafila mëkatarit dhe fajtorit që e goditi me gjembat e fyerjes dhe armiqësisë, duke e bërë që të shndërrohej në një gonxhe! Ai u soll si profeti Musa që i bëri magjistarët që de-shën ta trembnin me magjira, të shijonin kënaqësinë e besimit! Para moralit të tij të lartë, djalli i mallkuar plasi nga inati dhe u përkul!

Allahu i Lartë urdhëron:

“(O i Dërguar!) Ti zër rrugën e faljes, këshillo për mirë dhe largohu prej injorantëve!” (el-Araf: 199)

Kurse në një ajet tjetër, Zoti i përshkruan kështu cilësitë e robve të sinqertë ndaj Tij:

“... ata robtë e Mëshiruesit që ecin mbi tokë me seriozitet dhe thjeshtësi dhe, kur injorantët u hedhin ndonjë fjalë (fyese), u përgjigjen me selam (urim për paqe)!” (el-Furkan: 63)

Imam Shabiu i qe përgjigjur kështu një heretiku që e pati fyer:

“Po qe se ç'thua janë të vërteta, Allahu më faltë! Por po qe se je gënjeshtar, Allahu të faltë ty!”



Dhunun Misri thoshte kështu:

“Duhet të jesh mik i Allahut dhe armik i egos dhe jo mik i egos dhe armik i Allahut!”

Zoti ynë! Mbrona ne që të mos bëhemi robër të egos sonë! Dhe na i stolis zemrat me moralin e përlavdëruar për të cilin shpreh pëlqimin dhe kënaqësinë Tënde!

Amin, ashtu qoftë!

W





JETA DHE VDEKJA




فَلَا تَكْفُرُوا بِاللَّهِ إِنَّمَا
يُصِيبُ مَا يَشَاءُ اللَّهُ لِمَنْ
يُرِيدُ

*Allahu i Qartë urdhëron: "Thuaju:
Ne kurrë s'na prek dot ndonjë gjë (e keqe ose e mirë)
veç asaj që ka shikuar Allahu për ne!"*

(Kur'ani, Tevbe: 51)



JETA DHE VDEKJA

 shte një bakall që e kishte dyqanin në portën e daljes të qytetit. Përmes asaj porte nxirreshin të vdekurit për te varrezat. Bakalli mbante pranë një shtambë ku hidhte një bërthamë fruti sa herë që kalonte një i vdekur, duke thënë:

“Edhe ky ra në shtambë!”

Pastaj, në fund të muajit, i zbraste bërthamat, i numëronte dhe thoshte:

“Këtë muaj kaq vetë ranë në shtambë!”

Një ditë edhe ai vdiq! Ndërkaq, kishte kaluar shumë kohë kur i erdhi për vizitë një mik i largët që s’dinte gjë për vdekjen e tij. Meqë s’e pa, miku i pyeti fqinjët:

“Ç’u bë ai bakalli që e kishte dyqanin këtu?”

“Ra në shtambë!” – Iu përgjigjën fqinjët...

Ja, pra, historia e udhëtarëve të kësaj bote të përkohshme! Vjen një ditë që njeriu të harrohet aq shumë, sa të thonë për të: “Na ishte se ç’na ishte!”



Poeti Junus Emre thotë:

*Nga mitra e nënës erdhëm në pazar,
Morëm një qefin dhe u kthyem në varr!..*

Me të vërtetë, qoftë i pasur, qoftë i varfër, në fund mbetet vetëm me një qefin! Prandaj, e rëndësishme është se ç'gjëra të pavdekshme bëjmë në këtë botë, të tilla që mund t'i marrim me vete në botën tjetër!

Kurse poeti Nexhip Fazëll shprehet kështu:

*Sarraf i pangopur, qep një qese me vete për ta marrë
Dhe mblidh atë monedhë që të ketë vlerë në varr!*



Zoti e ka bërë aftësinë njohëse të njeriut të përshtatshme për të rrokur vetëm me anë të të kundërtave. Prandaj gjithësia mbështetet mbi të kundërtat. Për rrjedhojë, sa e plotë që të jetë kontradikta, aq e qartë është njohja. Dashuria dallohet me anë të urrejtjes, bukuria, me anë të shëmtisë, e mira, me anë të së keqes, mençuria, me anë të marrëzisë, vdekja fisnike, e cila është dëshmi, me anë të vdekjes së ulët...

Në rrjedhën e jetës, njeriu lëkundet vazhdimisht mes dy gjërave tmerrësisht kontradiktore siç janë gëzimi i jetës dhe rrëqethja nga vdekja. Pa u rrokur kuptimet e vërteta të jetës dhe vdekjes që janë në një rrjedhë të pandërprerë, nuk mund të rroken as enigma dhe urtësia e krijimit, as natyra e vërtetë e njeriut.

Njeriu me mendje të shëndoshë a nuk mendon se çdo gjë në gjithësi, nga plasja e farës te festa e pranverës, nga lindjet në vdekjet, nga makrobota në mikrobotë, nga molekulat te trupat qiellorë ekzistojnë dhe zhvillohen brenda një harmonie



të përcaktuar nga rregulla të pamundura për t'u rrokur denjësisht në të gjithë përmbajtjen dhe cilësinë e tyre? Mirë, po kush është artisti dhe krijuesi i kësaj rregullsie dhe harmonie? Kjo përsosmëri në gjithësi që e lë të paaftë njohjen njerëzore, a nuk është një poezi urtësish dhe shembujsh mësim-dhënës? Përgjigjja e këtyre pyetjeve ndodhet në formën më të bukur në Kur'an. Allahu i Lartë thotë:

وَمَا خَلَقْنَا السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا لَاعِبِينَ

“Ne nuk i krijuam për zbavitje qiejt, tokën dhe gjithçka ndodhet mes tyre...” (ed-Duhan: 38)

“A mos pandehni se ju krijuam juve pa ndonjë qëllim dhe se s’kemi për t’ju kthyer sërish tek Ne?” (el-Muminun: 115)

“A mos pandeh njeriu se do të lihet të bëjë si të dojë?” (el-Kijame: 36)

Urtësia e krijimit të njeriut është që, brenda aftësive dhe mundësive të veta, ta njohë Zotin dhe, duke e pajisur këtë njohje me kulturën shpirtërore, ta madhërojë Zotin me anë të akteve të mira e të bukura. Ne këtë e quajmë shkurt adhurim, detyrë të robit ndaj Zotit (krijesës ndaj Krijuesit). Dhe synimi i këtij adhurimi është që, duke e pastruar egon dhe kulluar zemrën, të arrihet bashkimi me Zotin, të bëhet robi konfident i Zotit, gjë që gjen përsosmërinë e vet me shenjtërinë²⁵ që është niveli më i lartë pas profetësisë që shpreh afrimin te Zoti.

²⁵ Në origjinal: velajet, kujdestari, shenjtëri.



Shenjtëria është ngjitja mbi përmasat egoistike, është afri-
mi shpirtëror te Zoti duke e ulur personalitetin në minimum
dhe ky nivel quhet fena fil'lah, humbje në Zotin, gjë që i ngjet
humbjes së lumit në det ose të lëndëve ushqimore në trup pas
tretjes dhe përvetësimit nga trupi.

Vdekja e ardhur pas arritjes së këtij niveli është, në kup-
timin e vërtetë të tij, një bashkim hyjnor.

Shprehja “ *مُوتُوا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوا* ” *“vdisni para se të vdisni”*, është
pohimi më i saktë i kësaj situatë. Poeti Mevlana thotë:

“Vdisni nëse dëshironi të ringjalleni!”

Me këtë ai e ka fjalën për vdekjen shpirtërore, gjë që është
lindje në jetën e pasosur, ringjallje në një botë tjetër.

Profeti (s.a.s.) i përgëzon dhe i paralajmëron për shpërb-
lim ata që munden të vdesin kështu duke e asgjësuar egon
mes haresë së besimit në një Zot të vetëm (tevhid) dhe njohjes
intuitive të Zotit (marifetullah).

Prandaj ndodh që poeti Mevlana ta quajë shpëtimin nga
bota e vdekshme dhe lindjen në botën e përhershme “nata e
martesës”. Ai thotë kështu në vargjet e tij:

*“Atë ditë kur të vdes dhe të jeni duke ma bartur tabutin, mos
pandeh se po më dhimbset kjo botë!*

*Dhe mos qaj e mos vajto për mua dhe, kur të më vësh në dhé,
mos thuaj “lamtumirë”!*

*Varri është një perde, pas së cilës është kënaqësia dhe prehja e
xhennetit, paraajsë!*

*Unë isha i vdekur dhe linda, isha lot dhe u bëra buzëqeshje, u
kredha në detin e pasionit dhe arrita, më në fund, pavdekësinë!..”*





Pa dyshim, vdekja që do t'i ndodhë pa përjashtim çdo udhëtar të jetës, është një mister që është i detyruar ta zgjidhë çdo qenie që kupton. Në ajetin e 35-të të sures Enbija thuhet:

كُلُّ نَفْسٍ ذَائِقَةُ الْمَوْتِ وَنَبَلُّوْكُمْ بِالشَّرِّ وَالْحَيْرِ فِتْنَةً وَإِلَيْهِ تُرْجَعُونَ

“Çdo qenie do ta shijojë vdekjen. Ne ju provojmë ju me anë të së mirës dhe së keqes dhe pastaj do të ktheheni tek Ne!”

Edhe në ajetin e 2-të të sures Mulk thuhet:

الَّذِي خَلَقَ الْمَوْتَ وَالْحَيَاةَ لِيَبْلُوَكُمْ أَيُّكُمْ أَحْسَنُ عَمَلًا

“Ai që i ka krijuar vdekjen dhe jetën për t’ju provuar se cili nga ju do të silllet më mirë!..”

Vdekja nuk ka ndonjë gjuhë të njohur. Ç’kuptime të frikshme ka gëpësuar ajo në atë heshtjen e saj të thellë! Profeti (s.a.s.) porositi:

“Ju kam lënë juve dy këshilltarë: njëri hesht, tjetri flet. Këshilltari që hesht është vdekja, kurse këshilltari që flet është Kur’ani!”
(Fezaili amal, f. 383)

Vdekjet janë mësimë pa tinguj e pa fjalë që u flasin njerëzve të ndjeshëm që kuptojnë, për pësimet, fundet dhe të vërtetat, më përsosmërisht se gojët më kompetente!

Supet e dobëta të fjalëve nuk mund ta durojnë rëndesën tronditëse të vdekjes. Përballë vdekjes, të gjitha pushtetet shkrihen dhe marrin fund!



Para vdekjes, dashuritë kalimtare, dëshirat e çmendura, dëfrimet e përkohshme dhe filozofitë sakate që i shkatërrojnë në njerëzit në rrugët pa dalje, duken më të mjera se gjethet e zverdhura të vjeshtës që i zvarrit era!

Varrezat janë plot me adresa prindërishe, fëmijëshe, familjesh, të dashurish, të afërmish, shokësh e miqsh që e kanë konsumuar jetën. Në çfarëdo kushtesh që të jetë jetuar jeta, në pallate të shkëlqyera ose mbi kashtë, të gjitha rrugët e saj me të gjitha lakimet e tyre kanë vetëm një pikë daljeje: varrin! Nuk ekziston as ndonjë vend tjetër e as ndonjë kohë tjetër kur e ku të mund të iket për të shpëtuar prej tij!

Në hadithin profetik thuhet:

أَكْثَرُوا مِنْ ذِكْرِ هَازِمِ اللَّذَاتِ

“Dhe kujtojeni shpesh vdekjen, atë që i pret si me thikë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote!” (Tirmidhi, Zuhd, 4; Nesai, Xhenaiz, 3)

Kurse në Kur'an thuhet:

يَقُولُ الْإِنْسَانُ يَوْمَئِذٍ أَيْنَ الْمَفْرُ

“Atë ditë (në ditën e kiametit) njeriu thotë: “Ku mund të iket?” (el-Kijame: 10)

Në lidhje me varrin që do të marrë formë me sjelljet tona të klasifikuara në bazë të zbatimit apo jo të urdhrave të Allahut, Profeti shprehet:

“Ose një lulishte nga lulishtet e xhennetit, ose një gropë nga gropat e xhehennemit!..” (Tirmidhi, Kijamet, 26)

Duke u shprehur kështu, ai ka dashur të shënojë lidhjen shumë të ngushtë të vdekjes me jetën.



Ebu Derja (r.a.), një njeri me sytë e zemrës të hapur, ishte ulur në krye të një varri dhe kishte thënë:

“O varr! Sa i heshtur je nga jashtë, por me sa frikëra të tmerrshme je i mbushur brenda!..”

Dhe kishte qarë me ngashërim!

Një sahabi e pati pyetur Profetin:

“Kush quhet njeri i mençur, o i Dërguari i Allahut?”

Dhe ai i qe përgjigjur:

“Ai që e mendon shumë vdekjen dhe që preokupohet shumë për t’u përgatitur për të!..” (Ibni Maxhe, Zuhd, 31)

Shtëpitë e njerëzve indiferentë që i janë nënshtruar egos së vet, janë pothuaj si varre familjare të vdekurish të gjallë. Ata nuk mendojnë se herët a vonë, vdekja nuk mungon të vijë, por vjen pikërisht në kohën e duhur! Atyre që kërkojnë t’i ikin vdekjes, Kur’ani u bën zë kështu:

“(O i Dërguar!) Thuaju: “Vdekja ka për t’ju gjetur kudo që të jeni, edhe sikur të jeni mbyllur brenda kalash me mure të trashë!” (en-Nisa: 78)

“Thuaju: “Vdekja që ju i ikni, do t’ju arrijë dhe pastaj do të dilni para Allahut që e njeh të dukshmen e të padukshmen dhe do t’ju tregojë juve se ç’keni bërë!” (el-Xhuma: 8)



Njeriun e gëlltit vaniteti dhe kotësia nëse s’arrin ta rrokë urtësinë e krijimit të gjithësisë duke përfshirë në të edhe qenien e vet. Njeriu që nuk mediton për ardhjen dhe largimin e



vet nga kjo botë dhe nuk arrin ta kuptojë këtë gjë, do të thotë se është indiferent si dhe i paimformuar edhe për të vërtetën e ekzistencës së vet, madje! Njeriu nuk është produkt rastësor i një aventure të pakuptim!..

Për besimtarët që e arrijnë këtë të vërtetë, vdekja është etapa e parë e konfidencës hyjnore, më të madhes ndër dhuntitë që i falen njeriut!

Në Kur'an, devocioni²⁶ është ndër fjalët më të shpeshta pas fjalës "Allah". Devocioni është ruajtja e zemrës, është zotërimi nga njeriu mbi egon dhe personalitetin e vet, është ngjitja e shpirtit në majat e përsosmërisë. Në Kur'an thuhet:

إِنَّ أَكْرَمَكُمْ عِنْدَ اللَّهِ أَتْقَىكُمْ

"Më i vlefshmi ndër ju është ai që e ka frikë më shumë Allahun (që është më i devotshëm ndaj Allahut)!.." (el-Huxhurat, 13)

Duke u përsosur me anë të devocionit dhe adhurimit, aktet fitojnë cilësinë e "aktit të mirë"²⁷. Për njerëzit që karakterizohen për akte të mira, Allahu i Lartë thotë:

"Ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira (kryejnë akte të mira), do t'i vendosim në xhennete nën të cilët rrjedhin lumenj, ku ata do të mbeten përgjithmonë!.." (en-Nisa: 122)

Adhurimi, devocioni dhe akti i mirë janë ndjeshmëri në zemër, dritë në ndërgjegje, prehje në shpirt dhe përsosmëri në moral.

²⁶ Në origjinal: takva, përkushtim i thellë ndaj urdhrave të Allahut.

²⁷ Në origjinal: salih amel.



Në përfundim të largimit prej mashtrueshmërisë së botës dhe pamjeve iluzive, shpirti arrin një nivel të tillë që mund të arrihet vetëm me anë të fitoreve materiale e moralo-shpirtërore. Në një hadith të tij, Profeti porositi:

“Luftëtari i vërtetë në rrugën e besimit është ai që lufton kundër vetvetes (egos)!” (Tirmidhi, Fezailu Xhihad, 2)



Me gjithë veprimtarinë orientuese të profetëve, çështja e vdekjes e ka preokupuar njerëzimin qysh në krye të herës. Kjo pengesë e tmerrshme e ulur rrafsh në mendjen e njeriut si një gjarpër i përdredhur rreth vetes por gjithnjë kërcënues, është kërkuar të heshtet me anë të shprehjeve egoistike të shumëllojshme.

Vdekja e cila ka për ta thithur çdo njeri në dredhat e vorbullës së saj, konceptohet ose si një perspektivë e frikshme, ose si një fatkeqësi, ose si një mëshirë. Mundësia për ta zgjidhur këtë nyje të perspektivës sonë, e cila qëndron larg rrokjes ashtu siç duhet me anë të meditimit njerëzor, bëhet reale duke e kapërcyer pengesën ego për t’i vënë veshin zbulesës hyjnore, duke përfituar edhe nga klima ndjesore e profetëve dhe të urtëve!

Faktin që çdo çast i kapërcyer i vijës kohore na afron në mëngjesin e të vërtetës, Kur’ani e shpreh në këtë mënyrë:

وَمَنْ نَعْمَرُهُ نُنَكِّسْهُ فِي الْخَلْقِ أَفَلَا يَعْقِلُونَ

“Atij që i japim jetë të gjatë, ia prishim krijimin (rininë dhe bukurinë). A nuk e kuptojnë ata këtë gjë?” (Jasin: 68)




Zoti ynë! Na e stolis dhe beko jetën dhe vdekjen me anë të begative, dhuntive dhe bukurive të larta me të cilat i ke favorizuar robtë e Tu të mirë, si dhe me bashkimin me Ty!

Amin, ashtu qoftë!

W



TA ZBUKUROSH VDEKJEN

 shte një furrtar i çuditshëm. Edhe po t'i jepnin para kallpe, i pranonte dhe, pa i thënë gjë dhënësit, pa ia përplasur syve mashtrimin, i jepte bukën që kërkonte. Ndërkaq, të gjithë habiteshin me të dhe askush nuk e kuptonte pse e bënte këtë. Më në fund, kur i erdhi ora e vdekjes, furrtari hapi duart drejt rezidencës së lartë dhe u lut kështu:

“Imzot, Ti e di se për vite të tëra njerëzit më sollën para kallpe, kurse unë, pa i qortuar, pa ua përplasur syve mashtrimin, u dhashë bukën që më kërkoni! Imzot, edhe unë po vij tani para Teje me bindje kallpe dhe të lutem të mos më qortosh për to, të mos m'i përplasësh syve mëkatet!”

Veprimi i furrtarit flet për qëllimin dhe përpjekjet e sinqerta të tij për ta vlerësuar veten në këtë botë dhe për t'u përgatitur për botën tjetër.

Shkurt, kësaj mund t'i themi ta zbukurosh vdekjen që është urë kalimi mes dy botëve. Sipas kësaj, synimi i të ashtu-



quajturit zbukurim i vdekjes është që të vdesësh para se të të ndodhë vdekja e pavullnetshme, siç thotë edhe porosia:

مُوتُوا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوا

“Vdisni para se të vdisni!”

Kjo do të thotë që, sa të jesh gjallë, t’i asgjësosh në mënyrë të vullnetshme situatat negative dhe të shëmtuara të egos, gjë që përbën pjekuri personaliteti, dhe të kalosh nga cilësia e njeriut të zakonshëm në cilësinë e njeriut të përkryer!

Para njeriut që arrin këtë nivel përkryerjeje, hapen perdet që e ndajnë nga Krijuesi dhe shijet e përkohshme e humbin vitalitetin, njeriu përjeton qetësi në adhurim, delikatesë në trajtim dhe virtyt në moral, shpirti i tij fillon të shijojë çdo ra-dhë kënaqësinë e përjetshme të afrimit të Zotit. Është për këto arsye që poeti Mevlana e ka cilësuar etapën e parë të tij para se ta shijonte kënaqësinë e afrimit të Zotit, me shprehjen “isha një gjë e papërpunuar”, etapën kur e shijoi atë kënaqësi, me shprehjen “u poqa” dhe etapën kur shfaqjet e enigmave të gjithësisë iu hapën parasysht si një libër dhe iu bënë të qarta, me shprehjen “u poqa”!

Në të njëjtën kohë, këto shprehje janë një pohim i shfaqjeve të përpjekjeve në rrugën për afrimin të Zotit. Megjithëse rrugët që të çojnë të Zotit janë, siç thotë një shprehje e njohur, sa frymët e krijesave, rruga më me ndikim është “rruga e mohimit të vetvetes”²⁸. “Mohim i vetvetes” do të thotë shpëtim nga identiteti si rezultat i dashurisë dhe afërsisë ndaj Zotit dhe heqje dorë me zemër dhe praktikisht nga çdo vanitet. Dhe ky është **zbukurimi i vdekjes** me anë të të fshehtës

²⁸ Në origjinal: fakr u fenâ.



“مَوْتُوَا قَبْلَ أَنْ تَمُوتُوَا” “*vdisni para se të vdisni*” në gjendjen e humbjes te Zoti ose gjendja e një konfidence të përjetshme. Vetëm se meritimi i njohjes së shfaqjes së kësaj të fshehte është i mundur duke i respektuar në praktikë esencialisht këto parime kryesore që vlejné për të gjithë:

Pendesa

Mëkatet shfaqen nga prirjet si injoranca, epshi, mendjemadhësia, krenaria, ambicja, koprracia, smira, shpërdorimi dhe zemërimi. Këto gjendje janë pengesa mes Krijuesit dhe njeriut. Po ta hapë perden e indiferentizmit, njeriu e ndjen në ndërgjegje peshën e mëkatit që ka bërë, në zemër i zgjohet ndjenja e fshehur e virtytit dhe zemra, duke u djegur thellë me një pendim të madh, strehohet te Zoti. Ja kjo është pendesa. Është kthimi te Zoti. Prandaj, pendesa shpreh kthimin e vullnetshëm te Zoti para se t’i vijë vdekja që është kthim i pavullnetshëm te Zoti. Pendesa është largimi me anë të pendimit i pengesave mes Zotit dhe robit.

Në kthimin kah Zoti, pendesa është domosdoshmëria e parë që duhet realizuar. Sepse mëkatet janë një pengesë që e pakësojnë ndjeshmërinë e zemrës dhe e bëjnë inerte atë, krejt si turbullimi i pamjeve te një pasqyrë e pluhurosur. Ashtu siç duhet pastruar me një leckë të pastër pasqyra e pluhurosur për ta bërë sërish të ndritshme, edhe në kthimin kah Zoti, zemra duhet pastruar më parë nga papastërtitë morale me anë të pendimit dhe pengesës. Prandaj ndodh që në të gjitha degët e mistikës mësimi fillon me pengesë. Kjo i përngjet fjalës mohuese “لا” “la” me të cilën fillon Fjala e Njësisë ku në fillim mohohet, pastaj pohohet. Pra, në fillim duhet eliminuar



negativiteti që i bëhet pengesë arritjes te synimi dhe, kështu, përgatitet trualli i përshtatshëm për qëllimin bazë.

Për këtë arsye, pendesa kryhet pothuajse si një detyrim për lutjet e bëra me zemër të pastër.

Poeti Mevlana thotë kështu për pendesën:

“Pendohu me zemrën plot me zjarrin e pendimit dhe me sytë plot lot! Sepse edhe lulet çelin në vende me diell dhe lagështirë...”

Tërheqja nga bota²⁹

Është heqja dorë me zemër nga stolitë, kënaqësitë, pasuritë dhe pozitat materiale. Vdekja është ndërprerje brenda një çasti e të gjitha lidhjeve të njeriut me këto gjëra. E vërteta e tërheqjes nga bota është ndërprerja e vullnetshme me zemër e lidhjeve në fjalë para se të ndodhë ndërprerja e pavullnetshme, vdekja!

Fudajl bin Ijadh thotë:

“Po qe se kjo botë e përkohshme që e mban këdo në gjumin e indiferentizmit, do të ishte prej floriri dhe xhenneti i përhershëm, prej dheu, njerëzit e zgjuar do të zgjidhnin jo atë prej floriri, por atë prej dheu!”

Përsa kohë njohja njerëzore e shtrënguar mes dy të vërtetave madhështore e të tmerrshme siç janë ardhja në këtë botë dhe largimi prej saj, nuk do të mundë të arrijë në një konkluzion vlerësues përfundimtar mbi këtë botë dhe përjetësinë dhe qëndrimet dhe veprimet e njeriut nuk do të rregullohen sipas atij konkluzioni, njeriu, si lojrat e fëmijëve, nuk do të mund të

²⁹ Në origjinal: zuhd, asketizëm.



shpëtojë nga bota e hijeve relative dhe nuk do të mund të dalë në udhëtimin jomaterial drejt vendit të së vërtetës.

Njëri prej dijetarëve të kulturës shpirtërore e ka përshkruar këtë botë-ekspozitë të urtësive dhe pësimeve për të mençurit si “soditje e bukurive”, kurse për kokëtrashët, “ngrënie dhe epsh”.

Po qe se zemra nuk mban një qëndrim të caktuar ndaj jetës së kësaj bote që jetohej materialisht, pra, me anë të përceptimeve, ndijimeve dhe ndjenjave si dhe funksioneve biologjike, përfundimi bëhet një disfatë që çon në shkatërrim.

Dorëzimi³⁰

Është mbështetja dhe nënshtrimi i robit, para se të vdesë, te Zoti. Me besimin dhe nënshtrimin te Zoti, nuk arrihet dot shmangia nga shkaqet dhe vlerësimi i tyre, por arrihet të kuptohet se po qe se masa paraprake nuk përputhet me paraktimin hyjnor, nuk ka ndonjë dobi. Kështu, vdekja në perspektivë është pikërisht gjendja kur asnjë lloj mase nuk mund ta parandalojë atë çast. Allahu i Lartë urdhëron:

وَمَنْ يَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ فَهُوَ حَسْبُهُ

“... Kush i dorëzohet Allahut, Allahu i mjafton atij...”

(et-Talak: 3)

E thënë ndryshe, dorëzimi është fakti që njeriu, zemra e të cilit është e mbushur plot me dashurinë për Allahun, ka siguri vetëm për Të dhe mbështetet vetëm te Ai. Zoti e pati

³⁰ Në original: tevekkul, dorëzim (në dorë të dikujt që merr përsipër dorëzaninë në fjalë).



pyetur profetin Musa për shkopin që mbante në dorë dhe pastaj e pati urdhëruar: “Hidhe atë!” Sepse, duke i dhënë Musait ndjenjën e sigurisë, shkopi hidhte hije mbi dorëzimin e plotë të tij te Allahu. Gjithashtu, Allahu i lartë urdhëron:

“... Po qe se jeni besimtarë, dorëzoni vetëm Allahut!”

(el-Maide: 23)

Dorëzimi nuk është hedhja mënjane e masave dhe iniciativave, përkundrazi, duke i përdorur ato, mbështetja në shfaqjet e fuqisë së Zotit.

Zjarri nuk e dogji profetin Ibrahim pikërisht si rezultat i këtij dorëzimi dhe nënshtrimi. Sepse kur dorëzimi u bë i plotë, Allahu e urdhëroi zjarrin: **“Bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!”**

Në fakt, dorëzimi është nënshtrimi i njeriut te Zoti në mënyrë të vullnetshme, sa është gjallë, para se t’i vijë vdekja që është dorëzim i pavullnetshëm.

Poeti Mevlana na flet neve për matjen dhe llogaritjen e dorëzimit:

*“Kërko të mësosh nëse ka tek ti cilësi të Ibrahimit, sepse zjarri
njej dhe nuk djeg vetëm ata që i dorëzohen denjësisht Allahut si
Ibrahimi!”*

Ngopja³¹

Është të mos kërkosh ose ndjesh kërkesë për më shumë se nevoja. Me vdekjen, njeriu hyn në një klimë të detyruesh-

³¹ Në origjinal: kanaât.



me ngopjeje. Mjekimi i vetëm i ambicjes dhe smirës si më të rrezikshmet e moralit të ulët është i mundur vetëm me hyrjen në frymën qetësuese dhe prehëse të ngopjes dhe kënaqjes me atë që të është dhënë, sepse thesaret hyjnore që i jep ngopja zemrës as konsumohen, as mbarojnë. Kështu, Profeti (s.a.s) thotë:

القنَاعَةُ كَنْزٌ لَا يَفْنَى

“Ngopja është një thesar i pashtershëm e i pafund!” (Dejlemi, Musned, 4699)

Prandaj, njësia e vërtetë e masës e të qenit i pasur është ngopja. Është ta pranosh dhe pëlqesh përpjesëtimin hyjnor të të mirave. Është të mos i kesh smirë ata që kanë më shumë se ti. Kënaqësia e pasurisë së zemrës mund të shijohet vetëm me anë të ngopjes.

Fakti që përpjestimi i të mirave është bërë në pafillimshmëri ose, e thënë ndryshe, ka karakter eternal, është një e vërtetë besimore. Pavarësisht nga kjo, një pjesë njerëzish, megjithëse e vënë re se, në shumicën e rasteve, fituesi dhe konsumuesi janë dy njerëz të ndryshëm, nuk munden të shpëtojnë lehtë nga ambicja për të shtënë në dorë mall e pasuri. Në nënvetëdijen e njerëzve të tillë ekziston një shfaqje egoizmi e vështirë për t’u eliminuar. Malli e pasuria për ta vetë si dhe për të tjerët përreth ekziston në formën e një iluzioni fuqie. Miratimi dhe interesimi që mbledhin përgjithësisht prej zemrave ziliqare, u jep një kënaqësi dhe ëndje tro-nditëse.

Ja, pra, ngopja është ilaçi i vetëm hyjnor që i eliminon këto sëmundje. Vetëm me begatinë e ngopjes mund të mbetet njeriu larg lidhjeve dhe interesimeve të rrjedhura si një



fatkeqësi nga malli e pasuria e kësaj bote, që e shkatërrojnë zemrën. Prandaj, shmangia që është pjesë e gjendjes së ngopjes, duhet të veprojë jo vetëm ndaj mallit e pasurisë, por edhe ndaj miratimit dhe interesimit që zgjojnë përreth shfaqjet e fuqisë që lindin malli e pasuria.

Shkurt, është e domosdoshme që njeriu të bëhet i vetëdijshëm se malli dhe pasuria i përkasin Allahut dhe se njeriu është vetëm një arkëtar i tyre. Për njerëzit indiferentë që nuk e sjellin ndërmend vdekjen, Aliu (r.a.) ka thënë:

“Shumë njerëz përpiqen të mbledhin pasuri vetëm që trashëgimtarët e tyre të grinden me njëri-tjetrin!”

Vetveçimi nga masa³²

Vetveçimi nga masa është, në përkushtimin mistik, kusht për të arritur përkryerjen. Ndërkaq, për të mos u penguar domosdoshmëritë e jetës shoqërore, forma e përgjithshme e këtij veçimi nuk është një vetmi praktike, por, ndoshta, një veçim ndjesor mes masës. Kuptimi i kësaj është kthimi kah Allahu duke e izoluar zemrën me sa të jetë e mundur nga lidhjet dhe interesat materiale.

Krahas kësaj, vetveçimi praktik i disa mistikëve nuk e dëmton jetën shoqërore sepse numri i tyre është i pakët. Kjo është një gjendje e posaçme. Kurse vetveçimi nga masa në kuptim të përgjithshëm dhe duke pasur parasysh shumicën e njerëzve, është jo izolimi në një skaj duke hequr dorë nga të gjithë e nga gjithçka, përkundrazi, është mundësia për të qenë së bashku me Zotin duke qenë mes masës. Ndërsa

³² Në origjinal: uzlet (halvet der-encümen)



vdekja është një veçim ose izolim i pavullnetshëm, vetveçimi që nënkupton afërsinë me Zotin duke qenë mes masës, është i vullnetshëm.

Zikri³³

Frymëzimi dhe begatia hyjnore³⁴ janë të pranishëm me intimitetin dhe dashurinë³⁵, kurse intimiteti dhe dashuria realizohen në raport me vendin që zë zikri ose përmendja e emrit të Zotit në zemër dhe mendje. Që i dashuri të zërë vend në zemër dhe mendje, duhet që të kujtohet. Sa më shumë që të kujtohet, aq më i madh është intimiteti, aq më e madhe është dashuria që ndjehet për të.

Emri individual i Zotit, Allah, është, ndër emrat hyjnore, më i ndikueshmi si burim frymëzimi dhe begatie hyjnore. Është për arsye të peshës së madhe të shfaqjes së tij që nxënësi i fushës së mistikës bën më parë një periudhë përgatitore me pendesë, pastaj fillon nga zikri, përmendja e emrit Allah.

Zikri ose përmendja e emrit të Allahut ndikon fuqimisht në zemra, gjë që ka si rezultat një frymëzim dhe begati hyjnore të madhe. Në Kur'an thuhet:

الْأَبْدَانِ لِلَّهِ تَطْمَئِنُّ الْقُلُوبُ

33 Shkrimi dhe leximi i kësaj fjale në origjinalin arabisht është *dhikr*, por tek ne është ngulitur për traditë trajta *zikr* që, për këtë arsye, po e lëmë kështu.

34 Në origjinal: fejk, frymëzim dhe begati hyjnore moral-shpirtërore.

35 Në origjinal: muhabet, intimitet dhe dashuri.



“Zemrat vetëm me përmendjen e Allahut kënaqen!”

(er-Rad: 28)

Po qe se Fjala e Lartë, Allah, nuk gjen vend në esencën e zemrës, njeriu mbetet i mbërthyer pas mallit, pasurisë, gjërave materiale dhe pas një sërë dëshirave egoistike e trupore. Në Kur’an thuhet:

أَرَأَيْتَ مَنْ اتَّخَذَ إِلَهَهُ هَوِيَهُ

“(O i Dërguar!) A i ke parë ata që i bëjnë dëshirat dhe pasionet e veta për zot?..” (el-Furkan: 43)

Në zemrat e mbushura plot botë shpirtërore, zënë vend morali i bukur, punët e mira dhe situatat shpirtërore, njeriu fiton cilësinë e krijesës më të mirë. Kurse në zemrat e mbushura plot egoizëm dhe ndjenja të ulta, zënë rrënjë mohimi, idhujtaria, veset, epshi dhe lëkundjet të cilat fillojnë ta sundojnë zemrën dhe zemra, duke marrë një kahje të kundërt me synimin e krijimit të vet, verbohët. Për pasojë, disa herë njeriu bie në një nivel më të ulët se krijesat e tjera. Fundin e atyre që i mposht egoja, poeti Nizami e përshkruan kështu:

“Kënaqësitë e kësaj bote (materiale) janë si kruarja e një dore me zgjebe. Në fillim kruarja jep kënaqësi, pastaj dora merr flakë dhe nuk ngopet me të kruar...”

Khunejd Bagdadi e shpreh kështu zburimin e vdekjes me anë të dekretit “vdisni para se të vdisni”:

“Zoti të vdes ty duke të shkëputur nga vetja (egoja) jote dhe të ringjall pranë Tij!”



Kthimi kah Zoti³⁶

Eshtë shmangia nga çdo ftesë tjetër tërheqëse veç ftesës së ardhur nga Zoti. Vdekja është pikërisht kjo: heqja dorë nga çdo ftesë tjetër duke iu përgjigjur vetëm ftesës së Zotit! Robi i mirë i Zotit, në kuptim të vërtetë, nuk mund të ketë as kërkesë, as mik dhe as synim tjetër veç Zotit të vet dhe as që mund të rrijë indiferent ndaj Tij. Me vdekjen, njeriu indiferent largohet në mënyrë të pavullnetshme prej çdo gjëje ndaj së cilës u prir në këtë botë veç Zotit. Lumturia e vërtetë është që qysh në këtë botë të priresh dhe të kapesh pas Zotit dhe çdo gjëje që ka pëlqimin e Tij!

Durimi³⁷

Eshtë, përballë ngjarjeve të pakënaqshme dhe dhimbëse, ruajtja e qetësisë pa e prishur ekuilibrin e jashtëm e të brendshëm dhe dorëzimi te Zoti. Varri do të jetë një mjedis i durimit të detyruar ndaj të gjitha dëshirave materiale. Për të duruar, na duhet detyrimisht të përdorim aftësitë tona moralo-shpirtërore, si falja, butësia, thjeshtësia, nderi, ngjopja, dhe-mbshuria, delikatesa dhe mirëkuptimi. Eshtë shumë e rëndësishme që të bëhet durim ndaj çdo gjëje që largon prej pëlqimit të Zotit. Në ajetin e 109 të sures Junus thuhet:

“... Duro gjersa të vijë urdhri i Allahut!..”

Durimi është një mburojë e madhe përballë vështirësive. Kurse vdekja është fundi i durimit ndaj dëshirave sensuale e egoistike. Dhe varri është mjedisi i detyruar i durimit gjer në kiamet.

³⁶ Në origjinal: tevehxhuh.

³⁷ Në origjinal: sabr.

Tërheqja në botën e brendshme³⁸

Është braktisja e fuqisë dhe forcës vetiake. Edhe vdekja është një humbje e tillë. E thënë ndryshe, duke e ndjerë veten çdo çast nën vëzhgimin hyjnor, njeriu të largohet nga e keqja dhe burimet e saj. Asnjë qenie nuk mund të mbetet jashtë administrimit të Zotit, nuk mund të shpëtojë nga vdekja dhe nga ringjallja. Mosekzistenca me ekzistencën, vdekja me jetën, përkohshmëria me përhershëmërinë janë çdo çast në marrëdhënie të dyanshme mes tyre. Çdo çast në trupin tonë vdesin mijra qeliza dhe çdo çast mijra qeliza lindin përsëri. Çdo çast mijra njerëz lindin dhe çdo çast mijra njerëz i japin lamtumirën jetës. Çdo çast mijra njerëz indiferentë e humbin veten në kënaqësitë sensuale e materiale, dehen dhe bëhen tapë, ndërsa në të njëjtën kohë mijra njerëz tejet të ndjeshëm i drejtohen Zotit me lutje e përgjërime. Va-rrin, domethënë stacioni i fundit i kësaj bote, pret njeriun pa bërë ndonjë përjashtim. Në tërë gjithësinë vepron vetëm administrimi, sundimi dhe rregulli i Zotit. Që njeriu të fitojë nivel në ekzistencën e vet, është e rëndësishme të ndodhet brenda përmbajtjes së administrimit hyjnor. Duke e menduar dhe përfytyruar çështjen kështu, njeriu arrin ta rrokë sekretin e parimit:

مَنْ عَرَفَ نَفْسَهُ فَقَدْ عَرَفَ رَبَّهُ

“Kush e njeh vetveten, e njeh Zotin!”

Dhe, duke e kuptuar këtë të vërtetë, njeriu mund të orientohet drejt konfidencës së Zotit.

³⁸ Në origjinal: murâkabe.



Pëlqimi hyjnor³⁹

Është largimi i njeriut nga pëlqimi i vetvetes (egos) dhe jetesa sipas pëlqimit të Zotit. Edhe vdekja është nënshtrimi përfundimtar ndaj pëlqimit të Zotit.

Pëlqimi është ngritja e njohjes në një nivel më të lartë si rezultat i pastrimit të egos dhe purifikimit të zemrës. Kështu, duke u çliruar nga robëria e materies mashtruese dhe vdekëtare, njeriu i nënshtrohet vetëm Zotit.

Meditimi mbi vdekjen

Bota është shkollë hyjnore e besimit, kurse vdekja, ligj i detyrueshëm kalimi nga një gjendje në një tjetër. Poeti Mevlana thotë:

“Vdisni që të ringjallen!”

Ringjallja e zemrës është e mundur vetëm me anë të braktisjes së sensualizmit dhe egoizmit. Profeti (s.a.s.) porositi:

“Mendojeni shpesh atë (vdekjen) që i zhdok me rrënjë të gjitha kënaqësitë!” (Tirmidhi, Zuhd, 4; Nesai, Xhenaiz, 3)

Meditim mbi vdekjen do të thotë ta kujtosh vdekjen e pavarur nga vullneti yt para se të të vijë. Kështu, duke u larguar nga sensualiteti dhe egoizmi, nga e gjithë qenia e tij materiale, njeriu e përgatit vullnetarisht veten për të dalë para Zotit. Ky është meditimi dhe vetëdija mbështetur mbi besimin.

³⁹ Në origjinal: riza.



Pa asnjë dyshim, dëshirat e kësaj bote, shpresat dhe ngushëllimet e përkohshme janë si gjethe vjeshte që bien mbi dheun e varrit.

Çdo gur varri është një këshillues i zjarrtë që flet me gjuhën e vdekjes dhe heshtjes. Varret brenda qytetit, anës rrugëve dhe në oborret e xhamive janë për një lloj meditimi mbi vdekjen.

Meditimi më i qartë mbi vdekjen fshihet në enigmën e heshtjes së pazbërthyeshme të ngrirë në buzët e nxira të të vdekurve.

Peshën tronditëse të vdekjes nuk mund ta mbajnë supet e dobëta të fjalëve! Përballë vdekjes, të gjitha pushtetet shkrihen e mbarojnë!

Para oratorisë së këshillave të vdekjes, përgjigjet që vijnë nga bota janë vetëm lot dhe ngashërime të thata!



Po qe se njeriu heq dorë me vullnetin e vet nga cilësitë sensuale e egoistike, pa dyshim që Zoti, me bujarinë dhe favorin e Tij, e ripërtërin atë. Në Kur'an thuhet:

“A mund të jetë ai që, ndërsa qe i vdekur, Ne e ringjallëm dhe e pajisëm me dritë që të mund të ecë mes njerëzve, si ai që ka mbetur mes errësirash pa mundur të dalë prej tyre?..” (el- En'am: 122)

Ky njeriu që hoqi dorë nga cilësitë sensuale e egoistike sa qe në botë, u bë ndër ata që u ringjallet zemra. Profeti (s.a.s.) porositi:



“Frikësohuni nga zgjuarsia e besimtarit sepse ai sheh me dritën e Allahut...” (Xhemiu'l-Fevaid, V, 329)

Kjo botë është një iluzion optik mashtrues, kurse bota e pasme, një jetë e pavdekshme. Vdekja është kiameti vetiak i posaçëm i personit. Le të zgjohemi para kiametit tonë në mënyrë që të mos biem në pendim. Se është e padyshtimtë që, në një kohë dhe vend të panjohur, çdo vdekëtar ka për t'u përballur me Azrailin. Nuk ka ndonjë vend ku njeriu të mund t'i ikë vdekjes. Atëherë, duke marrë pjesë nga e fshehta “ فَعِزُّوا إِلَى اللَّهِ ” **“vraponi te Allahu** (pa humbur kohë)” (edh-Dharijat: 50) njeriu duhet ta pranojë mëshirën hyjnore si strehim të vetëm!



Po qe se njeriu jeton nën sovranitetin e egos duke besuar vetëm te kjo botë, varri i duket si një vrimë e zezë. Tmerri i vdekjes e tmerron atë sa nuk mund ta tmerrojë asgjë tjetër. Në këto kushte, po qe se e kapërcen egon sipas parimeve të përshkruara më sipër dhe ecën para duke kapërcyer largësi në drejtimin që i tregon atributi engjëllor që përmbahet në shpirtin e tij, vdekja i duket si një kusht i detyrueshëm i konfidencës me Zotin e vet transcendental dhe madhështor përtej çdo përfytyrimi! Kështu, vdekja që tek shumica e njerëzve shkakton djersë të ftohta, kthehet në zemra në emocionin e bashkimit me Mikun e Madh.

Dhe, kështu, sipas shprehjes së poetit Mevlana Xhela-leddin Rumi, vdekjet janë “net dasme”. Dhe shndërrimi i vdekjes në natë dasme bëhet “duke e zbukuruar” atë, duke e adhuruar Zotin ashtu siç thuhet në Kur'an:



“Adhuroje Allahun gjersa të të vijë fakti (vdekja)!”

(el-Hixhr: 99)

Zoti na e bëftë të mundur ta vështrojmë gjithësinë me syrin e intimitetit dhe dashurisë hyjnore, ta sodisim atë nga këndi i vetëdijes, ndjenjës, dridhjeve të ndërgjegjes dhe emocioneve të besimit, të arrijmë në klimën e faljes hyjnore me lotët e pendesës dhe, duke e kuptuar të fshehtën e “vdekjes pa vdekur ende”, të zgjohemi në botën e të vërtetës!

Ç’lumturi për ata që munden të kthehen te Zoti pa u ardhur ende vdekja!

Amin, ashtu qoftë!

W



ENIGMA E NATES

Janë të panumërta vlerat që i ka dhënë Zoti natës dhe të fshehtat e vendosura brenda saj. Në lidhje me këtë, e fshehta e betimi të Zotit mbi natën është një dritare hyjnore e hapur për t'i treguar njohjes dhe zemrës sonë shumë të vërteta: **“Betohem mbi natën dhe gjërat e saj!”** (el-Inshikak: 17); **“Betohem në natën kur bie qetësia, se...”** (ed-Dua: 2); **“Betohem në natën kur bie errësira dhe në mëngjesin kur fillon të zbar-dhë!”** (et-Tekvir: 17-18)

Gjithashtu, në Kur'an theksohet:

“E bëmë për ju natën një mbulesë.” (en-Nebe: 10)

Fakti që Kur'ani flet për natën si një mbulesë, bart një sërë të vërtetash për të cilat e meriton të flitet posaçërisht.

Me të vërtetë, netët janë një mbulesë shëndetësore, shoqërore, moralo-etike dhe estetike. Janë një mbulesë fuqie, prehjeje dhe dhuntie e prerë sipas shtatit të tokës. Janë, edhe sipas ligjit të martesës, një mbulesë paqeje dhe lumturie. Në të njëjtën kohë, janë një perde enigmatike që fsheh dhe mbron



intimitetin e martesës. Janë një strehim për ata që kërkojnë të fshihen fizikisht dhe shpirtërisht. Në këtë kuptim, ndërsa nga njëra anë netët janë për të dashurit e pasionuar pas Zotit një kohë bashkimi me Të, nga ana tjetër janë një vetëmasht- rim i madh për mëkatarët dhe të nënshtruarit ndaj egos dhe sensualitetit.

Ditët nuk mund ta japin qetësinë shëndetësore të netëve. Për rrjedhojë, njeriu nuk mund ta hedhë nga supet peshën materiale dhe shpirtërore të lodhjes së ditës pa u mbështjellë në qetësinë e natës. Po të mos ishte nata, sa e sa njerëz ambi- ciozë e të pangopur, duke e shtyrë gjumin, do ta shkatërro- nin veten siç plasin kuajt e lodhur në padurim nën nxitjen e kalorësve të pamëshirshëm. Ja, pra, si rezultat i përpjesëtimit hyjnor, koha është ndarë në ditë dhe natë.

Ngjarjet më të rëndësishme si për mirë, ashtu dhe për keq, kanë ndodhur e ndodhin më shumë natën se sa ditën. Në ajete të ndryshme theksohet se ndëshkimi hyjnor ka ndodhur përgjithësisht natën. Në një ajet, Allahu thotë kështu:

“A mos qenë të sigurtë popullsia e atyre vendeve se ndëshkimi ynë nuk do t’u vinte natën kur të ishin në gjumë?” (el-Araf: 97)

Nga ana tjetër, Profetit i ka ardhur vahji, zbulesa hyjno- re, përgjithësisht natën. Profeti ka lindur natën e 12 të muajit Rebiulevvel në të gdhirë. Një nga ngjarjet më të shënuara të jetës profetike të profetit Muhammed (s.a.s.) është “Isra”, udhëtimi natën nga Qabeja në Jeruzalem, kurse “Miraxhi” i tij ka ndodhur natën e 27 të muajit Rexhep. Zbritja e përmb- ledhur e Kur’anit në qiellin e tokës ka ndodhur natën e Bera- tit, kurse zbritja e hollësishme, natën e Kadrit.



Si rrjedhojë e qetësisë dhe begatisë që përmbajnë, netët janë një dhunti përjashtuese për besimtarët që kanë arritur pjekuri besimore. Ata që e njohin mirë vlerën e kësaj dhuntie, veçanërisht pas mesit të natës gjejnë truallin më të begatshëm për t'iu lutur dhe përgjëruar Zotit. Për ta në Kur'an thuhet kështu:

كَانُوا قَلِيلًا مِنَ اللَّيْلِ مَا يَهْجَعُونَ وَبِالْأَسْحَارِ هُمْ يَسْتَغْفِرُونَ

“Ata flinin pak gjatë netëve, kurse në të zbardhur bënin pendesë!” (edh-Dharijat: 17-18)

Megjithëse gjatë natës nuk ka adhurime të detyrueshme (farz), namazet dhe tesbihet e kryera natën kanë një rëndësi të madhe përsa i përket afërsisë ndaj Allahut. Të hysh në klimën mëshirore të Krijuesit Transcendental ndërsa të gjithë flenë, do të thotë të jesh ndër robtë e Tij të zgjedhur, pjesëtarë të kuvendit të Tij plot mëshirë dhe dashuri!

Zoti urdhëron:

الَّذِي يَرَاكَ حِينَ تَقُومُ وَتَقْلُبُكَ فِي السَّاجِدِينَ

“(O i Dërguar!) Ai që të sheh ty kur ngrihesh (për namazin e natës) **dhe kur përsillesh mes atyre që bëjnë sexhde...”** (esh-Shuara: 218-219)

Në lidhje me këtë ajet, Kadi Bejzaviu thotë:

“Kur pesë kohë namaz u bënë të detyruara për ummetin, kurse namazi i natës, sunnet, Profeti (s.a.s.) qe ngritur natën, pati shëtitur rreth shtëpive të sahabeve dhe pati vënë re se ato gumëzhnin si koshere nga këndimi i Kur'anit, zikri dhe tespihet.”



Ndërsa sytë e lodhur me pamjet e luftës për ekzistencë, veshët e mbushur me zhurmat e përpjekjes për t'u përshkuar, mendjet e turbulluara me meditimin për jetën, buzët me zemrat e lodhura e të raskapitura nga tregimi i halleve, krahët dhe këmbët e rënduara nga lloj-lloj punësh, trupat e rënduar nën peshën e ditës ndjejnë mall për një pushim të plotë, horizontet zbehen, mbrëmjet fillojnë të bjenë...

Materia, gjithësia nënshtruar plotësisht qetësisë së një nate të errët, merr pamjen e një asgjësimi dhe bota duket si një varrezë, kurse njerëzit, të vdekur... Tashmë nuk duket shenjë nga pamjet e dhimbshme të spitaleve dhe burgjeve, kurse ata që jetojnë në pallate, janë shkëputur nga zhurma e gjallërisë së pushtetit dhe dëfrimit...

Çdokush ka marrë një pamje të mjerë nën shtypjen e përgjithshme të natës. Ndërsa endacakët dhe mjeranët janë shtrirë gjatë e gjerë mbi truall, adhuresit që e kanë shndërruar frymën e vet në një apoteozë të përjetshme ndaj Zotit, janë kah i afrohen Atij edhe më shumë.

Në Kur'an thuhet:

"... Ndërrimi i ditës me natën është vepër e Tij. Akoma s'po kuptoni?" (el-Muminun: 80)

E vërteta e zgjatjes së natës gjer në mëngjes na lidh ne, me të drejtë, me shpresën e një zbardhjeje rozë, me shpresën e mëngjesit. Sipas ligjeve të kësaj bote, me të cilat jemi mësuar, dita na kthehet në natë dhe nata, në ditë. Ndërsa të vuajturit presin mëngjesin me ngushëllimin e vargjeve si më poshtë, ne kridhemi në natë me urtësinë, sipas së cilës nuk ka ditë që të mos bëhet natë:

Mos i mbyll sytë nga dielli sado që të t'i verbojë,



Çdo natë, një ditë do ta pasojë!

Qëllimi më i rëndësishëm i ndërrimit ditë-natë është ligji i përgjithshëm sipas të cilit, “jeta përbëhet prej dy ditësh dhe një nate”. Sipas pikëpamjes së përgjithshme, jeta është nata e vdekjes mes ditës tokësore dhe ditës së botës së përjetshme. E thënë ndryshe, kjo botë është një ditë që ka mbarim, vdekja është një natë kalimtare, kurse jeta e pasme, mëngjes i një të vërtete të amshuar.



Siç është gjumi pika e takimit të jetës materiale me jetën shpirtërore, edhe vdekja e tillë është. Në një hadith, Profeti (s.a.s.) porositi:

“Varri është i fundit i konaqeve të kësaj bote, i pari i etapave të ahiretit (jetës së pasme).” (Ahmed b. Hanbel, Musned, I, 63)

Me këtë ai u tërheq njerëzve vëmendjen për faktin që va-rrri është një etapë e ndërmjetme që bashkon veçoritë e botës dhe jetës së pasme.

Kur’ani bën këtë përshkrim të figurshëm të gjumit si vdekje dhe të zgjimit si ngritje në mëngjesin e kiametit:

“Eshtë Ai që ju bën juve të vdisni natën (që ju vë në gjumë si të vdekur) dhe që e di se ç’bëni ditën, pastaj që ju ringjall (ju zgjon) ditën që të plotësohet jeta juaj e përcaktuar. Pastaj ju do të ktheheni përsëri te Ai dhe Ai do t’ju tregojë se ç’keni bërë!” (el-En’am: 60)

Me të vërtetë, ndërsa veprimtaria e organeve të një njeriu të rënë në gjumë vazhdon⁴⁰, veprimtaria mendore dhe

⁴⁰ Të kihet parasysh se veprimtaria biologjike në gjumë bie në nivelin më të ulët të domosdoshëm.



ndjesore ndërpritet. Ndryshimi i gjumit nga vdekja është te vazhdimësia e frymës shtazore te njeriu në gjumë. Pastaj, kur njeriu zgjohet pa ditur gjë për kohën që e kaloi në gjumë, të gji-tha funksionet jetësore rifillojnë me intensitetin normal të ty-re. Për këtë arsye, Profeti ka thënë:

“Gjumi është vëlla me vdekjen...” (Ahmed b. Hanbel, Kitabu’z-Zuhd, 43) Me këtë, ai ka dashur të theksojë se, përsa i përket meditimit mbi vdekjen, rrokja e të vërtetës së saj bëhet më e lehtë kur njeriu gjykon mbi të me anë të gjumit të vet, sesa kur gjykon duke marrë pjesë në funebrin e të tjerëve.

Në një ajet tjetër të Kur’anit thuhet:

“Allahu ua merr shpirtin atyre që kanë për të vdekur, në çastin e vdekjes, kurse atyre që s’kanë për të vdekur, gjatë gjumit dhe shpirtin e atyre për të cilët ka vendosur të vdesin, e mban, kurse të atyre që kanë për të jetuar gjer në një afat të caktuar, e lë. Pa dyshim, këtu ka mësim për ata që mendojnë!” (ez-Zumer: 42)

Ky ajet sugjeron se gjumi bart cilësi të vdekjes. Gjumi i mbulon njerëzit në gjumë siç i mbulon qefini të vdekurit. E rëndësishme është që njeriu që ndodhet nën mbulesë, të jetë së bashku me Zotin e vet. Në Kur’an thuhet:

“Dhe kujtoje emrin e Zotit tënd mëngjes e mbrëmje. Dhe bëji sexhde në një pjesë të natës. Dhe madhëroje Atë në një pjesë të shtyrë të natës!” (el-Insan: 25-26)

Duke e ftuar Hz. Omerin (r.a.) për t’i respektuar me ndjeshmëri të vërtetat e ditës dhe natës, Hz. Ebu Bekri (r.a.) e ka këshilluar atë kështu:



“O Omer! Allahu ka një të drejtë mbi ty në lidhje me gjërat që duhet të kryesh natën dhe atë të drejtë nuk ta pranon ditën; por ka edhe një të drejtë mbi gjërat që duhet të kryesh ditën dhe atë të drejtë nuk ta pranon natën!” (Ihju Ulumiddin, IV, 851)

Po qe se besimtari e përdor natën me një qëllim të caktuar dhe përfiton nga fryma e zikrit, nata i bëhet më e ndritshme se dita. Kurse një natë e lëshuar një gjumi të paqëllim, është e pafryt sikurse shiu që bie mbi gurishte e shkretëtirë, dhe një humbje e pazëvendësueshme.

Përfitimi nga nata fillon me pendesën. Profeti na porositi:

“Pasi të ndahem prej jush, do t’ju kem lënë si mbrojtës gjer në kiamet pendesën!..” (Tirmidhi)

Edhe sikur të mos kemi fare mëkate, duhet të falenderojmë për të mirat hyjnore që na jepen, gjë që e kemi krejt të pamundur ta bëjmë plotësisht dhe ashtu siç duhet, prandaj pendesa është një nga detyrat tona më kryesore.



Megjithëse Profeti (s.a.s) ishte i mbrojtur nga mëkati, ishte vazhdimisht i shqetësuar se mos nuk e falenderonte Zotin siç duhej, prandaj i kalonte netët me adhurim. Hz. Aisheja (r.anha) e pati pyetur:

“O i Dërguari i Allahut, pse e lodh kaq shumë veten me adhurim kur Allahu i Lartë ka bërë të ditur në suren Feth se të ka falur plotësisht?” Dhe ai i qe përgjigjur:

“A të mos jem një rob që falenderon?” (Xhem’u’l-Fevaid, I, 330)



Kurse në hadithet e tjera, Profeti na porositi kështu:

“Rinojeni besimin me Fjalën e Njësisë!” (Fezail-i Amal, 475; Ahmed b. Hanbel; Taberani)

“Çdo njeri ringjallet në po atë gjendje që ndodhet kur vdes!”
(Muslim, Xhennet, 83)

Kjo ka të njëjtin kuptim me porositë tjetër të tij: *“Si të jetoni, ashtu do të vdisni!”*

Duke e vlerësuar lart figurën e Profetit dhe duke na porositur edhe ne për ta dashur dhe respektuar atë, Kur’ani thotë:

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

“Allahu dhe engjëjt lutën shumë për mëshirë dhe paqe për Profetin. O besimtarë, edhe ju lutuni për mëshirë dhe paqe për të dhe përshëndeteni me përlulësi!” (el-Ahzab: 56)

Pas natës së jetuar në klimën e një lumturie familjare dhe të gdhirë me prehje, vjen një mëngjes jete i mbushur me vlera jetësore. Kështu, në Kur’an thuhet:

“Pa dyshim, veprimtaria e natës është më e fuqishme dhe fjala e saj, më e qartë, sepse ditën ti ke një preokupim të madh. Por ti përmende Zotin tënd dhe iu përkushto Atij me të gjithë qenien tënde!” (Muzzemmil: 6-8)

Po ta shohësh jetën brenda periodës kohore ditë-natë, do të vësh re një pamje hyjnore madhështore dhe mësimdhënëse. Shpenzimi i natës vetëm për gjumë duke e privuar



veten nga frymëzimi dhe begatia hyjnore, është një humbje e ma-dhe, sepse ne jemi udhëtarë të jetës tjetër që do të na heqin duarsh kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote. Po që se jeta e kësaj bote që vjen e shkon si një re vere, jetohet pa u shqetësuar për jetën që vjen pas, kjo s'është gjë tjetër veçse ta mendosh ditën pa perëndim, domethënë se pas ditës nuk ka për të ardhur nata!

Zoti ynë! Në këtë jetën tonë shumë të shkurtër, na ruaj nga disfata e kalimit të netëve në indiferentizëm dhe pasivitet si pasojë e nënshtrimit ndaj kërkesave dhe dëshirave të vetvetes! Dhe na jep pjesë neve nga e fshehta e netëve! Dhe na e stolis zemrën me shirat begatues të netëve të gdhirra!

Zoti ynë! Na e mundëso t'i kalojmë netët nga njëra anë duke i dhënë pushim trupit e, nga ana tjetër, duke i dhënë shpirtit një kënaqësi hyjnore të veçantë në klimën e konfidencës dhe mëshirës hyjnore!

Amin, ashtu qoftë!

W



FURNIZIMI⁴¹

Fbu Hazmi thotë:

“Krejt botën e pashë në dy gjëra të veçanta: në pjesën time dhe në pjesën e tjetrit dhe kuptova se, edhe sikur të hip mbi një re për të fluturuar e për t’i ikur pjesës sime, ajo do të më zërë, më në fund, kurse edhe sikur të hip mbi një re për të fluturuar e për ta kapur pjesën e tjetrit, kurrë nuk do të mund ta arrij e ta kap!”

Furnizimi përbën qendrën e rëndesës së programit të kaderit ose fatit të paracaktuar. Ai fillon me formimin e njeriut në mitrën amëso-re dhe vazhdon, në përputhje me shënimet në regjistrin e kaderit, gjer në çastin e vdekjes. Në një kuptim, çasti i vdekjes është pika e mbarimit të furnizimit përse i përket kësaj bote.

41 Në origjinal: rizk, furnizim, nevojat elementare të jetesës si dhe pjesa që i takon çdo krijese (njeriut dhe të gjitha krijesave të tjera të gjalla) nga të mirat e kësaj bote sipas paracaktimit hyjnor. Ideja e rizkut në Islam ka gjëra të përbashkëta me antropocentrizmin e filozofisë idealiste por nuk është identik me të. Gjithashtu, duhet sqaruar se, sipas Islamit, Allahu quhet Rezzak, furnizues, ushqyes.



Furnizimi është përcaktuar në mënyrë eternale për të gjitha krijesat. Ai nuk shtohet e nuk pakësohet. Kurse furnizimi i varur, në dukje, nga shkaqet, jep rezultat gjer në atë masë sa ç'është përcaktuar. Prandaj, furnizimi i të gjitha krijesave i përket vetëm Allahut. Kur'ani thotë:

وَمَا مِنْ دَابَّةٍ فِي الْأَرْضِ إِلَّا عَلَى اللَّهِ رِزْقُهَا

“Furnizimi i çdo gjallese që ecën mbi tokë i takon vetëm Allahut...” (Hud: 6)

Kurse në një ajet tjetër tregohet se Zoti ua siguron furnizimin (ushqimin) edhe gjallesave më të vogla, të dobëta, të plagosura e të paafta për t'u ushqyer vetë:

“Sa kafshë ka që nuk mund ta kursejnë dhe bartin me vete ushqimin, sepse furnizimin edhe të tyre, edhe tuajin e bën Allahu. Ai dëgjon dhe di gjithçka!” (el-Ankebut: 60)



Nga ana tjetër, duhet ta dimë se gjëja më e rëndësishme në furnizim është pabarazia dhe diferencimi në përpjesëtim, gjë që siguron arritjen e përsosur të rregullsisë dhe harmonisë shoqërore. Në Kur'an thuhet:

“... Ne e përpjesëtuam furnizimin e tyre në jetën e kësaj bote, duke i dhënë dikujt më shumë se dikujt tjetër në mënyrë që t'i shërbejnë njëri-tjetrit, por mëshira e Zotit është më e dobishme se gjëja që ata grumbullojnë!” (ez-Zuhuruf: 32)

Përpjesëtimi i furnizimit në këtë gjithësi të pajisur me urtësi dhe rrjedha të fuqisë hyjnore, është njëra nga shenjat më madhështore të kësaj fuqie. Për këtë mjafton të vërehet



ushqimi krejt i veçantë në sasi dhe cilësi i gjallesave që jetojnë në ujë, në tokë dhe ajër. Në Kur'an theksohet:

“A nuk e sheh njeriu se Allahu kujt të dojë i jep shumë furnizim, e, kujt të dojë, pak? Në këtë, për besimtarët e vetëdijshëm ka mësim!” (ez-Zumer: 52)

Në kuadër të kësaj të vërtete, Profeti (s.a.s.) porositi:

“Dikush nga ju, pasi ta shohë atë që qëndron më lart se vetja në krijim dhe pasuri, t’ia hedhë vështrimin edhe atij që ka më poshtë vetes, gjë që ju mjafton për të mos i nënvleftësuar të mirat që ju janë dhënë!” (Buhari, Rikak, 30; Muslim, Zuhd, 8)

Prandaj, besimi dhe bindja se ç’na është dhënë, është në të mirën tonë, janë të nevojshëm për të qenë të qetë e të lumtur në jetë. Sa e sa ngjarje persekutive ka që fundin e kanë të lumtur. Si varfëria pas së cilës vjen xhenneti. Dhe sa gjendje në dukje favor e lumturi ka që fundin e kanë një disfatë të hidhur. Si pasuritë që shpenzohen vetëm për qëllime egoistike pa bërë asnjë mirësi. Në Kur’an thuhet:

“Dhe hani ju nga gjërat e pastra me të cilat ju kemi furnizuar, pa e tepruar dhe pa u treguar mosmirënjohës. Ndryshe, ju qëllon ndëshkimi ynë! Dhe kush të qëllohet nga ndëshkimi ynë, ai me të vërtetë është shkatërruar!” (Taha: 81)

Dorëzimi dhe nënshtrimi gjer në fund ndaj Zotit për furnizimin nën dritën e këtyre të vërtetave bëhet pretext për lumturinë e njeriut në të dy botët. Duke u mbështetur mbi të vërtetën se furnizimi është përpjesëtuar nga Zoti qysh para se të jetë krijuar njerëzimi, njerëzit duhet të jetojnë të nënshtruar ndaj Tij në mënyrë që ndjejnë kënaqësinë e furnizimit që u



është caktuar, si dhe shijen e besimit të kaderi, fati i paracaktuar! Në Kur'an theksohet:

وَمَنْ يَتَّقِ اللَّهَ يَجْعَلْ لَهُ مَخْرَجًا وَيَرْزُقْهُ مِنْ حَيْثُ لَا يَحْتَسِبُ

“... Kurse kush ka frikë Allahun, Ai krijon për të një rrugëdalje dhe e furnizon atje ku s’e pret...” (et-Talak: 2-3)

Ndërkaq, njeriu duhet të bëjë edhe përpjekjet e veta për ta siguruar furnizimin dhe mirëqenien. Shfaqje të moralit të ulët si përtacia, koprracia, smira, dëshira për të mos pasur fëmijë, etj., janë konsiderata të shtrembra e të gabuara mbi furnizimin.

Gjithashtu, instinkti i vetëruajtjes është pjesë përmbajtësore e krijimit. Prandaj, përpjekjet e njeriut për t’u furnizuar dhe ushqyer si dhe për t’u ruajtur nga rreziqet janë urdhër jehonor. Në Kur’an theksohet:

وَأَنْ لَيْسَ لِلْإِنْسَانِ إِلَّا مَا سَعَى

“Për njeriun nuk ka gjë tjetër veç asaj që fiton me përpjekjen e vet!..” (en-Nexhm: 39)

Profeti (s.a.s.) porositi:

“Esh të më e dobishme dhe e bekuar që njeriu të marrë sëpatën dhe litarin, të shkojë në mal, të ngarkojë dru e t’i shesë, sesa të lypë, edhe sikur t’i japin...” (Buhari, Zekat, 50)

Sipas rrëfimit të Ibnul Firasiut, i ati e kishte pyetur Profetin:

“O i Dërguari i Allahut! A t’i kërkoj tjetërkujt (për nevojat e mia)?”



Dhe Profeti i ishte përgjigjur:

“Jo, mos i kërko! Por, po të mbetesh i detyruar të kërkos, të paktën kërko nga njerëzit e mirë!” (Ebu Davud, Zekat, 28)



Ushqimi hallall

Këtu është një pikë shumë e rëndësishme që duhet sqaruar: ushqimi hallall. Faktori bazë që e rrit figurën dhe përkrerjen e njeriut është ushqimi i fituar me rrugë legjitime.

Ushqimet haram (jo legjitime, të pabekuara, të palejuara, të ndaluara) janë helm që e helmon jetën, janë zjarr që e përvëlon zemrën dhe disfatë. Poshtërimi në këtë botë dhe në tjetrën, mungesa e dinjitetit dhe fatkeqësitë janë rezultate persekutuese të ushqimeve të fituara me mënyra jolegjitime.

Ushqimi dhe pasuria hallall (legjitime, e lejuar, e bekuar) janë pretekste për të fituar pëlqimin e Zotit. Kurse ushqimi dhe pasuria të fëlliqura me haram janë disfatë e madhe. Poeti Mevlana thotë:

“Uji që i hyn anijes brenda, e fundos, kurse uji që ka poshtë, e mban dhe i jep mundësi të vozisë!”

Allahu i Lartë urdhëron:

يَا أَيُّهَا النَّاسُ أَنْتُمُ الْفُقَرَاءُ إِلَى اللَّهِ وَاللَّهُ هُوَ الْغَنِيُّ الْحَمِيدُ

“O njerëz! Ju të gjithë jeni të varfër, kurse i pasur, i ngopur dhe i denjë për lavdërim është vetëm Allahu i Lartë!”

(Fatir: 15)



Profeti (s.a.s.) porositi:

“Pa dyshim, edhe hallalli, edhe harami janë të qartë. Por mes këtyre të dyve ka edhe gjëra të dyshimta që shumica e njerëzve nuk i dinë. Kush ruhet prej gjërave të dyshimta, e ka ruajtur edhe besimin dhe nderin e vet. Dhe kush bie në gjërat e dyshimta, ka rënë brenda në haram. Kjo i ngjan punës së atij bariut që, duke mos u kujdesur siç duhet për tufën, e lë atë të futet në livadhin e tjetrit. Ta dini mirë se çdo sundimtar ka një livadh ku hyrja është e ndaluar. Livadhi i ndaluar i Allahut janë gjërat që Ai i ka ndaluar!..” (Buhari, Iman, 39; Muslim, Musakat, 107)

Shpenzimet tona materiale janë për jetesën tonë personale dhe familjare, prandaj, ruajtja nga shpërdorimi është e detyrueshme, sepse pasuritë dhe mundësitë në botë janë të kufizuara, janë amanet dhe llogaridhënia për to është e pashmangshme. Në Kur’an theksohet:

“Nuk ka gjë që të mos të jetë e depozituar tek Ne. Dhe Ne e zbresim atë vetëm në një masë të caktuar!” (el-Hixhr: 21)

Ushqimet haram e nxijnë zemrën (ndjenjat), e bëjnë atë të shurdhër ndaj realitetit. Meqë qarkullimi i një ushqimi në trup plotësohet në rreth 40 ditë, lutja e njeriut që ka ngrënë një ushqim haram është e dënuar të mos pranohet për 40 ditë me radhë. Prandaj, ushqimi me gjëra haram është një helmim shpirtëror për trupin, pra, në këto kushte është e pamundur të shijohet adhurimi.

Në tregun e kësaj bote duhet të tregojmë kujdes për kapitalin tonë të jetëgjatësisë. Frymërat tona të numërueshme



duhet t'i mbajmë lart ndaj vulgariteteve të kësaj bote për të mos e lënë të na ikë prej dore fitimi i përjetshëm!

Ne duhet të jemi udhëtarë të së vërtetës dhe virtytit, të cilët e japin të vdekshmen për të blerë përjetësinë, të cilët e lënë mënjanë perversitetin për të pëlqyer rrugën e drejtë!


Zoti ynë! Furnizona ne me ushqime të pastra e të bekuara dhe na jep sukses në punë të mira!

Amin, ashtu qoftë!

W



FOLEJA FAMILJARE

oti e ka bërë vetminë të posaçme vetëm për vete, kurse të gjitha krijesat i ka krijuar çift. Pastaj, duke vënë ligjin e tërheqjes dhe shtytjes mes tyre, e ka kushtëzuar përkryerjen materiale e moralo-shpirtërore me bashkimin dhe njësimin e tyre me njëri-tjetrin. Pa asnjë dyshim, prirja për intimitet dhe dashuri që është e natyrshme te njeriu si krijesë e nderuar, përbën shkallën e parë të lartësimit në dashurinë pasionante hyjnore. Nisur nga kjo, Zoti, për ta mbrojtur këtë shkallë të lartë të dhënë prej Tij dhe për t'i dhënë vazhdimësi në mënyrë të pastër dhe të bekuar brezit njerëzor, e ka bërë të detyrueshme jetën familjare, për nisjen e së cilës ka urdhëruar kurorën martesore.

Për njeriun e krijuar në formën e krijimit të bukur, kurora kryen detyrën e mbrojtësit moralo-shpirtëror dhe shoqëror të nderit dhe dinjitetit njerëzor. Si rrjedhojë e kësaj, kurora është kushti më esencial i ngritjes së familjes, ose, e thënë ndryshe, shtylla qëndrore e çatisë familjare.



Për femrën, kurora është dorëzimi i ndjenjave femërore, i aftësive dhe mundësive të posaçme të saj, seksit tjetër, gjë që është mbrojtje hyjnore e seriozitetit dhe dinjitetit të saj. Kurse për mashkullin, kurora është një shtrat sublim që e shpëton atë nga përfundimi i keq i dorëzimit ndaj sensualitetit dhe që i jep mundësi të bëjë një jetë familjare të ndershme.

Pas devocionit, pasuria më e çmuar e besimtarit është një grua e mirë. Në Kur'an thuhet:

وَمِنْ آيَاتِهِ أَنْ خَلَقَ لَكُمْ مِنْ أَنْفُسِكُمْ أَزْوَاجًا لِتَسْكُنُوا إِلَيْهَا
وَجَعَلَ بَيْنَكُمْ مَوَدَّةً وَرَحْمَةً إِنَّ فِي ذَلِكَ لَآيَاتٍ لِقَوْمٍ يَتَفَكَّرُونَ

“Dhe një ndër argumentet e Tij është se krijoj për ju, nga vetja juaj, shoqe që të bashkoheni dhe që mes jush të lindë mëshirë, afërsi dhe dashuri. Me të vërtetë, në këtë fakt ka mësim për njerëzit që mendojnë!” (er-Rum: 21)

Në lidhje me zgjedhjen e bashkëshortes me të cilën njeriu do të kalojë jetën, Profeti (s.a.s.) na porositi:

“Gruaja merret për katër gjëra: pasurinë, bukurinë, fisin dhe përsosmërinë e besimit. Ju zgjidheni për besimin në mënyrë që të gjeni bekim!..” (Buhari, Nikah, VI, 132; Muslim, Rada, 53)

Meqë faktori më me ndikim për mbrojtjen e moralit të shoqërisë është kurora, Profeti (s.a.s.) e ka paralajmëruar kësh-tu bashkësinë e tij për të mos krijuar vështirësi në kurorë:

“Kurora më e dobishme dhe me të ardhmen më të mirë është kurora e pasforcuar.” (Ebu Davud, Nikah, 32)

Vështirësitë, kushtet e rënda, shtrëngesa dhe të gjitha llo- jet e sforcimeve që nxirren para kurorës ose që e shoqërojnë



atë, bëhen shkak për lindjen dhe përhapjen e prostitucionit, gjë që do të thotë vetëvrasje për shoqërinë.

Muheddini Arabiu (k.s.) është shprehur kështu për vlerën e nxitjes së kurorës dhe ndihmën që duhet t'u jepet të martuarve:

“Sadakaja xharije (gjithëvepruese) më e madhe është të bëhesh pretekst për martesën e dikujt, sepse ai që bëhet pretekst për martesën e një çifti dhe i ndihmon ata, ka për të ma-rrë shpërblim nga çdo e mirë e kryer prej pasardhësve të atij çifti!”

Nga ana tjetër, ceremonitë e martesave duhen bërë në mënyrë të thjeshtë duke u shmangur nga çdo shpenzim i tepërt.

Gjithashtu, në ngritjen e familjes duhet vepruar me shumë seriozitet, sepse foleja familjare e ngritur me mendimin e një bashkëjetese të thjeshtë përfundon me ndarje të rënda. Profeti na porositi:

“*Martohuni, por mos u ndani!..*” (Muhtarull-Ehadisi'n-Nebevije, 228)

Veçanërisht, ndarja e gruas për qejf dhe dëfrim është një padrejtësi dhe mëkat i madh me ndëshkim të rëndë.

Të drejtat e burrit dhe gruas

Individualiteti dhe personaliteti i vërtetë i njeriut del në pah në formën më të qartë në follenë familjare. Po qe se në familje sundon mirësia, ajo fiton nivel moralo-shpirtëror.



Lumturia e familjes varet nga përdorimi i mirë i të drejtave nga ana e të dy palëve.

Kryetari i familjes është burri. Ndërkaq, kryerja e mirë e kësaj detyre varet kryesisht nga burri. Kur'ani thotë:

الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ

“Burrat janë administrues të grave...” (en-Nisa: 34)

Kryesia e familjes i është dhënë burrit dhe jo gruas për shkak të ndjeshmërisë së tepërt të saj. Në mënyrë të veçantë, mbrojtja e brezit mund të bëhet vetëm me anë të ndjenjave të dhembshurisë.

Kryesia e burrit nuk ka për qëllim sigurimin e epërsisë dhe sundimit të tij mbi gruan, por sigurimin e rregullit të familjes dhe mbrojtjen e jetës bashkëshortore. Edhe gruaja kryeson dhe përgjigjet për punët brenda shtëpisë.

Fakti që mashkulli merr përsipër përgjegjësi të tilla si sigurimi i ushqyerjes dhe veshmbathjes së pjesëtarëve të familjes, sigurimi i banesës, pjesëmarrja në luftë, imameti në namaz, sundimi politik, etj., tregojnë se mashkulli është poli i bindjes. Ky është argumenti më i rëndësishëm i faktit që nuk ka pasur femra profete.

Në lidhje me ndërtimin e lumturisë së familjes, është shumë e rëndësishme që të merret pjesë nga burimi i devocionit që përmbahet në fjalën **itteku** të ajeteve kur'anore. Sepse gjatë gjithë historisë, kur është respektuar ligjshmëria mbi respektimin e të drejtave të gruas, bota është kthyer në xhennet, kurse kur është shkelur, është kthyer në xhehennem. Në hutben e tij të lamtumirës, Profeti (s.a.s.) u drejtohet muslimanëve kështu mbi të drejtat e grave:



“O njerëz! Respektoni të drejtat e grave! Trajtojini ato me dashuri dhe dhembshuri! Ju porosis të keni frikë Allahun për to! Ju i morët gratë si amanet nga Allahu dhe, në emër të tij, u bekuat me nderin dhe virtytet e tyre!” (Sahih-i Buhari Muhtasari, X, 398)

Përsosmëria e gruas arrihet me anë të ruajtjes së mundësive dhe aftësive të dhëna asaj nga Allahu. Po qe se femra i orienton veçoritë e veta në anë të kundërt me kahjen hyjnore dhe e braktis të vërtetën e vet, e shkatërron vlerën e vet dhe bëhet fatkeqe, e varfëron follenë familjare dhe, kështu, jeta shoqërore bëhet djerr. Në kohën tonë ka filluar një garë për barazinë artificiale burrë-grua. Kjo garë që bie në kundërshtim me veçoritë e krijimit, i dobëson aftësitë amësore dhe bashkëshortore të femrës dhe e plagos familjen. Nga ana tjetër, abortet e kohëve të sotme s’janë veçse një formë tjetër e modernizuar e groposjes përsëgjalli të vajzave në periudhën paraislame të injorancës idhujtare e politeiste si dhe krimi i shekullit. Mes femrës së lodhur e të rrëgjuar të këtij shekulli dhe femrës së periudhës paraislamike të injorancës ka vetëm një dallim veshjeje. Dhe kjo gjë është një krim shoqëror i rrjedhur nga edukimi materialist i ftohtë e pa shpirt.

Paralajmërimi hyjnor mbi përgjegjësinë e groposjes përsëgjalli të vajzave të vogla është mjaft i rëndë:

“Dhe kur të pyetet vajza e groposur përsëgjalli në tokë për shkak të ç’mëkati e kanë vrarë, ...” (et-Tekvir: 8-9)

Të mos duash të kesh fëmijë, është mosmirënjohje ndaj favorit hyjnor, kundërshti ndaj qëllimit serioz të kurorës, pandjeshmëri ndaj vlerave dhe shijeve shoqërore, shpirtërore e morale!



Etërit, nënat, vëllezërit e motrat në familje

Babai është autoriteti i rregullit, qetësisë dhe lumturisë së familjes. Është kartvizita e familjes. Duke e bërë burrin përgjegjës për luftën për jetën dhe për jetesën e familjes, Allahu (xh.xh.) e ka bërë atë më të fuqishëm fizikisht dhe më të fortë shpirtërisht se gruan.

Pa dyshim, sigurimi i lumturisë së familjes mbështetet mbi administrimin e pjekur të një babai të mirë.

Roli edukativ i babait në familje është t'i aftësojë pjesëtarët e familjes fetarisht dhe moralisht.

Babai dhe nëna duhet t'i ruajnë pjesëtarët e familjes nga bisedat, programet televizive, letërsia, etj. me karakter negativ. Allahu i Lartë urdhëron:

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا وَقُودُهَا النَّاسُ
وَالْحِجَارَةُ

“O ju që keni besuar! Ruajeni veten dhe familjen nga zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët!..”
(et-Tahrim: 6)

Me rregullin dhe pamjen e brendshme të shtëpisë, me administrimin e saj si dhe me lindjen dhe rritjen e brezit të ri është e ngarkuar **nëna**. Prandaj nëna është e pajisur me aftësi të tilla si thellësia e ndjenjave, delikatesa, dhembshuria, mëshi-ra, vetëmohimi dhe sakrifica, mirërritja e fëmijëve dhe mbrojtja e brezit.

Nëna është kryetari i dytë i familjes pas babait. Nga ky këndvështrim, nënat janë për shtëpitë burimi i lumturisë, drita e kënaqësisë dhe begatia e brezit!



Nuk ka një krijesë tjetër që të meritojë atë dashuri dhe respekt që meriton nëna që na ka mbajtur në bark, pastaj në krahë dhe pastaj në zemër gjatë gjithë jetës! Në lidhje me këtë, Allahu i Lartë urdhëron:

“Ne e porositëm njeriun që të sillet mirë ndaj nënës dhe babait. Sepse e ëma e ka bartur atë duke përballuar shu-më shqetësime. Pastaj i ka dhënë gji që vazhdon dy vjet. Prandaj e kemi urdhëruar të na falenderojë së pari Ne, pastaj nënën dhe babanë. Pastaj kthimi i tyre do të jetë tek Ne!” (Lukman: 14)

Ndërkaq, koncepti nënë është, në vetvete, si syzet pa numër. Ndërsa akrepi, madje, e bart pjellën e vet mbi shpinë, edhe nëna që e braktis fëmijën e saj të bukur në anë të rrugës, edhe nëna që e rrethon me mëshirë dhe dhembshuri fëmijën e saj të gjymtuar, është nënë! Profeti porositi:

الْحَنَّةُ تَحْتَ أَقْدَامِ الْأُمَّهَاتِ

“Xhenneti ndodhet nën këmbët e nënave!” (Dejlemi, Musned, 2611)

Nëna është një prehër i zgjeruar me mëshirën hyjnore. Nënata janë bartëset e posaçme e të zgjedhura të emrave hyjnorë Rahman dhe Rahim në këtë botë!



Bijtë janë, për familjet ku s’janë prishur harmonia e ndjenjave, delikatesa e ndërgegjes dhe rregulli moral, dhunti të posaçme që, duke forcuar lidhjet e dashurisë, bëhen pretekst për lumturi.

Në hadithin profetik theksohet:



“Fëmijët janë fryti i zemrës, drita e syve!..” (Tenbihu'l-Gafilin, 838)

Ndërkaq, fëmijët kanë përgjegjësi për mbrojtjen e të drejtave të prindërve dhe për respektin ndaj tyre.

Allahu i Lartë urdhëron:

“Zoti yt ju urdhëroi ta adhuronit vetëm Atë dhe të sille-ni mirë me prindërit. Po qe se njëri prej tyre ose të dy pla-ken pranë teje, mos u thuaj as “uf”, mos i qorto, por thuaju fjalë të mira!”

“Hapi krahët mbi ta me thjeshtësi dhe falje dhe lutu për ta kështu: “Zoti im! Siç patën treguar mëshirë ata për mua kur isha i vogël dhe më rritën, ashtu dhe Ti tani ki mëshirë për ta!” (el-Isra: 23-24)

Ndërkaq, **“nuk mund të ketë bindje ndaj krijesave në kundërshtimin e Zotit”**. Prandaj Allahu e urdhëron kështu fëmijën:

“Por po qe se prindërit të shtrëngojnë ty të njohësh zota të tjerë veç Meje, për ty s’ka asnjë argument, prandaj mos iu bind atyre! Megjithëkëtë, në punët e kësaj bote sillu mirë me ta dhe ec në rrugën e atyre që kthehen nga Unë. Pastaj ju do të ktheheni tek Unë!” (Lukman: 15)



Të gjitha që u thanë këtu tregojnë se familja është guri themelor i qetësisë, lumturisë dhe paqes individuale e shoqërore. Prandaj është thënë se:

جَنَّةُ الرَّجُلِ دَارُهُ

“Xhenneti i personit është shtëpia e tij!..”



Kjo do të thotë se, na ruajttë Zoti, shtëpia e vet mund t'i bëhet njeriut edhe xhehennem, skëterrë!

Zoti ynë! Na mundëso neve dhe familjeve tona një jetë devocioni me të cilën Ti do të ishe i kënaqur dhe na i bëj banesat parajsë favori dhe lumturie, jo skëterra mundimi ku marrin flakë mijra akte indiferentizmi dhe kundërshtimi ndaj Teje!

Amin, ashtu qoftë!

W



DRITE DHE ERRESIRE

*H*z. Ebu Bekr Varrak e kishte dërguar të birin në shko-llë për të mësuar Kur'an. Një ditë, i biri iu kthye në shtëpi i bërë dyllë e i tmerruar. I çuditur kur e pa, Hz. Ebu Bekr Varrak e pyeti:

“Të qoftë për mbarë, biri im, ç’ke kështu?”

I biri iu përgjigj:

“O im atë, sot, nga Kur’ani kënduam ajetin:

فَكَيْفَ تَتَّقُونَ إِنْ كَفَرْتُمْ يَوْمًا يَجْعَلُ الْوِلْدَانَ شِيبًا

“Po qe se mohoni, si do të mbroheni nga ajo ditë (e kiametit) kur fëmijët do të kthehen në pleq flokëbardhë?”

(el-Muzzemmil: 17)

Kur e mendoj këtë, më zënë drithmat dhe tmerri!

Pak kohë pas kësaj, djali vdiq. Ebu Bekr Varrak e viziton-te shpesh varrin e të birit dhe thoshte me dëshpërim:



“Unë kam shumë kohë që këndoj Kur’an por nuk u preka dot kaq shumë sa ky djalë! Sa keq për mua!”

Profeti (s.a.s.) ka porositur:

“Mësojini fëmijët të falin namaz kur të bëhen shtatë vjeç...”

(Ebu Davud, Salat, 26) Me këtë porosi ai ka tërhequr vëmendjen mbi domosdoshmërinë e fillimit të edukimit fetar në mosha të hershme, sepse sugjerimet e sinqerta që u bëhen fëmijëve të vegjël nguliten në mendjen e tyre si shkrimi mbi mermer.

Zoti e ka krijuar njohjen njerëzore të tillë që mund ta arrijë të vërtetën vetëm me anë të kontradiktave. Prandaj është e pamundur që njohja njerëzore të kapë diçka që nuk ka të kundërtën e saj. Kështu, ne mund ta njohim dhe kuptojmë të mirën bashkë me të keqen, të bukurën, bashkë me të shëmtuarën, të drejtën, bashkë me të shtrembrën, lartësinë e besimit bashkë me ultësinë e mohimit. Këto vlera ekzistojnë gjithmonë dhe vetëm me të kundërtat e tyre.

Për të gjithë njerëzit, aventura e besimit dhe mohimit zhvillohet me atributit hyjnor Hadi (orientues) dhe të kundërtës së tij, atributit Mudil (shmangës, çorientues)⁴². Fakti që toka u nënshtrohet rrymave të dritës dhe errësirës, përbën shkak që dukuritë dhe ngjarjet jetësore të trajtohen nën cilësitë antagoste **dritë dhe errësirë**.

Përballë alternimeve **dritë-errësirë**, Kur’ani i orienton njerëzit duke i shmangur nga errësira për t’i shtyrë në dritë.

⁴² Sipas Islamit, Allahu e prezanton veten si Hadi, orientues, drejtues, që e orienton atë që do në rrugë të drejtë e të mbarë, dhe si Mudil, çorientues, që e çorienton atë që do nga rruga e drejtë dhe e mbarë për ta futur në rrugën e perversitetit.



Përgjegjësia e njeriut në jetën e kësaj bote është që ta nxje-rrë fitues “dritën” që zotëron si një favor hyjnor, ndaj errësirës që ekziston në vetveten (frymën, egon) e tij. Është për këtë arsye që Kur’ani është plot urdhra dhe ndalime për njeriun me qëllim që ai ta bëjë fituese dritën në botën e tij të bre-ndshme dhe në shoqërinë ku jeton. Në Kur’an urdhërohet:

أَفَلَمْ يَسِيرُوا فِي الْأَرْضِ فَتَكُونُ لَهُمْ قُلُوبٌ يَعْقِلُونَ بِهَا أَوْ آذَانٌ
يَسْمَعُونَ بِهَا فَإِنَّهَا لَا تَعْمَى الْأَبْصَارُ وَلَكِنْ تَعْمَى الْقُلُوبُ الَّتِي
فِي الصُّدُورِ

“(O i Dërguar!) Ata që të kundërshtojnë ty, a nuk shëtitën mbi tokë për të parë? Po të kishin shëtitur, do të ishin bërë me zemra për të ndjerë dhe veshë për të dëgjuar. Por e vërteta është se sytë nuk verbohen, por verbohen zemrat brenda gjoksit!” (el-Haxh: 46)

Në Kur’an që është një gjithësi në formë fjalësh, u flitet kështu zemrave indiferente e të pandjeshme:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

“A nuk e mendojnë Kur’anin me hollësi? Apo mos i kanë zemrat të drynosura?” (Muhammed: 24)

Kur’ani na e ka bërë të njohur neve krijuesin e qiejve, të tokës e të çdo gjëje tjetër dhe na e ka tërhequr vëmendjen mbi dukuritë e dritës dhe errësirës.

Dritërat kozmologjike dhe diturore që i përkasin botës së jashtme dhe botës ndjesore nuk mund të jenë një dritë



dhe argument më i lartë se shkëlqimi i deklaratës mrekullore kur'a-nore me mësim, urtësi dhe enigme hyjnore.

Në Kur'an theksohet se “ **اللَّهُ نُورُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ** ” “**Allahu është drita e qiejve dhe tokës...**” (en-Nur: 35) Nga ky ajet rrjedhon se mosnjohja e Allahut është verbëria më e madhe.

Feja islame na kërkon që në mendje, ndjenjë, trup, art dhe tregti, në përgjegjësi dhe nëpunësi, në pasje e papasje, përgjithësisht, në të gjitha marrëdhëniet individuale e shoqërore ta ndjekim të vërtetën e dritës dhe errësirës me një parashikim serioz për të jetuar të ndriçuar e për të vdekur të ndriçuar!

Ardhja në botë e **profetit Muhammed** është një dritë madhështore e favorizuar gjithë kohëve dhe vendeve si dhe gjithë njerëzimit. Ajo përkoi me atë kohë kur e drejta dhe e vërteta ishin zhdukur, kur mohimi e kishte shëmtuar jetën, ishte **periudha pagane e injorancës**, një periudhë errësire e tmerrshme. Në Kur'an urdhërohet:

“Besoni në Allahun, në të Dërguarin e Tij dhe në atë dritë (në Kur'anin) që zbritëm! Allahu e di se ç'bëni!” (et-Te-gabun: 8)

Këndimi i Fjalës së Allahut është, pa dyshim, adhurimi më i vlershëm. Edhe sikur në namaz të mos kryhen elementët e tij për shkaqe të justifikueshme, namazi është i vlefshëm, por nuk mund të ketë namaz pa këndim Kur'ani. Në të njëjtën kohë, duhet edhe që ai të këndohet sa më bukur. Zoti ur-dhëron:

وَرَتِّلِ الْقُرْآنَ تَرْتِيلاً

“... këndoje Kur'anin fjalë për fjalë!” (Muzemmil: 4)



Këndimi i Kur'anit është sunnet, kurse dëgjimi, farz. Në Kur'an urdhërohet:

وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ

“Kur të këndohet Kur'an, heshtni dhe dëgjojeni që të mëshiroheni!” (el-Araf: 204)

Heshtja ndihmon për ta dëgjuar mirë, dëgjimi i mirë, për ta kuptuar qartë dhe kuptimi i qartë, për shtimin e begatisë së tij dhe meritimit të mëshirës hyjnore. Profeti (s.a.s.) e vinte Ibni Mesudin të këndonte Kur'an, kurse vetë e dëgjonte me sy të përlotur dhe me një kënaqësi shpirtërore të madhe.



Njëri prej shkaqeve më të rëndësishëm të mosbesimit është se disa indiferentë dhe mohues janë të paaftë për ta rrokur kufirin e kompetencës së zgjuarsisë dhe dijes njerëzore. Këta janë njerëz të mjerë që tentojnë t'i interpretojnë për mohim dijet që nuk janë të aftë për t'i kuptuar.

Për këtë tip mohuesish që nuk e njohin vetveten dhe injorancën e vet, Kur'ani thotë kështu:

“A nuk e sheh njeriu se e kemi krijuar prej embrioni? Dhe ja tek është bërë armik i hapur!..” (Jasin: 77)

Këta mohues që nuk kanë as ndjenja, u thonë atyre që kërkojnë t'ua tërheqin vëmendjen dhe t'i ndriçojnë: “Sot jemi në shekullin e shkencës, këto janë përrallat e të parëve!..” Për këta, Kur'ani thotë:

“Kur u kanë ardhur profetët me prova të hapura dhe mrekullira, ata janë mburrur me dijen e vet. Krenimi vetiak dhe përbuzja e tyre ndaj fesë i ka futur ata në rrethin e ndëshkimit!” (el-Mumin: 83)



Është detyrë e ne të gjithëve që t'i shtojmë përpjekjet për ta njohur mirë Kur'anin vetë dhe për t'ua mësuar edhe fëmijëve tanë, për të siguruar qetësinë dhe mbarëvajtjen e shoqërisë kundër injorancës, imoralitetit dhe anarkisë. Në Kur'an theksohet:

وَنَزَّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ وَلَا يَزِيدُ
الظَّالِمِينَ إِلَّا خَسَارًا

“Ne zbresim nga Kur’ani një gjë të tillë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët, kurse mizorëve vetëm sa ua shton dëmin!” (el-Isra: 82)

Si dhe:

وَلِلَّهِ خَزَائِنُ السَّمَوَاتِ وَالْأَرْضِ وَلَكِنَّ الْمُنَافِقِينَ لَا يَفْقَهُونَ

“... kurse thesaret e qiellit e të tokës janë të Allahut. Por hipokritët nuk e kuptojnë këtë!” (el-Munafikun: 7)

Bota është një sofër e hapur për shfaqjen e të gjitha emrave hyjnorë duke filluar me atributet Rahman dhe Rahim. Nuk duhet të harrojmë se jemi ulur në sofrën e kësaj bote të ëmbël me favorin e Zotit dhe se një ditë do të ngrihemi e do të shkojmë. Dhe duhet ta dimë se jemi të detyruar ta respektojmë etikën e kësaj sofre!

Dita e llogaridhënies para Allahut është e pashmangshme. Pesha, tronditja dhe tmëri i asaj dite përshkruhen kështu në Kur'an:

“Një ditë e ashpër, plot ngatërresa...” (el-Insan: 10)

Dhe:

“Atë ditë njeriu do të thotë: “Ku ka vend për të ikur?”
(el-Kijame: 10)



Fjala e Allahut është më e bukura e fjalëve. Rruga e mbarë dhe e bekuar e Profetit (s.a.s.) është më e bukura e rrugës së drejtë.

Trashëgimi më i bukur është shtresimi ndër zemra i këtij amaneti të shenjtë. Në Kur'an, si një paralajmërim hyjnor, thuhet:

“O njerëz! Ruajeni veten dhe familjen tuaj nga zjarri, lënda e të cilit janë njerëzit dhe gurët!” (et-Tahrim: 6)

Zoti ynë na i pajistë zemrat me drojtje dhe mirësi! Na bëftë udhëtarë të jetës tjetër me ndërgjegje të pastra dhe zemra të ndriçuara! Na e mundësoftë të gjithëve ta jetojmë lumturinë e amshuar në ekstazën e klimës pranverore kur'anore e muhammediane që e ka fillimin në këtë botë! Na stolistë të gjithëve me vëllazërinë e besimit, me begatinë kur'anore dhe moralin muhammedian!

Amin, ashtu qoftë!

W





PERGJEGJESIA JONE PARA KUR'ANIT




"A mund të jenë njëlloj të paditurit me të diturit?"

(Kur'ani, Zumer: 9)



PERGJEGJESIA JONE PARA KUR'ANIT

 oti që e ka krijuar njeriun me formën më të përsosur, e ka pajisur atë me aftësi të posaçme si mendja, arsyeja dhe njohja. Dhe përfundimi i natyrshëm dhe i logjikshëm i këtyre aftësive është **përgjegjësia**. Përgjegjësia më e madhe e njeriut i cili zë një vend të pashoq mes qenieve, është kryerja denjesisht e detyrës së **adhurimit** ndaj Zotit të vet.

Një prej favoreve dhe dhuratave më të mëdha nga Zoti për njeriun në këtë botë është se e ka bërë atë bashkëbisedues të **Kur'anit**. Ndërkaq, pa dyshim, kjo e rrit përgjegjësinë e njeriut. Sepse është domosdoshmëri logjike që çdo e mirë të shpërblehet me një detyrim.

Po qe se njeriu e kupton denjesisht kuptimin dhe përmbajtjen e meritimit të kësaj dhurate, me entuziazmin shpirtëror që do ta pasonte këtë gjë, do të ngrihej në nivele të larta të pakrahasueshme. Sepse njohja e kuptimit të të qenit ummet, bashkësi e Muhammedit, kërkon konceptimin e rëndësisë së kësaj përgjegjësie. Zoti që e ka caktuar dhe rregulluar këtë botë si botë prove, e ka lënë njeriun me të metën e indiferentizmit me qëllim që të kryhet dhe vërtetohet prova.



Eshtë për këtë arsye që, kohë pas kohe, ndërsa një pjesë njerëzish, duke u larguar nga frymëzimi dhe begatia e meritimit të Kur'anit, jepen pas dëshirave dhe pasioneve frymore e egoistike, njerëzit e mirë dhe besnikë të besimit ngjiten, në saje të tij, në nivele të larta. Me këto zigzake rrjedh jeta njerëzore, me këto ngjitje dhe zbritje. Prej këtyre ngjitje-zbritjeve përbëhet historia si për individët, ashtu dhe për shoqëritë!

Allahu (xh.xh.) ia ka dorëzuar si amanet gjithësinë njeriut me të gjitha gjërat që përmban. Brenda kësaj përmbajtjeje duhen menduar edhe fëmijët, pasuria, shëndeti, etj. Njeriu ka përgjegjësi për t'i përdorur dhe mbrojtur këto me korrektesë dhe ndjeshmëri. Ndërkaq, kulmin e këtyre amaneteve e përbën Kur'ani i dërguar njerëzimit si udhëzues i rrugës së drejtë nga Zoti me anë të përfaqësuesit të Tij, profetit Muhammed (s.a.s.)! Prandaj, në hutben e tij të lamtumirës, Profeti e pati përmendur Kur'anin të parin ndër amanetet dhe pati kërkuar miratimin e muslimanëve se e pati kryer plotësisht detyrën e kumtimit të tij dhe, pastaj, dëshminë e Zotit.

Sado e lartë të jetë fjala e njeriut, ajo është e kufizuar. Kështu, tefsiret dhe interpretimet e bëra për shtjellimin e kup-timeve që përmban Kur'ani, i përngjajnë nxjerrjes së ujit nga deti me enët tona. Në lidhje me këtë, poeti Mevlana thotë:

“Fjalët e Kur'anit mund të shkruhen me një sasi boje, kurse për shkrimin e të fshehtave të tij s'mjaftojnë lumenj, s'mjaftojnë dete pa breg!”

Në lidhje me pafundësinë e të vërtetave kur'anore, Zoti thotë kështu:

وَلَوْ أَنَّ مَا فِي الْأَرْضِ مِنْ شَجَرَةٍ أَقْلَامٌ وَالْبَحْرِ يَمُدُّهُ مِنْ بَعْدِهِ
سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَا نَفِدَتْ كَلِمَاتُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ



“Edhe sikur pemët mbi tokë të bëhen pena dhe detrat bojë, fjalët e Allahut nuk mbarojnë. Pa dyshim, Allahu është fitues dhe i urtë absolut!” (Lukman: 27)

Nuk ka dyshim se Kur’ani është zbritur për t’u falur njerëzve lumturinë e të dy botëve.

Profeti ynë na ka porositur:

“Mbahuni fort pas Kur’anit dhe njiheni atë për udhëheqës dhe komandant, sepse ai është fjala e bekuar e Allahut, edukuesit të botëve! Erdhi prej Tij dhe te Ai do të kthehet!”

Ajetet e Kur’anit janë plot me mrekulli që ndriçojnë errërsirat e historisë, që zgjidhin të panjohurat e pazgjidhshme, që dhurojnë pranverën e jetës së kësaj bote e të botës së pasme. Duke na treguar për ndodhitë e kohëve të vjetra, e popujve të kaluar, Kur’ani na favorizon shumë mësimë dhe urtësi dhe na jep shumë mësimë jetësore e shoqërore mbi të ardhmen!

Vetëm se indiferentët që vetëm i vënë veshin zërit të Kur’anit pa arritur dot te urtësitë e përmbajtjes së tij, mbeten të privuar nga begatia e tij për jetën e njeriut. Njerëz të tillë vrapojnë pas kënaqësive të kësaj bote të përkohshme pa mundur ta adhurojnë Zotin siç duhet.

Edhe shumë vetë që kanë futur të afërmit në dhé, s’dinë gjë për aventurën që zhvillohet atje. Sepse ata s’kuptojnë nga gjuha e selvive, kurse kur hanë një shpullë paralajmëruese me anë të tërmeteve, furtunave dhe fatkeqësive të ndryshme, bërtasin me të madhe mbi “dukuri të natyrshme” dhe kërkojnë strehim. Sa e çuditshme është që jetojnë në pronën hyjnore, por ose mbeten indiferentë ndaj Zotit, ose bëhen armiq të Tij! Në lidhje me këtë, në Kur’an thuhet:



أَوَلَمْ يَرَ الْإِنْسَانُ أَنَا خَلَقْنَاهُ مِنْ نُطْفَةٍ فَإِذَا هُوَ خَصِيمٌ مُبِينٌ

**“A nuk e sheh njeriu se e krijuam prej një embrioni?
Kurse ai ja tek bëhet armik i hapur!”** (Jasin: 77)

Sipas përshkrimit islam, varret janë ose gropa xhehen-nemi, skëterre, ose lulishte xhenneti, parajse. Edhe njeriu pa Kur’an nuk ka ndryshim nga të varrosurit në ato varre si gropa skëterrore. Ai është pothuaj si një varrezë shëtitëse. Kurse besimtarët me zemrën të mbushur me dritën e Kur’anit, mendojnë vazhdimisht mbi të vërtetat e larta. Fjala hyjnore u su-gjeron zemrave të tyre gjithmonë këto ide:

“Ti je rob i Allahut, jeton në pronën e tij, ushqehesh me ç’të jep Ai, prandaj kridhu në urtësinë dhe enigmën e Kur’anit dhe, me zemër të pastër, udhëto drejt Zotit tënd!”

Duke u mbështetur në këtë të vërtetë, poeti Junus Emre shprehet kështu poetikisht:

*Njeriu që s’këndon Kur’an një herë,
Çdo punë i vjen e vështirë;
Kështu shkon dimër e verë,
I habitur, i hutuar shkon e vjen!..*

*Njeriu që Kur’an s’diti,
Në këtë botë zëre se s’erdhi,
Shërim për hallet s’gjeti;
Për punët që ka bërë, pendesë ndjen!..*



Në Kur’an, Zoti urdhëron:



“(O i Dërguar!) Thuaj: “Allahu im që je pronari i vërtetë i pasurisë! Ti i jep pasuri kujt do dhe ia merr pasurinë kujt do. Ti e lartëson kë do dhe e poshtëron kë do. Të gjitha të mirat janë në dorën tënde dhe Ti ke mundësi për çdo gjë!”

(Al-i Imran: 26)

“Sundimi i qiejve e i tokës i përket Allahut dhe ai ka fuqi për çdo gjë!” (Al-i Imran: 189)

“Thesaret e qiejve e të tokës janë të Allahut, por hipokritët nuk e kuptojnë këtë!” (el-Munafikun: 7)

Këto ajete e deklarojnë hapur se fuqia e vetme që dhuron suksesin e sotëm dhe të ardhmen është Allahu, Krijuesi i gjithësisë. Perspektiva e vërtetë është jeta e pasme e amshuar, kurse sukcesi i sotëm i vërtetë është meritimi i pëlqimit hyj-nor.

Nuk ka dyshim se detyra e parë e çdo njeriu me zemër të pastër dhe e çdo muslimani të zgjuar është t'i mendojë fatkeqësitë e mëdha që do të rridhnin nga nënvleftësimi dhe braktisja e Kur'anit që i çon njerëzit në pjekuri dhe lumturi dhe popujt në nder dhe lartësim, ndëshkimet e rënda përkatëse, dhe të veprojnë siç duhet.

Në Kur'an theksohet:

أَفَلَا يَتَذَكَّرُونَ الْقُرْآنَ / إِنَّ أَمْ عَلَى قُلُوبٍ أَقْفَالُهَا

“A nuk mendojnë ata mbi hollësitë e Kur'anit? Apo i kanë zemrat të drynosura?” (Muhammed: 24)



Në këtë botë ku ndodhemi si udhëtarë, nuk duhet ta ndiejmë veten si vendas. Shekujt dhe njerëzit janë një karvan hyj-nor emigrantësh. Ligji i kalimit nga kjo botë hijesh



në vendin e të vërtetave është thelbi i jetës dhe një e vërtetë e pashma-ngshme!

Për ta rrokur të vërtetën e faktit se do të vijë një ditë që do të bëhemi një copë nga ai dhé që e shkelim me këmbë për ditë dhe për ta rregulluar jetën tonë nën dritën e kësaj ideje, na duhet që të përkulemi me besim dhe dashuri para përmbajtjes së gjerë të Kur'anit! Ndërkaq, prindërve u bie për detyrë që t'i përgatisin fëmijët me një kuptim të qartë mbi jetën dhe perspektivën e saj.

Ç'lumturi për ata që marrin përsipër dhe e çojnë në vend përgjegjësinë e tyre para Kur'anit për të sotmen dhe për të ardhmen e brezit njerëzor!

Zoti ynë! Bëna ne rob të Tu të vërtetë dhe njerëz të tillë të përgjegjshëm dhe na e mbro atdheun dhe kombin nga mungesa e Kur'anit, nga mosbesimi dhe imoraliteti! Dhe na e bëj të mundur të jetojmë në këtë botë të vdekshme jetë xhenneti të mbështjellë me shkëlqimin e vërtetë të Kur'anit dhe na e bëj të mundur vazhdimësinë e brezit të Kur'anit të begatshëm!

Amin, ashtu qoftë!

W



PER TE QENE NJE KUR'AN I GJALLE

Lumturia e kësaj bote dhe e përjetësisë i është premtuar njeriut vetëm në shpërblim të bindjes ndaj Kur'anit. **Çdo e vërtetë ndodhet e fshehur në Kur'an, çdo lumturi ndodhet e dukshme në besim!** Njerëzit më të dobishëm e më të lumtur të botës janë njerëzit e mbledhur nën hijen e Kur'anit dhe të ndriçuar me dritën jetësore të tij si dhe njerëzit e shkri-rë me të, domethënë njerëzit që kanë mundur të bëhen një Kur'an i gjallë!

Në Kur'an shprehet kështu mbi Profetin (s.a.s.):

وَأَنَّكَ لَعَلَىٰ خُلُقٍ عَظِيمٍ

“(O i Dërguar!) Pa dyshim, ti qëndron mbi një moral të lartë!” (el-Kalem: 4)

Në lidhje me këtë pohim, e pyetën Hz. Aishenë se cili ishte morali i Profetit dhe ajo u përgjigj kështu:

“Morali i tij ishte Kur'ani!..” (Muslim, Kitabu-s-Salat, 746)

Prandaj, ajeti i mëposhtëm:

الرَّحْمَنُ عَلَّمَ الْقُرْآنَ ۚ إِن خَلَقَ الْإِنْسَانَ عَلَّمَهُ الْبَيَانَ



“Rahmani ua mësoi Kur’anin. Ai e krijoi njeriun dhe e mësoi si të shprehej!” (Rahman: 1-4)

është komentuar kështu:

“Zoti e krijoi njeriun për t’ia mësuar Kur’anin dhe e mësoi të shprehej që ta kuptonte Kur’anin.”

Kur’ani që është vendshfaqja më e madhe e mëshirës së Allahut mëshirues për njerëzimin, është për njerëzimin një thesar dhe një dhunti pakrahasimisht e madhe dhe e lartë. Kur’ani është interpretuesi më i drejtë e më i përsosur i njeriut dhe i ligjeve dhe rregullave themelore të gjithësisë. Është i vetmi udhëzim i rrugës së drejtë i zbritur nga Levhi Mah-fudh⁴³.

Kur’ani na fton ne për të medituar, na zgjon ne nga indiferentizmi dhe përgjumja me qëllim që të mendojmë. Ai u jep përgjigje hyjnore pyetjeve: Ç’është njeriu? Nga e ka prejardhjen? Si ka filluar ekzistenca e tij? Kush ia ka mësuar njeriut imtësitë e Kur’anit dhe shprehjes?



Zemrat e besimtarëve të bërë një me Kur’anin janë qiej të pakufi të mbretërimit të Allahut.

Kjo veçori është shfaqur në formën më të bukur te sahabet, shokët e Profetit, të cilët qenë mbështjellë me shkëlqimin e Kur’anit, patën jetuar në parajsën e të vërtetave kur’anore dhe i patën ndjerë në zemër delikatesat e tij.

Në Kur’an thuhet:

⁴³ Sipas Islamit, Tabela e Kujtesës ku përmbahet informacioni i përgjithshëm dhe i detajuar i ekzistencës.



مَنْ يَعْمَلْ سُوءًا يُجْزَ بِهِ

“... dhe kush të bëjë një punë të keqe, ta vuajë ndëshkimin e saj!..” (en-Nisa: 123)

Kur zbriti ky ajet, Ebu Bekri (r.a.) tha duke u dridhur thellë nga frika e Allahut:

“Më duket sikur m’u thye mesi, sikur u mpiva dhe mbeta ashtu...” (S. Uludag, Kelabazi, Taarruf, f. 113)

Një ditë, ndërsa po kalonte kaluar para një shtëpie, Hz. Omeri (r.a.) dëgjoi se i zoti i shtëpisë po këndonte suren Tur me një zë që dëgjohej gjer jashtë. Dhe ja tek njeriu erdhi te ajeti që thotë: **“Pa dyshim, ndëshkimi i Zotit tënd është i vërtetë dhe s’ka gjë që mund ta propësojë atë!”** (et-Tur: 7-8) Omeri zbriti nga kafsha, u mbështet te muri dhe vazhdoi të dëgjojë. Pastaj, tejet i prekur, shkoi në shtëpi ku ra i sëmurë disa ditë!

Shprehja e mëposhtme e Hz. Omerit të bën të mendohesh thellë:

“Suren Bakara e mbarova në dymbëdhjetë vjet dhe preva një kurban për falenderim!..”

Sepse këndimi i Kur’anit s’ishte për të vetëm shqiptim i fjalëve të tij. Këndimi i tij ishte duke fituar kompetencë mbi urtësinë dhe enigmën e Kur’anit, duke i kuptuar dhe jetuar idetë hyjnore të tij. Sepse, përfitimi nga Kur’ani në kuptimin e vërtetë të kësaj fjale, mund të bëhej vetëm në këtë mënyrë!

Morali i Kur’anit është një realitet tejet i thellë e sublim. Zemrat marrin pjesë nga Kur’ani në atë masë sa mund të mbruhen me të. Kështu, kjo pjesë, kjo masë përfitimi nga



Kur'ani te dikush është e pakët, te dikush, mesatare dhe, tek dikush tjetër mjaft e madhe. Pra, sipas të veçantës së zemrës!

Prandaj, zemrat duhet të kthehen në **Kur'an të gjallë** në mënyrë që të mund të meritojnë favorin dhe enigmën e tij! Ndërkaq, për t'u bërë Kur'an i gjallë, duhet filluar me mësimin sa më të bukur dhe përjetimin e tij!



Në këtë drejtim janë përgatitur shumë e shumë njerëz kompetentë të fjalës dhe kuptimit të Kur'anit që ia kanë kushuar fjalën dhe zemrën vetëm Kur'anit, që e kanë kërkuar çdo gjë nga Kur'ani duke lexuar ajetet e tij, që i kanë dhënë përgjigje çdo pyetjeje duke lexuar ajetet e tij. Burri i madh i Islamit, Abdullah Ibni Mubarek, na e përcjell kështu gjendjen plot mësim dhe urtësi të një gruaje që përmbante këto cilësi:

“Kisha dalë në rrugë me qëllim për të vizituar Qaben për haxh dhe varrin e Profetit (s.a.s.). Diku, pashë një si gjë të zezë ndanë rrugës. Pasi e pashë me kujdes, e kuptova se ishte një grua e vetme me kokën mbuluar me një mbulesë të leshtë, kurse në shpinë kishte një lëmsh leshi. E përshëndeta me selam:

“Esselamu alejkum ve rahmetullahi ve berekatuhu!”

Kurse ajo ma ktheu përshëndetjen duke kënduar ajetin e Kur'anit:

“(Dhe ky) është një selam nga Zoti i tyre shumë bujar!”

(Jasin: 58)

E pyeta:

“E gjeç të mirën prej Allahut! Ç'bën këtu ti?”

Ajo m'u përgjigj me ajetin 186 të sures Araf:



“Atë që ta çorientojë Allahu, s’ka kush që mund ta sjellë në rrugë!..”

E kuptova se ajo e kishte humbur rrugën, prandaj kishte mbetur aty. Dhe e pyeta:

“Ku dëshiron të shkosh?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 1 të sures Isra:

“Ai që një natë e mori robin e vet nga Qabeja dhe e çoi në xhaminë Aksa...”

E kuptova se kishte bërë haxh dhe donte të shkonte në Jeruzalem. E pyeta:

“Sa ditë ke këtu?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 10 të sures Merjem:

“Tri net të plota...”

I thashë:

“Nuk shoh të kesh ndonjë gjë për të ngrënë!”

Ajo këndoi ajetin 79 të sures Shuara:

“Eshtë Ai që më ushqen mua..”

E pyeta:

“Me se merr abdest?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 43 të sures Nisa:

“... dhe po të mos gjeni ujë, bëni tejemmum me dhé të pastër!..”

E pyeta:

“Me vete kam gjëra për të ngrënë. A do të hash?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 187 të sures Bakara:

“... pastaj plotësojeni agjërimin gjer në mbrëmje...”

Unë i thashë:



“Po tani nuk jemi në muajin e ramazanit!”

Ajo më këndoi nga ajeti 158 i sures Bakara:

“... dhe kush të bëjë një punë të mirë nga zemra. Sepse Allahu është ai që jep shpërblimin e bindjes dhe di çdo gjë me të drejtë!”

Unë i thashë:

“Mirëpo ne e kemi të lejuar ta prishim agjërimin në udhëtim!”

Ajo më këndoi nga ajeti 184 i sures Bakara:

“... sikur ta dinit se (me gjithë vështirësitë) agjërimi është për ju më i dobishëm!”

E pyeta:

“Pse nuk bisedon me mua siç po bisedoj unë me ty?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 18 të sures Kaf:

“S’ka fjalë që ta thotë njeriu e të mos shënohet nga një engjëll që i ndodhet pranë dhe e vëzhgon!”

Unë i thashë:

“Të të hip në devenë time e ta arrijmë karvanin tënd!”

Ajo më këndoi nga ajeti 197 i sures Bakara:

“... Allahu e di se ç’punë të dobishme bëni...”

E ula përtokë devenë që të hipte. Ajo më këndoi pjesë nga ajeti 30 i sures Nur:

“Thuaju besimtarëve t’i ruajnë sytë nga harami...”

Dhe, pasi hipi në deve, më këndoi nga ajetet 13-14 të sures Zuhruf:

“... sa e lartë është fama e Allahut që na i vë këto nën urdhër, ndryshe ne vetë nuk do të bënim dot gjë! Pastaj, pa dyshim, do të kthehemi tek Ai!”



Pasi u vumë në udhë, më këndoi nga ajeti 20 i sures Muz-zemmil:

“... lexoni nga Kur’ani atë që t’ju duket më e lehtë...”

Kurse unë, duke u frymëzuar nga ajeti që thotë, **“... kujt t’i jepet urtësi, do të thotë se i janë dhënë shumë dobi...”**

(Bakara: 269), i thashë:

“Ty të janë dhënë shumë dobi!”

Dhe ajo këndoi vazhdimin e këtij ajeti:

“... nuk mendojnë mirë veçse ata që kanë mendje të shëndoshë!” (Bakara: 269)

Më në fund, e arritëm karvanin dhe i thashë gruas:

“Ja karvani yt! Kë ke aty?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 46 të sures Kehf:

“Pasuria dhe djemtë janë stoli e kësaj bote!..”

E kuptova se në karvan kishte të bijtë. E pyeta:

“Ç’kërkojnë ata në karvanin e haxhit?”

Ajo m’u përgjigj me ajetin 16 të sures Nahl:

“Dhe sa të mira të tjera krijoi. Ata e gjejnë rrugën me anë të yjeve...”

E pyeta:

“Cilët janë të tutë në këto çadra?”

Ajo më këndoi me radhë pjesën e fundit të ajetit 125 të sures Nisa, një pjesë nga ajeti 164 i po kësaj sureje dhe fillimin e ajetit 12 të sures Merjem:

“... Allahu e ka bërë Ibrahimin mik...” “... Allahu me të vërtetë bisedoi me Musanë...” “O Jahja, mbahu me të gjithë fuqinë pas Librit!..”

Atëherë unë thirra:



“O Ibrahim! O Musa! O Jahja!”

Dhe ja ku dolën nga çadra tre të rinj si drita!

Pasi erdhën e u ulën pranë nesh, e ëma u këndoi nga ajeti 19 i sures Kehf:

“... dhe tani dërgoni në qytet njërin prej jush me këtë para të argjendtë që t’ju sjellë diçka të pastër për të ngrënë...”

Njëri nga djemtë shkoi e solli për të ngrënë. Gruaja këndoi ajetin 24 të sures Hakka:

“Hani e pini me shëndet si shpërblim për të mirat që bëtë ditët e kaluara...”

Por unë u thashë kështu djemve:

“M’u bëftë haram ushqimi juaj nëse s’më tregoi se kush është kjo nëna juaj!”

Dhe djemtë më thanë kështu:

“Ka dyzet vjet që kjo nëna jonë flet vetëm me ajetet e Kur’anit nga frika se mos bëjë gabim!”

Atëherë unë u këndova atyre ajetin 4 të sures Xhuma:

“Ky është një virtyt që Allahu ia jep kujt të dojë! Allahu është i virtytshëm dhe bujar!”

(M.A.Koksal, Kitab ve Sunnet, 21-25)

Ja, pra, njëra prej mënyrave të shumta për t’u bërë një Kur’an i gjallë!

Ibni Abbas (r.a.) thoshte kështu:

“Po të më humbej litari i devesë, edhe atë, në librin e Allahut e gjeja!”

Sepse Kur’ani përmban informacion, njohuri, dituri, të fshehta, urtësi dhe mjeshtëri të pasosura:



وَلَوْ أَنَّ مَا فِي الْأَرْضِ مِنْ شَجَرَةٍ أَقْلَامٌ وَالْبَحْرِ يَمُدُّهُ مِنْ بَعْدِهِ
سَبْعَةُ أَبْحُرٍ مَا نَفِدَتْ كَلِمَاتُ اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ عَزِيزٌ حَكِيمٌ

“Edhe sikur pemët mbi tokë të bëhen pena dhe detrat bojë, fjalët e Allahut nuk mbarojnë...” (Lukman: 27)

Këtu duhet ta pohojmë se të mbahesh fort pas Kur’anit e të bëhesh një Kur’an i gjallë, nuk do të thotë t’i lësh mënjanë sunnetin dhe hadithet. Përkundrazi, do të thotë t’i jetosh Librin dhe Sunnetin si një e tërë, gjë që e urdhëron vetë Kur’ani:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا وَاتَّقُوا اللَّهَ إِنَّ
اللَّهَ شَدِيدُ الْعِقَابِ

“... dhe ç’t’ju japë i Dërguari, atë merreni dhe nga ç’gjë që t’ju largojë ai, nga ajo ruhuni!...” (el-Hashr: 7)

Nuk duhet harruar se Islami ka dy burime që ia ka ofruar njerëzimit si një të tërë:

I pari, Kur’ani, dhe, i dyti, sunneti i Profetit (s.a.s)!

Zoti ynë! Na i zbukuro zemrat me diturinë, urtësinë, dritën dhe gëzimin e Kur’anit dhe na bëj të dashur të pasionuar të profetëve që e kanë jetuar Islamin si Kur’an i gja-llë!

Amin, ashtu qoftë!



PERMBAJTJA

Parathënie.....	5
Enigma në dashurinë për Allahun dhe Profetin.....	11
Trungu i hurmës që qan.....	34
Njeriu i përkryer.....	42
Orientimi.....	53
Të rrish bashkë me njerëzit e mirë dhe besnikë.....	65
Shpirti dhe kurmi.....	77
Besimi dhe prova.....	87
Sinqeriteti ndaj Allahut.....	97
Frika dhe shpresa.....	106
Indiferentizmi.....	111
Ambicja, smira dhe kënaqja.....	120
Mposhtja e zemërimit.....	131
Jeta dhe vdekja.....	139
Ta zbukurosh vdekjen.....	151
Enigma e natës.....	167
Furnizimi.....	176
Foleja familjare.....	183
Dritë dhe errësirë.....	192
Përgjegjësia jonë para Kur'anit.....	199
Për të qenë një Kur'an i gjallë.....	207

